



Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo
Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
Ministarstvo Poljoprivrede, Šumarstva i Ruralnog Razvoja
Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development



PROGRAMI | 2023

PËR ZHVILLIM RURAL



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
Ministarstvo Poljoprivrede, Šumarstva i Ruralnog Razvoja
Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development

Programi për Zhvillim Rural 2023

Shtator 2023

Tabela e përmbajtjes

PROGRAMI PËR ZHVILLIM RURAL 2023	4
1. Kërkesat e përgjithshme që vlejné për të gjitha masat përveç nëse është shkruar ndryshe në masën specifike	4
2. Aplikuesit e pranueshëm për mbështetje	5
3. Kërkesat e aplikimit për mbështetje	5
4. Kushtet në vijim gjithashtu do të kërkohen për zbatimin e masave të programit	5
5. Pagesa e kësteve dhe paradhëniet për mbështetjen e investimeve	5
6. Kushtet financiare	6
7. Investimet e pranueshme për mbështetje	6
8. Shpenzimet e papranueshme në kuadër të Programit	7
9. Procedura Administrative	7
10. Kontrollat administrative	8
11. Verifikimi i shpenzimeve të pranueshme dhe vlerësimi i qëndrueshmërisë ekonomike dhe financiare	8
12. Kontrollat në terren (On spot)	8
13. Kriteret e përzgjedhjes dhe renditja e projekteve/poentimi	8
14. Aprovimi i projekteve dhe kontraktimi	9
15. Refuzimi i projekteve	9
16. Implementimi i projektit	9
17. Aprovimi i pagesës	10
18. Kontrollat Ex-post	10
19. Buxheti dhe ndarja në masa	10
MASA 1: INVESTIMET NË ASETET FIZIKE TË EKONOMIVE BUJQËSORE	11
1. Baza ligjore	11
2. Arsyeshmëria	11
3. Objektivat e përgjithshme	15
4. Lidhja e masës me masat tjera të Programit	16
5. Përfituesit	16
6. Kriteret e përbashkëta të pranueshmërisë	17
7. Kriteret e veçanta të pranueshmërisë	20
8. Shpenzimet e përbashkëta të pranueshme	23
9. Kriteret e përzgjedhjes	26
10. Shkalla e përkrahjes publike	28
11. Buxheti për Masën 1	29
12. Treguesit	29
13. Procedura administrative	30
14. Afati i zbatimit	30
15. Shtrirja gjeografike e masës	30
MASA 3: INVESTIMET NË ASETET FIZIKE NË PËRPUNIMIN DHE TREGTIMIN E PRODUKTEVE BUJQËSORE	31
1. Baza ligjore	31
2. Arsyeshmëria	31
3. Objektivat e përgjithshme	36
4. Lidhja me masat e tjera të programit	36
5. Përfituesit	36
6. Kriteret e përbashkëta të pranueshmërisë	37
7. Kriteret e veçanta të pranueshmërisë	39
8. Investimet e përbashkëta të pranueshme	40
8.1 Investimet e pranueshme për sektor	41
9. Kriteret e përzgjedhjes për të gjithë nënsektorët	43
10. Shkalla e përkrahjes publike	43
11. Buxheti	44
12. Treguesit	44
13. Procedura administrative	45
14. Afati i Zbatimit	45
15. Shtrirja gjeografike e masës	45
MASA 7: DIVERSIFIKIMI I FERMËS DHE ZHVILLIMI I BIZNESIT	46

1.	Baza ligjore	46
2.	Arsyeshmëria	46
3.	Objektivi i përgjithshëm	49
4.	Lidhja me masat e tjera të PZHR –së	49
5.	Përfituesit	49
6.	Kritere të përbashkëta të pranueshmërisë	49
7.	Kriteret e veçanta të pranueshmërisë	53
9.	Kriteret e përzgjedhjes sipas nënmasave	58
10.	Shkalla e përkrahjes publike	63
11.	Buxheti	64
12.	Treguesit	65
13.	Procedurat administrative	65
14.	Afati i zbatimit	65
15.	Shtirirja gjeografike e masës	65
MASA 5: ZBATIMI I STRATEGJIVE TË ZHVILLIMIT LOKAL – QASJA LEADER		66
1.	Baza Ligjore	66
2.	Arsyeshmëria	66
3.	Objektiva e përgjithshme	66
4.	Lidhjet me masat e tjera në program të PZHR-së	67
5.	Përfituesit	67
6.	Zbatimi i Qasjes LEADER	67
7.	Aktivitetet e pranueshme	69
8.	Procedura për përzgjedhjen e Grupeve Lokale të Veprimt	69
9.	Kriteret e përzgjedhjes së SZHL-ve	70
10.	Intensiteti i ndihmës dhe niveli i kontributit	70
11.	Buxheti	70
12.	Treguesit	71
13.	Procedura administrative	71
14.	Afati i zbatimit	71
15.	Shtirirja gjeografike e masës	71

PROGRAMI PËR ZHVILLIM RURAL 2023

Programi është i bazuar në Strategjinë për Bujqësi dhe Zhvillim Rural 2022-28, Programin Kombëtar për Bujqësi dhe Zhvillim Rural 2023 -2027, Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr.15/151 të datës 12 .07. 2023, Ligjin Nr.08/L-072 për Bujqësi dhe Zhvillim Rural (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/ Nr. 8/ 29 mars 2023) dhe në analizën e pavarur sektoriale, për sektorët kryesorë të bujqësisë dhe zhvillimit rural, e cila është financuar nga zyra e BE-së në Kosovë:

- Sektori i bimëve/drithërat, pemët dhe perimet - prodhimi, përpunimi dhe tregtimi në tërë zinxhirin;
- Sektori i legjtorisë (mishi, qumësht, vezë) - prodhimi, përpunimi dhe tregtimi në tërë zinxhirin, dhe
- Diversifikimi rural dhe zhvillimi i ekonomisë rurale, përfshirë marketingun në tërë zinxhirin. Këtu përfshihen edhe niveli i arritjes së standardeve përkatëse kombëtare dhe të BE-së, si dhe përafrimi me marrëveshjen e Gjelbër të BE-së.

Sipas analizave të përmbledhura; analizës SWOT, analizës sektoriale janë përcaktuar objektivat afatmesme të PZHR, të cilat janë:

- Rritja e konkurrencës së sektorit agro-ushqimor duke përmirësuar efikasitetin dhe qëndrueshmërinë e prodhimit në fermë, duke tërhequr fermerët e rinj, duke orientuar prodhimin sipas kërkesave të tregut, duke përmirësuar zinxhirin e vlerës dhe duke u fokusuar në kërkimin, inovacionin, teknologjinë e re dhe digjitalizimin;
- Të sigurojë përgjigje më të mirë ndaj kërkesave të shoqërisë për ushqim të sigurt, ushqyes dhe të qëndrueshëm, duke kontribuar me një pjesë më të madhe të prodhimit vendas;
- Mbrotjtja e burimeve natyrore dhe mjedisore, të cilat adresojnë sfidat e ndryshimeve klimatike duke arritur përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore;
- Përmirësimi i cilësisë së jetës, zhvillimi i komunitetit dhe përfshirja sociale në zonat rurale dhe ndërtimi i administratave publike moderne, duke respektuar parimet e qeverisjes së mirë.

Kërkesat e përgjithshme që vlejné për të gjitha masat përveç nëse është shkruar ndryshe në masën specifike

- Shkalla e përkrahjes, minimumi dhe maksimumi i shpenzimeve të gjithmbarshme të pranueshme;
- Rregullat e pranueshmërisë: aplikuesit e pranueshëm, investimet/aktivitetet e pranueshme, shpenzimet e pranueshme;
- Kriteret e përzgjedhjes;
- Procedurat për aplikim, përfshirë dispozitat për kontrolle administrative dhe të pranueshmërisë, verifikimin e rentabilitetit të investimeve;
- Dokumentet mbështetëse të kërkuara për të dëshmuar pranueshmërinë e aplikuesve dhe investimeve, si dhe prioritetet në sistemin e përzgjedhjes;
- Procedurat e kontraktimit dhe dispozitat për plotësim-ndryshim të kontratave;
- Obligimin për të mos ndryshuar investimin sipas Ligjit;
- Publikimin e emrave të përfituesve që kanë pranuar përkrahje
- Shpjegime për obligimet për publicitet dhe dukshmëri; si dhe
- Masat e ndëshkimit në rast të mos respektimit të kushteve të parapara, para dhe pas zbatimit të projektit.

Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë (AZHB), në bashkëpunim me AM-në, do të zhvillojë modelet për formularët e aplikacionit dhe planet e biznesit dhe do të ofrojë udhëzime për

përgatitjen e tyre, kontrata standarde, gjithashtu do të sigurohen udhëzuesit për fermer për secilën masë.

1. Aplikuesit e pranueshëm për mbështetje

Grupet e aplikantëve të pranueshëm sipas Programit për Zhvillim Rural janë:

- Ekonomitë bujqësore/personat fizik dhe juridik të regjistruar në Regjistrin e Fermës në pajtim me Ligjin Nr.08/L-072 për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural dhe Ligjin Nr.06/L-016 për Shoqëritë Tregtare;
- Operatorët e ushqimit (përpunimi dhe tregtimi i produkteve bujqësore), të regjistruar në bazë të Ligjit Nr.04/L-2020 për Investime të Huaja, Ligji Nr. 08/L-120 për Ushqim dhe Ligjit Nr. 06/L-016 për Shoqëritë Tregtare;
- Grupet Lokale të Veprimit të regjistruara në MPB në bazë të Ligjit për Bujqësi dhe Zhvillim Rural dhe Ligjit Nr.06/L-043 për Lirinë e Asocimit në Organizatat Joqeveritare.

2. Kërkesat e aplikimit për mbështetje

Kërkesat e përgjithshme në vijim zbatohen, përveç nëse kërkohet ndryshe në përkrahimin e masës. Të gjithë aplikuesit që aplikojnë për mbështetje nga PBZHR-ja duhet të dorëzojnë formularët e aplikimit të lëshuar nga Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë për masa të veçanta dhe të kompletojnë dokumentet e kërkuara.

Në aplikacion duhet të përfshihen aktivitetet dhe shpenzimet e pranueshme lidhur me projektin për të cilin aplikohet. Aplikuesi mund të aplikojë në masa të ndryshme të programit. Megjithatë, aplikuesi mund të aplikojë vetëm një herë brenda masës/nën-masës brenda një afati/thirrjeje për aplikim. Nëse aplikacioni aprovohet, aplikuesi duhet të përfundojë këtë projekt para se të aplikojë për projektin tjetër.

3. Kushtet në vijim gjithashtu do të kërkohen për zbatimin e masave të programit

(a) Në rastin e aktiviteteve të ndërtimit/rinovimit/zgjerimit, aplikuesit duhet të dorëzojnë kopjet e skicave të projektit dhe koston e vlerësuar të punimeve dhe materialeve të parashikuara.

(b) Aktivitetet e ndërtimit/rinovimit/zgjerimit duhet të jenë në pajtueshmëri me standardet e përcaktuara të Komunës në përputhje me planet urbane dhe hapësinore dhe/apo standardet tjera të aplikueshme të Komunës;

(c) Aplikuesi duhet të dëshmojë se ai/ajo është pronar i tokës/ndërtesës ku do të bëhet investimi apo që ka të drejtë ta përdorë/merr me qira atë për të paktën 10 vjet. Kontratat e nënshkruara dhe të noterizuara për qiramarrje para periudhës së aplikimit, duhet të mbulojnë periudhën kohore për së paku 5 vite nga dita e aprovimit. Në rast të investimeve, të cilat nënkuptojnë aktivitetet e ndërtimit/zgjerimit, përmirësimin e ujitjes apo mbjelljen e bimëve shumëvjeçare, aplikuesi duhet të dëshmojë pronësinë e tokës/ndërtesës lidhur me investimin në fjalë ose të drejtën për të përdorur atë për të paktën 5 vite nga dita e aprovimit (përveç nëse thuhet ndryshe në masën specifike).

Tokat pyjore (sipas certifikatës së pronësisë) nuk pranohen si tokë bujqësore. Tokat e privatizuara nga AKP-ja, të cilat në certifikatën e pronës paraqiten si "tokë e marrë me qira për 99 vjet" trajtohen si tokë në pronësi të privatizuesit.

(d) Aplikuesi nuk duhet të ketë detyrime të papaguara ndaj shtetit, detyrimeve fiskale, tatimet në pronë ose në të ardhura ose ndonjë obligim tjetër ndaj shtetit.

4. Pagesa e kësteve dhe paradhëniet për mbështetjen e investimeve

Zbatimi i projektit /fillimi i investimeve mund të bëhet vetëm pas nënshkrimit të kontratës me AZHB-në. Pagesa e ndihmës publike do të bëhet në bazë të kërkesës për pagesë dhe kushteve të kërkuara në kontratë.

Pagesa mund të bëhet në dy këste për të gjitha masat, përjashtimisht masa 5, pjesa e parë e përkrahjes publike në vlerë prej 50% bëhet në formë të paradhënies pas nënshkrimit të kontratës me përfituesin me kërkesën e tij (përveç nëse është e caktuar ndryshe në masa), me kusht të sigurimit të garancionit bankar, ndërsa pjesa tjetër e mbetur prej 50%, paguhet pas verifikimit të përfundimit të investimit të përgjithshëm. Nëse përfituesi nuk parashton kërkesë për paradhënie, atëherë pagesa e tërësishme bëhet pas verifikimit të përfundimit të investimit të përgjithshëm. Garancia bankare duhet të sigurohet vetëm për paradhënien prej 50% të përkrahjes publike, përkatësisht deri në aprovimin e pagesës përfundimtare për pagesë/pranim të pagesës ose refuzim të pagesës.

5. Kushtet financiare

Investimi për të cilin përfituesi ka marrë mbështetje nuk duhet të pësojë ndryshim thelbësor brenda pesë (5) viteve nga data kur pagesa përfundimtare është pranuar. Ndryshime thelbësore të një investimi janë ato që rezultojnë në:

- Ndërprerjen ose zhvendosjen e aktivitetit prodhues në një fushë që nuk është e mbuluar me Program.
- Ndryshime në strukturën e pronësisë, që i japin një subjekti apo organi publik një përparësi të pamërituar, ose
- Ndryshim përmbajtësor që ndikon në natyrën, objektivat ose kushtet e implementimit të cilat rezultojnë me ndryshimin e objektivave fillestare.
- Në rast të situatave të jashtëzakonshme që mund të ndikojnë në investim nga fatkeqësitë natyrore, përfituesi duhet të informojë AZHB-në brenda afateve, sipas kontratës së nënshkruar nga të dy palët.
- Përfituesit janë të detyruar të mbajnë të gjitha dokumentet të paktën pesë (5) vite pas zbatimit të projektit, si dhe të bashkëpunojnë me zyrtarët e MBPZHR-së, AZHB-së, Auditorit, organizatave dhe institucioneve të tjera me kërkesë të AZHB-së. Kushtet e financimit do të përcaktohen më hollësisht në kontratë në mes të përfituesit dhe AZHB-së.

Në rast të shkeljes së dispozitave të lartpërmendura, AZHB-ja duhet menjëherë të informojë palën për shkelje të kontratës dhe Zyra ligjore e AZHB-së duhet të fillojë procedurat ligjore sipas legjislacionit në fuqi.

6. Investimet e pranueshme për mbështetje

- (a) Ndërtimi¹/zgjerimi/rinovimi i pronës së paluajtshme;
- (b) Blerja e makinerisë dhe pajisjeve të reja, përfshirë softuerin kompjuterik;
- (c) Blerja e fidanëve të bimëve shumëvjeçare;
- (d) Blerja e mëshqerrave të mbarësuara/lopëve të racës (të matrikuara dhe me pedigree).
- (e) Shpenzimet e përgjithshme që ndërlidhen me shpenzimet e referuara në pikat (a) dhe (b) si më lartë, ku përfshihen shpenzimet për shërbimet e arkitektëve dhe inxhinierëve, shërbimet këshilluese, studimet e fizibilitetit, shpenzimet për marrjen e lejeve dhe licencave, kostot e përgjithshme nuk mund të tejkalojnë 10% (përgatitja e planit të biznesit përfshihet në këtë përqindje) të shpenzimeve të përgjithshme të investimeve të pranueshme.

Shpenzimet për tarifën e arkitektëve, inxhinierëve, studime fizibiliteti, apo konsulencë për përgatitjen e planit të biznesit do të jenë të pranueshme vetëm nëse janë kryer nga profesionistë dhe kompanitë të specializuara të fushës. Përfituesi duhet të ofrojë të dhënat e sakta për ekspertin dhe kompaninë që ofron shërbimin. Si shpenzim i pranueshëm për të gjitha nën-masat do të jetë edhe angazhimi i një studenti në vitin e fundit apo të sapodiplomuarit në fushën e bujqësisë, agroekonomisë apo teknologjisë ushqimore. Vlera e

¹ Përjashtim bëjnë disa nënmasa në të cilat nuk parashihet ndërtimi.

mbështetjes nga MBPZHR do të jetë 2,400 € brenda një viti kalendarik, e dëshmuar përmes kontratës së noterizuar.

Asnjë lloj investimi nuk pranohet të rrefinancohet pa kaluar periudha e amortizimit të plotë të atij investimi (pajisje, makineri, ndërtesa etj.).

AZHB-ja duhet të mbajë një listë të investimeve për secilin fermer dhe gjatë vlerësimit të aplikacionit në vitin aktual duhet të nënshtrohet kontrollit të kryqëzuar në dhjetë (10) vite paraprake për investim të njëjtë për përfituesin e njëjtë.

Vetëm shpenzimet e bëra pas nënshkrimit të kontratës ndërmjet përfituesit dhe AZHB-së, konsiderohen të pranueshme për bashkëfinancim, me përjashtim të shpenzimeve të përgjithshme të cilat janë të pranueshme edhe para nënshkrimit të kontratës, por vetëm për aplikuesit e përzgjedhur.

Përfituesi duhet të sigurojë dokumentacionin e detajuar që arsyeton vërtetësinë dhe vlefshmërinë e shpenzimeve me kërkesën për pagesat e prezantuara në AZHB. AZHB-ja është përgjegjëse për të kontrolluar vërtetësinë dhe vlefshmërinë e shpenzimeve. Në udhëzuesit për fermer, AZHB-ja publikon kriteret e përzgjedhjes dhe dokumentet e nevojshme për arsyetimin e shpenzimeve nga aplikuesi/përfituesi. Një listë e shpenzimeve të pranueshme, e specifikuar, do të ju ofrohet fermerëve si aneks në udhëzuesin për aplikues.

7. Shpenzimet e papranueshme në kuadër të Programit

- (a) Taksat, përfshirë TVSH-në; me përjashtim të TVSH-së së pakthyeshme për personat fizikë dhe ndërmarrjet jo-raportuese të TVSH-së;
- (b) taksat doganore dhe akcizat;
- (c) blerja dhe qiraja e tokës dhe ndërtesave ekzistuese;
- (d) gjobat, ndëshkimet financiare dhe shpenzimet e proceseve gjyqësore;
- (e) shpenzimet operative;
- (f) makineri dhe pajisje e përdorur;
- (g) detyrimet bankare, kamatat, shpenzimet e garantuesit dhe detyrimet e ngjashme;
- (h) kostot e këmbimit, detyrimet dhe humbjet e këmbimit, si dhe shpenzime tjera financiare;
- (i) kontributet në naturë;
- (j) blerja e inputeve bujqësore, bimëve njëvjeçare dhe mbjellja e tyre;
- (k) shpenzimet e mirëmbajtjes dhe amortizimit;
- (l) shpenzimet për pagat e stafit të punësuar për aktivitetet e menaxhimit, implementimit, monitorimit dhe kontrollimit;

Shpenzimet nën pikat (c) dhe (e) përveç blerjes së tokës, janë të pranueshme në kuadër të masës "Implementimi i Strategjive të Zhvillimit Lokal – Qasja LEADER", Përmirësimi i Trajnimit" dhe "Mbështetja për krijimin e grupeve të prodhuesve".

8. Procedura Administrative

- Implementimi i masave sipas këtij Programi fillon me thirrjet e publikuara për aplikim nga AZHB-ja.
- Aplikimi bëhet përmes web-modulit online në web faqen e AZHB-së www.azhb-ks.net, në të cilën gjendet linku "apliko online" që dërgon në modulën e aplikimit online.
- Në web-modul regjistrohet projekti si dhe ngarkohen (upload) dokumentet e nevojshme për aplikim.
- Dokumentet e nevojshme për aplikim (përfshirë formularët e aplikimit, listën e dokumenteve të kërkuara, si dhe modelet e projekt-propozimit dhe planit të biznesit, përfshirë udhëzimet për plotësimin e formularëve dhe udhëzimet tjera për përfituesit) publikohen në formë elektronike në web-faqen e Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë, të MBPZHR-së dhe shtypen si doracak, si kopje fizike.

- Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë procedon aplikacionet e pranuar për aprovim në përputhje me procedurat e brendshme të Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë, duke respektuar rregullat për mbrojtjen e të dhënave personale në përputhje me dispozitat në fuqi.

9. Kontrolllet administrative

Pasi që aplikacioni është hapur, së pari bëhet kontrolli administrativ, me ç'rast kontrollohet përmbushja e kërkesave themelore të pranueshmërisë (si lloji i përfituesit dhe lloji i investimeve të pranueshme), nëse aplikacioni përmban të gjitha dokumentet e nevojshme mbështetëse të obligueshme. Krahas kontrollit administrativ, verifikohet përmbushja e kritereve të pranueshmërisë (si respektimi minimal i standardeve kombëtare, dhe kërkesat tjera të përgjithshme dhe specifike në kuadër të kësaj mase).

10. Verifikimi i shpenzimeve të pranueshme dhe vlerësimi i qëndrueshmërisë ekonomike dhe financiare

Aplikacionet e kompletuara i nënshtrohen vlerësimit të mëtutjeshëm të shpenzimeve të pranueshme dhe vlerësimit të qëndrueshmërisë ekonomike dhe financiare. Pranueshmëria e shpenzimeve kontrollohet duke i krahasuar ato me çmimet referente të aprovuara nga AZHB-ja ose me ofertat nga tregu. Vlera e shpenzimeve të pranueshme verifikohet më tutje nëse korrespondon me vlerën e tregut të artikujve përkatës të dëshmuara përmes tri ofertave të ndryshme nga furnizuesit (për mallrat me vlerë mbi 10,000 €), duke krahasuar me vlerat referente të përcaktuara nga Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë. Shuma e përgjithshme e shpenzimeve të pranueshme të projektit vlerësohet duke krahasuar pragun minimal edhe maksimal të aplikueshëm, të përcaktuar për projektet sipas kësaj mase. Nëse shuma e përgjithshme e shpenzimeve të pranueshme është nën minimum, projekti refuzohet. Nëse vlera e projektit është mbi pragun, projekti mbetet i pranueshëm, ndërsa e gjithë vlera që del përtej pragut duhet të mbështetet plotësisht nga përfituesi.

Vlerësimet e qëndrueshmërisë ekonomike – financiare bëhen për projektet që përmbushin kërkesat e pranueshmërisë dhe që kanë dokumentacionin e kompletuar. Vlerësimi kryhet sipas metodologjisë së Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë për kriteret e qëndrueshmërisë ekonomike dhe financiare.

Ne rastet kur vlera e aplikuar e projektit është mbi 50,000 euro, atëherë aplikuesi duhet të sjellë dëshmi mbi gjendjen financiare të tij. Në rastet kur aplikuesi tashmë është subjekt i regjistruar juridik, ai duhet që si dëshmi t'i ofrojë Pasqyrat financiare nga viti paraprak. Në rastet kur aplikuesi është person fizik, i njëjti duhet të dëshmojë gjendjen në llogarinë e tij bankare për periudhën e fundit 6 mujore.

11. Kontrolllet në terren (On spot)

Projektet e përzgjedhura për financim iu nënshtrohen kontrolleve në terren (on spot), për të verifikuar gjendjen faktike të propozimeve për investime, nëse informacioni në dokumentet e parashtruara korrespondon me gjendjen reale dhe masat tjera. Janë të detyrueshme të paktën 2 inspektime në vend: një para miratimit të projektit dhe një para miratimit të pagesës.

12. Kriteret e përzgjedhjes dhe renditja e projekteve/poentimi

Autoriteti Menaxhues është përgjegjës për përcaktimin e kritereve të pranueshmërisë dhe kritereve të përzgjedhjes.

Kriteret e përzgjedhjes janë kushte që AM-ja duhet t'i përcaktojë për të siguruar prioritetet e financimit të projekteve më të mira që adresojnë nevojat e identifikuara në analizën sektoriale, SWOT analizën, dhe objektivat e përcaktuara në PZHR. Kriteret e përzgjedhjes duhet të jenë të qarta, në përputhje me objektivat, dhe duhet të zbatohen në mënyrë transparente gjatë gjithë periudhës së programimit, dhe kanë për qëllim që të sigurojnë trajtim të barabartë të aplikuesve, shfrytëzim më të mirë të burimeve financiare dhe

orientimin e masave në përputhje me prioritetet e zhvillimit rural të vendit. Kriteret e përzgjedhjes duhet të jenë të përcaktuara qartë para fillimit të procesit të aplikimit për të siguruar trajtim të barabartë të të gjithë aplikuesve potencialë.

Kriteret e përzgjedhjes duhet të sigurojnë:

- Prioritizimi i mbështetjes në përputhje me prioritetet kombëtare/rajonale për zhvillim rural;
- Përdorimi më i mirë i burimeve financiare - vlera më të mira për paratë (p.sh. në lidhje me investimin e propozuar);
- Trajtimi i barabartë (i drejtë) i të gjithë aplikuesve;

Një projekt/aplikacion mund të përzgjidhet për mbështetje vetëm nëse arrin pragun minimal 50 pikë. Pragu minimal vendoset për të siguruar që projektet e përkrahura sjellin vlerë të shtuar të mjaftueshme për sektorin.

13. Aprovimi i projekteve dhe kontraktimi

Procedura e aprovimit nuk duhet të tejkalojë 3 muaj nga data e mbylljes së aplikimit. Nëse projekti apo kërkesa është vlerësuar nga shërbimet e veçanta (ekspert relevant i fushës), shqyrtimi i projektit apo i kërkesës shtyhet derisa shërbimet e veçanta të japin konkluzionet. Aplikuesi njoftohet për propozimin e tij/saj të miratuar me anë të vendimit për miratim të kërkesës/aplikacionit të lëshuar nga AZHB-ja. Së bashku me vendimin, aplikuesi ftohet të nënshkruajë kontratën për bashkë-financim të projektit brenda 5 ditëve pas pranimit të vendimit dhe/apo ftesës. Ftesës për nënshkrimin e kontratës i bashkëngjiten të paktën 4 kopje të kontratës. Vlerësimi i aplikacioneve duhet të fillojë jo më vonë se 7 ditë pas mbylljes së afatit për aplikim.

14. Refuzimi i projekteve

Aplikuesit do të refuzohen në rast se:

- Nuk e kanë të kompletuar dokumentacionin;
- Dështojnë të plotësojnë kriteret e pranueshmërisë;
- Shpenzimet nuk mund të verifikohen si të pranueshme;
- Projekti nuk është i qëndrueshëm ekonomikisht sipas AZHB-së;
- Në rast të mashtrimit në cilëndo fazë të procedurës;
- Nëse projekti i financuar nga përkrahja publike nuk është funksional sipas projektit/plan biznesit dhe kontratës;
- Në rast mos respektimit të kushteve të kontratës për financim të kontratës;
- Aplikuesit të cilët aplikojnë për investime publike gjithashtu do të refuzohen nëse ata dështojnë të kryejnë procesin e prokurimit sipas rregullave të aplikueshme të prokurimit.

Aplikuesi njoftohet për projektin e tij/saj që është refuzuar me anë të vendimit për refuzim të lëshuar nga Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë. Vendimi për refuzim përmban shkaqet e refuzimit.

Aplikuesi ka të drejtë ankese kundër vendimit për refuzim të lëshuar nga Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë. Procedura e ankesës do të shpjegohet në Udhëzimin Administrativ për masat dhe kriteret e përkrahjes për zhvillim rural 2023.

15. Implementimi i projektit

Projekti fillon së implementuari pasi kontrata për bashkë-financim të nënshkruhet dhe mund të ketë kohëzgjatje deri në 1 vit, varësisht nga specifikat e investimit. AZHB mund të delegojë kompetenca të caktuara për zbatimin e programit tek trupat deleguese përmes kontratës me shkrim. Në asnjë rast nuk mund të delegohet procesi i kontraktimit të përfituesve dhe ekzekutimit të pagesave. AZHB mbetet përgjegjëse për kontrollin e

implementimit të programit nga trupat e deleguara. AZHB duhet të kërkojë raporte nga organi delegates për progresin e implementimit të programit. Nëse ka ndërtime, duhet të paraqesë raportin nga mbikëqyrja teknike.

16. Aprovimi i pagesës

Pagesa e fundit për përfituesin do të bëhet në bazë të kërkesave për pagesë, bazuar në deklaratat e shpenzimeve të bëra nga përfituesi dhe të dëshmuara me fatura origjinale.

Kërkesa për pagesë dhe dokumentet shoqëruese u nënshtrohen kontrollove përfundimtare të pranueshmërisë. Pranueshmëria e shpenzimeve të bëra do të kontrollohet në përputhje me dokumentet, dispozitat e kontratës dhe me anë të kontrollove në terren përpara se pagesa të aprovohet.

Pas aprovimit, pagesa do të bëhet në valutë vendore të llogarisë së përfituesit final apo të nënshkruesve të tyre. Asnjë pagesë nuk do të ju bëhet përfituesve për të cilën konstatohet se kanë krijuar kushte artificiale për marrjen e projektit.

17. Kontrollat Ex-post

- Të gjitha projektet e përkrahura me Programin e Zhvillimit Rural u nënshtrohen kontrollit Ex-post për një periudhë pesë (5) vjeçare.
- Gjatë kësaj periudhe, AZHB-ja duhet të bëjë kontrolle për të verifikuar respektimin e kritereve të pranueshmërisë dhe kritereve të selektimit
- Gjatë periudhës së monitorimit/kontrollit Ex-post, përfituesi është i obliguar të mirëmbajë investimin dhe t'u ofrojë qasje zyrtarëve në rast të kontrollit.
- Në rast të mosrespektimit të zbatimit të projektit sipas kontratës nga ana e përfituesit, AZHB-ja është e obliguar që të kërkojë nga përfituesi kthimin e pjesës së bashkëfinancimit nga programi (paranë publike).
- Në rast të mospërputhjeve të vogla që mund të korrigjohen lehtësisht nga përfituesit, mund të jepet një periudhë kohore për përmirësime (detajet duhet të jepen në procedurën operacionale të inspektimeve Ex-post të AZHB-së).

18. Buxheti dhe ndarja në masa

Masat	Përshkrimi i masave	Buxheti/€	%
Masa 1	Investimet në asete fizike dhe në ekonomitë familjare	16,827,000.00	68.33
Masa 3	Investime në asete fizike në përpunim dhe tregtimin e prodhimeve bujqësore	3,500,000.00	14.21
Masa 7	Diversifikimi i Fermave dhe Zhvillimi i Bizneseve	4,000,000.00	16.24
Masa 5	Zbatimi i Strategjive të Zhvillimit Lokal - "Qasja Leader"	300,000.00	1.22
	Totali i Buxhetit	24,627,000.00	100.00

MASA 1: INVESTIMET NË ASETET FIZIKE TË EKONOMIVE BUJQËSORE

1. Baza ligjore

- Ligji nr.08/L-072 për Bujqësi dhe Zhvillim Rural (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/ Nr. 8/ 29 mars 2023);
- Strategjia për Bujqësi dhe Zhvillim Rural 2022-2028, vendim i Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr.12/50, i datës: 23.12.2021;
- Programi Kombëtar për Bujqësi dhe Zhvillim Rural 2023-2027, vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr.15/151, i datës 12.07.2023.

2. Arsyeshmëria

Sektori i bujqësisë ka kontribuar me 6.9% në BPV në vitin 2021². Sektori i bujqësisë në Kosovë luan një rol shumë të rëndësishëm në ofrimin e mundësive në punësim dhe në krijimin e të ardhurave. Me gjithë investimet e bëra në sektorin e bujqësisë gjatë periudhës së kaluar 2014-2020, ende mbetet struktura e pafavorshme e fermës, fermat e vogla e të fragmentuara, prodhuesi jokonkurrent, lidhjet e dobëta me tregjet janë disa nga faktorët që pengojnë zhvillimin e sektorit dhe parandalojnë sektorin nga përmbushja e potencialit të tij të plotë prodhues.

Analiza e aftësisë konkurruese e bujqësisë së Kosovës tregon që aktualisht vetëm një pjesë shumë e vogël e fermave mund të konkurrojnë në tregun rajonal, të BE-së dhe atë ndërkombëtar. Shkaktarët kryesorë të kësaj aftësie të ulët konkurruese janë përmasat e vogla të shumicës së bizneseve bujqësore, fragmentimi i tokës së tyre, ndërtesat dhe pajisjet e vjetra, mungesa e mjeteve financiare për investime dhe niveli i ulët i njohurive lidhur me teknologjinë bashkëkohore të prodhimit. Veç kësaj, shumica e fermave nuk i përmbushin standardet e BE-së për siguri dhe higjienë të ushqimit, për mirëqenie të kafshëve dhe mbrojtje të mjedisit. Duke marrë parasysh faktin se shumica e fermave janë shumë të vogla, duket e arsyeshme që të nxitet edhe bashkëpunimi horizontal ndërmjet bujqve në formën e bashkëpunimit të prodhuesve, i cili mund ta ndërtojë bazën për organizatat e mëvonshme prodhuese, ose shoqatat e prodhuesve, por edhe për integrimin vertikal të bujqve, për shembull në hallkat e tregut përmes kontratave të furnizimit.

Me qëllim të përparimit të metodave të punës dhe zbatimit të inputeve cilësore, do të nxiten fermerët e rinj të moshës prej 18 deri 40 vjeç, të cilët përfaqësojnë bazën për një sektor bashkëkohor dhe inovativ bujqësor. Në bazë të këtij shqyrtimi, por edhe të përparësisë krahasuese të cilën Kosova e ka në disa sektorë siç janë: pemë, perime(përfshirë patatet), qumësht, mish, rrush dhe vezë. Masat do të përqendrohen në përkrahjen e investimeve në rritjen aftësisë konkurruese, në teknologjitë e reja dhe arritjen e standardeve të BE-s.

2.1 Sektori i pemëve

Si rezultat i kushteve të mira klimatike, në shumë rajone të Kosovës kultivohen pemët. Pemët përbëjnë një pjesë të rëndësishme të sipërfaqes së kultivuar, duke zënë rreth 2.4% të saj.

Megjithëse prodhimi vendor në shumicën e prodhimeve është rritur viteve të fundit, ende ka nevojë për vetëmjaftueshmërinë për konsum të freskët e gjithashtu për plotësimin e nevojave të industrisë së agro-përpunuese, gjë që lë hapësirë për zgjerimin e sipërfaqeve me prodhim intensiv të pemëve. Pemët prodhohen shpesh në sipërfaqe mjaft të vogla dhe kërkojnë shumë punë; kjo i përshtatet situatës aktuale të një papunësie të madhe.

Mekanizimi është në nivele të ulëta për shkak të sipërfaqeve të vogla të parcelave, por edhe për shkak të mungesës së mjeteve financiare. Traktorët, plugjet, rimorkiot janë të vjetra dhe

²Raporti i Gjellbër i Kosovës 2022

vetëm fermerët e mëdhenj mund të përballojnë makineri si spërkatës të mirë ose makineri për vjelje. Situata është më e mirë në rastin e fermerëve më të mëdhenj, me pemishte moderne në sipërfaqe 5 ha e sipër.

Momentalisht prodhuesit e pemëve ballafaqohen me disa probleme, si pemishtet e vjetra dhe varietetet me cilësi të dobët, mungesa e mundësive për ujitje, mungesa e sistemeve/rrjetave për mbrojtjen nga breshëri, mungesa e depove për ruajtjen e pemëve, pajisjet e dobëta për klasifikim dhe paketim për tregtimin e pemëve. Tregu kërkon sasi të vazhdueshme dhe konsistente të pemëve me cilësi të lartë. Kështu që, kjo nënmasë kryesisht synon intensifikimin e prodhimit të pemëve në një sipërfaqe më të gjerë dhe arritjen e standardeve të cilësisë së lartë të produkteve. Përfituesit që synojnë këtë nënmasë janë fermat me qëndrueshmëri ekonomike me prodhim të orientuar për treg.

Nënmasa do të përqendrohet në përmirësimin e efikasitetit të prodhimit, duke përkrahur ngritjen/rehabilitimin e sipërfaqeve të reja me pemishte, modernizimin e pajisjeve për kultivim, sistemet për ujitje që kursejnë ujë, sistemin e mbrojtjes nga breshëri dhe makinerinë e përdorur në fermë për ta përmirësuar efikasitetin në fermë si dhe përmirësimin e përgjithshëm të standardeve.

Objektet e magazinimit në vend për pemë janë të kufizuara dhe nëse ka fermerë që i kanë të tilla kapacitete, atëherë janë vetëm fermerët e mëdhenj. Fermerët e vegjël nuk kanë ambiente për depo të ftohta dhe frigoriferë, pasi ato janë tepër të kushtueshme për pronarët e vegjël. Ashtu si objektet e magazinimit, edhe ambientet e paketimit e klasifikimit mungojnë. Do të përkrahet ndërtimi dhe përmirësimi i objekteve për aktivitetet pas vjeljes. Do të përkrahen edhe investimet e mëtejme në shfrytëzimin e energjisë së ripërtëritshme.

2.2 Sektori i perimeve, serrat (përfshirë patatet)

Perimet janë kultura shumë të rëndësishme dhe premtuese në Kosovë. Tradita në kultivimin e perimeve dhe kushtet e mira klimatike u sjell të ardhura edhe fermerëve më të vegjël. Megjithatë janë kultura premtuese, prodhimtaria e perimeve nuk është në nivel të kënaqshëm për shkak të nivelit të ultë të përdorimit të mekanizmit dhe të inputeve cilësore. Sektori i perimtarisë mbulon sipërfaqe prej 8,491 ha në fushë të hapur dhe 562 ha në serra. Perimet kryesore të prodhuara janë: patatet, speci, fasulja, kungulli, qepa, shalqiri, lakra, domatja, trangulli, pjepri, etj. Sektori i perimtarisë ka një numër të vogël të kultivuesve komercialë, kryesisht dominojnë kultivuesit gjysmë-komercial dhe ekzistencial. Në total, sipërfaqja e kultivimit të gjitha perimeve është e ngjashme ndër vite. Pavarësisht kushteve të mira klimatike, rendimenti i perimeve, veçanërisht në fusha të hapura, mbetet i ulët, dhe kjo nuk është vetëm rezultat i strukturës së fermave - fermat e vogla me copëzim të madh toke - por edhe e teknologjisë së vjetruar të prodhimit. Sektori dominohet nga fermat e vogla private, me prodhimtari dhe rendimente të ulëta si dhe zinxhirë joefikas të furnizimit, me shpenzime të larta për grumbullim dhe logjistikë. Tregtimi i perimeve të freskëta shpesh bëhet pa paketim të përshtatshëm dhe pa klasifikim të prodhimeve.

Prodhimi në serra

Sipërfaqet e mbjella me kultura në serra kanë një rritje prej 15 ha nga viti 2020 në vitin 2021. Kulturat të cilat dominojnë në kultivimin në serra gjatë vitit 2021 janë: speci me 173.30 ha, domatja 190.29 ha dhe trangulli me 102.03 ha. Speci, domatja dhe trangulli janë kulturat që dominojnë në kultivim në serra.

Perimet kryesore që kultivohen në serra janë domatja, trangulli, kurse e treta vjen sallata e gjelbër. Mundësi të tjera të mira janë: kultivimi i specit, patëllxhanit, kungullit, pjeprit. Potencial i mirë për kultivim në serra është edhe dredhëza.

Në kuadër të kësaj nënmase, përkrahja do të sigurohet për ndërtimin e serrave të përhershme për prodhimin e pemëve manore dhe perimeve si dhe ndërtimin e depove për trajtim pas vjeljes, për ruajtjen e pemëve dhe perimeve. Nevoja për pemë dhe perime të freskëta gjatë tërë vitit është në rritje. Këtë mungesë në treg mund ta plotësojë më së miri prodhimi në ambiente të mbyllura/mbrojtura.

Tregu kosovar është i furnizuar me pemë dhe perime të freskëta gjatë tërë vitit, kryesisht të importuara nga vende të ndryshme. Rritja e sipërfaqeve me serra i kontribuon edhezëvendësimit të prodhimeve të importuara me prodhime vendore, rrjedhimisht edhe përmirësimit të bilancit tregtar negativ të vendit.

2.3 Sektori i mishit

Sektori i mishit konsiderohet të ketë potencial të mirë, pasi që kërkesa për produkte të mishit është e lartë. Një numër i vogël i fermave janë të fokusuara në majmëri intensive me një numër të ulët krerësh. Pjesa më e madhe e mishit që përdoret për përpunim importohet. Mishi i vëçit është lloji i mishit më i kërkuar në Kosovë, pastaj mishi i shpezëve dhe ai i qengjit.

Mishi i gjedhit tradicionalisht është konsideruar si nënprodukt i sektorit të qumështit. Shumica e vëçave vijnë nga fermat prodhuese të qumështit, d.m.th. nuk ekziston një zinxhir furnizimi i mishit, i kompletuar dhe specializuar. Stallat për majmëri janë kryesisht objekte të konvertuara nga objektet për prodhimin e qumështit ose objekte të ndërtuara nga vetë fermerët e vegjël. Sektori i prodhimit të mishit në Kosovë është i dominuar nga fermat me tufa me më pak se 9 krerë. Në vitin 2021, fermat vendore të bagëtive furnizuan 44% të nevojës së tregut të Kosovës për mish gjedhi, ndërsa pjesa e mbetur prej rreth 56% u importua.³

Prodhimi i mishit të shpendëve aktualisht është shumë i ulët dhe në vitet e fundit është zvogëluar. Zinxhiri i marketingut të mishit të shpendëve në Kosovë nuk është i organizuar. Njëri nga prodhuesit më të mëdhenj të mishit të pulës, shitjen e realizon përmes pikave të shitjes të organizuara nga vetë prodhuesi.

Me rritjen ekonomike pritet të rritet kërkesa për konsum të mishit të freskët dhe produkteve të mishit në Kosovë. Importet e mishit dhe të të brendshmeve ushqimore janë vazhdimisht në rritje. Rritja e importeve në vitin 2021 ishte 28.7% krahasuar me vitin 2020. Prodhimi lokal i të gjitha kategorive të mishit është relativisht i vogël në krahasim me kërkesat e tregut të brendshëm.

Mbarështuesit e gjedheve për mish gjithashtu kanë nevojë për investime në stalla dhe objekte përcjellëse. Investimet në makineri të fermës për prodhim të ushqimit për kafshë dhe investimet në menaxhimin e mbetjeve dhe plehut gjithashtu kanë prioritet. Ka nevojë për ndërtimin e stallave të reja moderne dhe objekteve të fermave për mbarështim të kafshëve për mish, në përputhje me standardet ekzistuese për mirëqenie të kafshëve dhe mjedis. Janë të nevojshme pajisje për fermë si: sistemi i furnizimit me ujë, sistemi i të ushqyerit, largimi i plehut të stallës, makineria e fermës, sidomos për prodhimin, ruajtjen, përgatitjen, përdorimin dhe shpërndarjen e ushqimit të kafshëve.

Rëndësia e sektorit të derrarisë në Kosovë vazhdon të mbetet e ulët në krahasim me sektorët e tjerë blegtoral, ku kategoria e derrave përbën vetëm 8% nga gjithsej numri i kafshëve.

Sipas Regjistrimit të Bujqësisë (2014) në Kosovë janë 6,302 ekonomi bujqësore që mbajnë 34,188 derra apo mesatarisht 5 krerë për ekonomi bujqësore. Në vitin 2021 numër i derrave kishte arritur 47,384 krerë. Shumica e këtyre ekonomive kanë nevojë për investime në stalla moderne dhe objekte përcjellëse me qëllim të shtimit të numrit dhe përmirësimit të kushteve për shëndet dhe mirëqenie të kafshëve.

2.4 Sektori i qumështit

Qumështi i lopës është prodhimi më i rëndësishëm blegtoral. Viteve të fundit janë bërë përpjekje që prodhimi i qumështit të kalojë nga prodhimi për nevoja familjare në prodhim për treg. Sasia e prodhuar/dorëzuar e qumështit vazhdon të jetë e ulët dhe nuk i plotëson nevojat e tregut dhe kapacitetet përpunuese, çka po i shtynë përpunuesit që të importojnë qumësht. Me përmirësimin e kushteve të mbarështimit, duke zbatuar praktikën e mira bujqësore në fermat prodhuese të qumështit, do të rritet kapaciteti prodhues i fermave dhe qumështi

³ Raporti i gjelbert 2022

do të ketë cilësi të lartë. Me qëllim të rritjes së kapaciteteve prodhuese për qumësht, këtë vit Ministria do të përkrahë edhe rritjen e fondit blegtoral.

Cilësia jo e kënaqshme e qumështit të freskët ka shtyrë MBPZHR-në në zbatimin e skemës së pagesave direkte për cilësi. Ende ka mjaft hapësirë për përmirësim në asetet fizike, siç janë objektet më të mira, pajisje më bashkëkohore të stallave, sisteme më të mira dhe më bashkëkohore të mjeljes. Duke krijuar qendra të reja për grumbullimin e qumështit përfermer me pajisje ftohëse të qumështit, efikasiteti i mbledhjes së qumështit do të rritet, ndërsa cilësia e tij do të përmirësohet.

Derisa një pjesë e pikave të grumbullimit përmbushin standardet e sigurisë ushqimore, ato ende kanë nevojë për investime që të arrijnë të përmbushin dhe rrisin standardet e sigurisë ushqimore. Paralelisht me intensifikimin e prodhimit, duhet të ruhet edhe mjedisi nga ndikimi negativ i prodhimit. Me qëllim të mbrojtjes së ujërave nëntokësore nga ndotja prej plehut të lëngët, ndërtesat e stallave të reja janë të detyruar të ndërtojnë edhe depo të plehut.

Prodhimi i qumështit nga ripërtpësit e vegjël (dele dhe dhi) është kryesisht cikël i mbyllur, nga prodhimi i qumështit, te përpunimi i djathit dhe shitja (marketingu) në fermë. Shumica e prodhuesve që mbajnë ripërtpës të vegjël janë ferma të vogla me praktika kryesisht tradicionale të mbarështimit të kafshëve. Përprojekjet për zhvillimin dhe modernizimin e fermave janë të pamjaftueshme: pranimi i ngadalshëm i teknologjisë (p.sh., përdorimi i pajisjeve të mjeljes); strehimi i papërshtatshëm i kafshëve, zakonisht me nivel të ulët të mirëqenies. Ky sektor ka nevojë të madhe për investime në modernizimin e stallave, objekteve përcjellëse infrastrukturore, për përdorimin e sistemeve të mjeljes, etj.

2.5 Sektori i rrushit

Ngastrat e vreshtave kryesisht janë të vogla, ndërsa rrushi prodhohet në 3,471 ha me vreshta. Madhësia mesatare është 0.5 ha, me rendiment mesatar prej 7.6 t/ha. Kosova ka 938 ha vreshta me rrush tryeze, me një prodhimtari vjetore prej 7,435 t, ku arrihet që konsumi të mbulohet me 72% dhe 2,533 ha vreshta me rrush për verë, me një prodhimtari prej 19,091/t rrush për verë.⁴ Shpenzimet e prodhimit janë të larta, pjesërisht për shkak të vreshtave të vjetra, ngastrave të vogla dhe mekanizimit të vjetër. Rrushi i tryezës i prodhuar në vend, ballafaqohet me konkurrencë të fortë nga importi i cili është i kategorizuar dhe paketuar mirë. Prioritet do t'i jepet prodhimit të rrushit të tryezës, por pa e lënë anash edhe prodhimin e rrushit të verës. Investimet në ristrukturimin dhe modernizimin e prodhimit dhe tregtimit të rrushit janë të nevojshme për të konkurruar me prodhimet e importuara.

Sektori i rrushit ka nevojë për zgjidhje specifike; për rrushin e tryezës mënyra e duhur do të ishte mbjellja e vreshtave të rinj dhe rimbjellja e varieteteve moderne pa fara, ujitja pikë-pikë (kur është e nevojshme), vendosja e rrjetave të breshrit, pajisja me frigoriferë ose depo tëftohta për ruajtjen e rrushit pas vjeljes.

2.6 Sektori i vezëve

Sektori i prodhimit të vezëve është i konsoliduar relativisht mirë. Prodhimi i vezëve në fermat komerciale vlerësohet të jetë rreth 419.9 milionë vezë (2021) ndërsa në kuadër të ekonomive familjare prodhohen rreth 131 milionë vezë, që rezulton me një prodhimtari totale prej 550.9 milionë vezë. Konsumi mesatar për kokë banori llogaritet të jetë rreth 239 vezë/vit, dhe mund të themi se Kosova plotëson rreth 99 % të nevojave për konsum të vezëve.

Cilësia e vezëve të pulave është e mirë, andaj sektori i vezëve ka potencial për zgjerim në tregun e huaj. Shumica e prodhuesve e aplikojnë sistemin e mbajtjes në kafaze konvencionale. Me qëllim të mbrojtjes së shëndetit dhe mirëqenies së kafshëve, njëkohësisht dhe përmbushjes së standardeve europiane, do të investohet vetëm në kafaz të përmirësuar

⁴ Raporti i gjelbert 2022

(sipas standardeve të BE-së) apo në mbajtje në dysheme dhe në sistem të lirë të mbajtjes në natyrë. Për ta përmirësuar efikasitetin e prodhuesve mesatarë, prioritet do t'i jepet fermave të mesme me nga 5,000 deri 25,000 pula vojse, të cilat mund t'i përballojnë lëvizjet e mëdha të çmimeve përgjatë viteve dhe të konkurrojnë në tregun dinamik.

Do të sigurohet përkrahje për ta përmirësuar efikasitetin e prodhimit duke investuar në pajisje më të mira për stallë dhe higjienë në stallë (ajrosje, sistem të ujit, sistem të grumbullimit të vezëve, etj.). Duhet të përmirësohet menaxhimi i plehut të stallës dhe mbetjeve të tjera, pasi që ndikimi negativ i shpeztarisë intensive në mjedis mund të jetë i lartë nëse nuk trajtohet si duhet. Shërbimet këshilluese në Kosovë duhet të përmirësohen ashtu që t'u ofrojnë trajnim përkatës prodhuesve të mesëm dhe të vegjël në prodhimin e ushqimit të kafshëve, operimin dhe mirëmbajtjen e linjave gjysmë-automatike për grumbullimin dhe kategorizimin e vezëve.

3. Objektivat e përgjithshme

- Rritja e efikasitetit, aftësisë konkurruese dhe prodhim më i qëndrueshëm bujqësor në sektorin e agro - ushqimit, p.sh., me përafrimin progresiv me standardet e Unionit, duke forcuar pozicionin e fermerëve në zinxhirin ushqimor dhe duke mbështetur fermerët e rinj në krijimin e vendeve të punës.
- Përmirësimi i reagimit të sektorit agro-ushqimor ndaj kërkesës publike për ushqime me cilësi të lartë, të sigurta, ushqyese dhe të qëndrueshme, si dhe mirëqenie optimale të kafshëve.
- Të kontribuojë në zbutjen e ndryshimeve klimatike, si dhe në prodhimin e energjisë së qëndrueshme, dhe të nxisë menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore, siç janë uji, toka dhe ajri.

3.1 Objektivat specifike

Sektori i pemëve dhe sektori i perimeve (përfshirë patatet):

- Të rrisë prodhimin e pemëve dhe perimeve (përfshirë patatet dhe fidanët për perime në serra) për qëllime komerciale;
- Përmirësimi i cilësisë dhe sigurisë me qëllim të përmbushjes së standardeve përkatëse kombëtare dhe të atyre të BE-së;
- Modernizimi i fermave përmes përdorimit të pajisjeve të reja, mekanizimit modern, sistemeve të ujitjes dhe digjitalizimi i fermës;
- Zvogëlimi i humbjeve pas vjeljes nëpërmjet investimeve në fermë, në teknologjinë e ruajtjes, në infrastrukturë dhe pajisje për fazën pas vjeljes, përfshirë kapacitetet për ftohje, klasifikim dhe paketim;
- Mbështetja në krijimin e vendeve të punës në fermë;
- Ruajtja dhe përdorimi efikas i inputeve dhe pajisjeve bujqësore në fermë;
- Mbrojtja e mjedisit dhe adresimi i ndryshimeve klimatike;
- Përmirësimi i zinxhirit të vlerës (integritet të fermerëve me blerësit e prodhimeve të tyre).

Sektori i qumështit dhe sektori i mishit:

- Rritja e prodhimit në fermat e specializuara;
- Rritja e fondit blegtoral dhe përmirësimi racor;
- Përmirësimi i cilësisë dhe sigurisë me qëllim të përmbushjes së standardeve kombëtare dhe të atyre të BE-së;
- Modernizimi i fermave përmes përdorimit të pajisjeve të reja, mekanizimit modern, pajisjeve për menaxhimin e mbetjeve dhe digjitalizimi i fermës;
- Zvogëlimi i lirimit të oksidit të azotit dhe metanit përmes trajtimit të duhur të plehut organik dhe evitimi i ndotjes së ujërave mbitokësore dhe nëntokësore;
- Mbështetja në krijimin e vendeve të punës në fermë;
- Ruajtja dhe përdorimi efikas i inputeve dhe pajisjeve bujqësore në fermë;

- Prodhimi i energjisë së ripërtëritshme;
- Mbrojtja e mjedisit dhe adresimi i ndryshimeve klimatike;
- Përmirësimi i zinxhirit të vlerës (integrimi i fermerëve me blerësit e prodhimeve të tyre).

Sektori i rrushit:

- Rritja e prodhimit të rrushit të tryezës dhe rrushit të verës;
- Përmirësimi i cilësisë dhe sigurisë me qëllim të përmbushjes së standardeve kombëtare dhe të atyre të BE-së;
- Modernizimi i fermave përmes përdorimit të fidanëve cilësorë dhe mekanizimit modern, duke përfshirë përdorimin e plehrave dhe pesticideve, si dhe digjitalizimi i sektorit;
- Mbështetja në krijimin e vendeve të punës në fermë;
- Ruajtja dhe përdorimi efikas i inputeve dhe pajisjeve bujqësore në fermë;
- Mbrojtja e mjedisit dhe adresimi i ndryshimeve klimatike;
- Përmirësimi i zinxhirit të vlerës (integrimi i fermerëve me blerësit e prodhimeve të tyre).

Sektori i vezëve:

- Përmirësimi dhe zgjerimi i kapaciteteve ekzistuese prodhuese;
- Përmirësimi i cilësisë dhe sigurisë me qëllim të përmbushjes së standardeve kombëtare dhe të atyre të BE-së;
- Modernizimi i fermave përmes përdorimit të pajisjeve të reja, mekanizimit modern dhe digjitalizim i sektorit;
- Zvogëlimi i lirimit të oksidit të azotit dhe metanit përmes trajtimit të duhur të plehut organik;
- Mbështetja në krijimin e vendeve të punës në fermë;
- Mbrojtja e mjedisit dhe adresimi i ndryshimeve klimatike;
- Prodhimi i energjisë së ripërtëritshme;
- Përmirësimi i zinxhirit të vlerës (integrimi i fermerëve me blerësit e prodhimeve të tyre).

4. Lidhja e masës me masat tjera të Programit

Duke e mbështetur Masën 1 “Investimet në asetet fizike të ekonomive bujqësore”, sigurohet lënda e parë për industrinë përpunuese, e cila mbështetet në kuadër të Masës 3 “Investimet në asetet fizike për përpunimin dhe tregtimin e prodhimeve bujqësore”. Agrobizneset si përpunues të lëndës së parë, e sigurojnë tregun për fermerët.

Gjatë zbatimit të Masës 1, njëkohësisht bëhet edhe plotësimi i disa kërkesave që rrjedhin nga Masa 4 “Masa për agro-mjedis, klimë dhe bujqësi organike”. Fermerët me sipërfaqe të vogël prodhuese, prodhimet e veta mund t’i plasojnë edhe tek përfituesit e Masës 7 “Diversifikimi i fermave dhe zhvillimi i bizneseve”.

5. Përfituesit

- Përfituesit nën këtë masë janë fermerët, sipas përkufizimit në Ligjin Nr.08/L-072 për Bujqësi dhe Zhvillim Rural,
- Të gjithë aplikuesit e kësaj mase duhet të jenë të regjistruar në Regjistrin e Fermës. Certifikata e Numrit Identifikues të Fermës (NIF) duhet të jetë në emër të aplikuesit.
- Nëse aplikuesi është ndërmarrje, edhe certifikata e NIF-it duhet të jetë në emër të ndërmarrjes.
- Të gjithë përfituesit e projekteve të zhvillimit rural obligohen t’i mirëmbajnë investimet e tyre sipas projektit të miratuar gjatë 5 viteve pas ekzekutimit të pagesës

së fundit nga AZHB. Nëse nuk i mirëmban investimet, përfituesi obligohet ta kthejë shumën e financuar të përkrahjes publike.

- Aplikuesi mund të aplikojë sërish vetëm pasi të ketë përfunduar zbatimin e projektit aktual.

6. Kriteret e përbashkëta të pranueshmërisë

- Nëse aplikuesi është person fizik, ai duhet të jetë së paku 18 vjeç, por që nuk i ka mbushur 65 vjet. Në rastin e ndërmarrjeve ky kriter nuk aplikohet;
- Personi fizik duhet ta ketë të përfunduar së paku shkollimin e detyrueshëm elementar (8 ose 9 vjeçar). Aplikuesi duhet të ketë së paku dy (2) vjet përvojë pune në lëmin në të cilën aplikon, kurse ata që nuk kanë përvojë pune dy vjeçare, duhet të ndjekin kurse trajnimi me së paku 20 orë mësimi në fushën për të cilën aplikojnë, e të cilat do t'i përfundojnë para kërkesës për pagesën e fundit;
- Në rastin e ndërmarrjeve, kërkesa e sipërpërmendur vlen për pronarin, për të punësuarin ose për personin e autorizuar të ndërmarrjes. I punësuarin ose personin e autorizuar duhet të ketë kontratë pune së paku edhe për pesë (5) vite pas momentit të aplikimit;
- Aplikuesit duhet t'i kenë të rregulluara detyrimet tatimore dhe atë:
- ✓ Personat fizik, tatimin në pronë, kurse
- ✓ Ndërmarrjet, tatimin në të ardhura të korporatave;
- Nëse toka ose ndonjë pronë tjetër në të cilën do të bëhet investimi është në bashkëpronësi, aplikuesi duhet të sjellë pëlqimin e bashkëpronarëve me kopje të letërnjoftimeve;
- Në rast se toka në certifikatën e pronësisë është mal ose tokë pyjore dhe në terren është tokë bujqësore, aplikuesi duhet paraprakisht ta ndërrojë destinimin e tokës në kadastrë dhe pastaj të aplikojë;
- Në rastet e tokave të marra me qira nga APK apo AKP, pranohen edhe tokat pyjore me kusht që në aplikacion të bashkëngjitet një vërtetim nga APK apo AKP se toka në fjalë është tokë bujqësore;
- Përfituesit të cilët në planin e biznesit janë zotuar të kenë të punësuar, duhet të regjistrohen në ARBK së paku si Biznes Individual dhe të gjitha pagesat duhet të bëhen nga llogaria e biznesit;
- Të bëhet digjitalizimi në vendin ku bëhet investimi.
- Të gjithë aplikuesit (përfituesit) e projekteve në vlerë mbi 50,000 euro, janë të obliguar që së paku për 1 vit kalendarik nga dita e nënshkrimit të kontratës, të angazhojnë të paktën një person të diplomuar apo student që vijon vitin e fundit të studimeve në shkencat bujqësore ose agroekonomi, me qëllim të realizimit të praktikës së punës. Personi i angazhuar duhet të jetë me përgatitje profesionale të njëjtë ose të përafërt me sektorin, e dëshmuar përmes kontratës së noterizuar.

6.1 Qëndrueshmëria ekonomike

Aplikuesi duhet të dëshmojë qëndrueshmërinë ekonomike të fermës përmes planit të biznesit, për rezultatet që synon të arrijë deri në fund të periudhës së investimeve. Kriteret që do të përdoren nga AZHB për të vlerësuar qëndrueshmërinë ekonomike janë rrjedha e parasë dhe kthimi i investimit. Në rastet kur vlera e propozuar e projektit është mbi 50,000 euro, atëherë aplikuesi duhet të sjellë dëshmi mbi gjendjen financiare të tij. Në rastet kur aplikuesi veç është subjekt i regjistruar juridik, ai duhet që si dëshmi të ofrojë pasqyrat financiare nga viti paraprak. Në rastet kur aplikuesi është person fizik, i njëjti duhet të dëshmojë gjendjen në llogarinë e tij bankare për periudhën e fundit 6 mujore.

Mënyra se si dëshmohet qëndrueshmëria ekonomike do të shpjegohet në udhëzuesin për aplikues, i cili përgatitet nga AZHB. Fondet e AZHB-së të dhëna për përfituesin duhet të merren parasysh kur llogaritet qëndrueshmëria ekonomike e përfituesit.

Në rast të investimeve më të vogla ose baras me 20.000 euro, është e pranueshme një formë

e thjeshtuar e një plani të biznesit ose projekt-propozimi, i cili ruan parashikimet e qëndrueshmërisë financiare/ekonomike. Aplikuesi duhet ta dorëzojë projekt/propozimin sipas modelit që do të publikohet në web-faqet e AZHB-së dhe MBPZHR-së. Projekt-propozimi duhet të përfshijë edhe rrjedhën e parasë dhe tabelën e kthimit të investimit. Për projektet investuese në të cilat investimet e pranueshme janë më të mëdha se 20,000 €, aplikuesit duhet ta dorëzojnë një plan të biznesit sipas modelit që do të publikohet në web-faqet e AZHB-së dhe MBPZHR-së.

Plani i biznesit është dokumenti kryesor për vlerësimin e qëndrueshmërisë ekonomike. Investimet e planifikuara duhet të jenë në përputhje me kapacitetin prodhues. Gjatë vlerësimit të aplikacioneve, duke u bazuar në planin e biznesit, zyrtarët e AZHB-së janë të obliguar të refuzojnë pjesën e investimeve të cilat janë në kundërshtim me këtë parim. Qëndrueshmëria ekonomike dhe financiare vlerësohet në bazë të projekt-propozimit ose planit të biznesit. Plani i biznesit duhet të tregojë qëndrueshmërinë ekonomike të fermës/ndërmarrjes në fund të realizimit të investimit.

6.2 Standardet Kombëtare/BE

Standardet kombëtare për shëndetin e kafshëve, mirëqenien e kafshëve dhe mbrojtjen e mjedisit janë paraqitur në udhëzuesin për aplikues. Ato duhet të përmbushen më së voni para kërkesës për pagesën e fundit dhe të verifikohen me rastin e kontrollit të personit zyrtar në vendin e investimit.

Në rast të investimeve në pemishte dhe vreshta të reja, para nënshkrimit të kontratës për bashkëfinancim, përfituesi i grantit duhet të sjellë analizat kimike dhe fizike të tokës me rekomandim pozitiv për përshtatshmërinë për investimin e paraparë. Në rast se rekomandimi është negativ, refuzohet dhënia e grantit.

6.3 Kriteret tjera të pranueshmërisë

- Përfituesit e projekteve me vlerë të investimeve të pranueshme në vlerë më të madhe se 30,000 €, ose përfituesit të cilët në planin e biznesit kanë deklaruar punëtorë të rinj dhe për të cilët janë poentuar, para nënshkrimit të kontratës me AZHB-në, duhet t'i regjistrojnë ndërmarrjet si person juridik apo biznes individual, ndërsa investimet/shpenzimet e zbatimit të projektit duhet të faturohen në emër të biznesit;
- Projektet e financuara nga Programi i Zhvillimit Rural 2023 nuk lejohet të jenë të financuara edhe nga Zyra e BE-së në Kosovë apo ndonjë donator tjetër publik vendor ose ndërkombëtar. Në rast se vërtetohet se përfituesi ka përfituar përkrahje për projektine njëjtë edhe nga ndonjë donator tjetër, atij nuk i jepet përkrahja ose nëse e ka marrë atë, ai do të detyrohet t'i kthejë mjetet e marra, si dhe ndaj tij do të zbatohen masat ndëshkimore në përputhje me ligjin;
- Aplikuesit nuk mund t'i jepet një projekt i ri nëse nuk e ka përfunduar investimin paraprak.
- Nëse përfituesi potencial ka qenë paraprakisht përfitues i ndonjë projekti nga MBPZHR në (5) pesë vitet e fundit dhe ndodhet në periudhën monitoruese, para nënshkrimit të kontratës së re me AZHB-në duhet të bëjë një kontroll në mënyrë që të bëhet verifikimitë projektit të mëparshëm. Nëse projekti nuk është mirëmbajtur dhe/ose nuk është funksional, nuk mund të lidhet kontrata e re;
- Të gjitha asetet që kanë të bëjnë me investimin dhe për të cilat ka rubrika përkatëse në aneksin e NIF-it duhet të jenë të regjistruara në Regjistrin e Fermës;
- Të gjitha kontratat e qiramarrjes duhet të jenë të noterizuara apo të vërtetuara nga gjykata, përveç kontratave të qiramarrjes me Agjencionin e Pyjeve të Kosovës (APK), Agjencionin e Kosovës për Privatizim (AKP) apo me Komuna, të cilat nuk ka nevojë të jenë të noterizuara;
- Tokat e privatizuara nga AKP-ja, të cilat në certifikatën e pronës paraqiten si "tokë e marrë me qira për 99 vjet", trajtohen si tokë në pronësi të privatizuesit. Edhe tokat e blera nga privatizuesit trajtohen si tokë në pronësi të blerësit;

- Tokat me komasacion të papërfunduar pranohen me vendime të organit kompetent, pra edhe pa certifikatë të pronës;
- Vendi/Toka nën hipotekë ku realizohet investimi, nuk është e pranueshme për investim, qoftë në pronësi apo e marrë me qira.
- Nëse nga një parcelë është dhënë me qira vetëm një pjesë e saj, aplikuesi para aplikimit duhet të bëjë digjitalizimin e pjesës së dhënë me qira dhe një kopje fizike të pjesës së digjitalizuar t'ia bashkojë dosjes së aplikimit;
- Në rast se ngastrat janë ngjitur fizikisht me njëra-tjetrën pranohen si një ngastër, qoftë edhe në rastet kur njëra është me qira dhe tjetra në pronësi;

Në rastin e projekteve që parashohin ndërtim, zgjerim, rinovim ose vetëm në pajisje aplikuesit me rastin e aplikimit duhet të dorëzojnë;

- Certifikatën e pronësisë (Fletën poseduese) të parcelës në të cilën do të bëhet investimi (në rastet kur toka/objekti është marrë me qira, fleta poseduese e tokës ku është toka/objekti duhet të jetë në emër të qiradhënësit).
- Në rast se toka/objekti është marrë me qira, kërkohet kontrata e noterizuar e qirasë për së paku 10 vjet. Nëse kontrata është nënshkruar dhe noterizuar para datës së aplikimit, duhet të mbulojë periudhën kohore për së paku 5 vite nga dita e aprovimit;
- Kontrata e noterizuar duhet të përmbajë edhe pëlqimin e pronarit (qiradhënësit), për investimin që do të bëhet në tokën/objektin e tij;
- Nëse toka/objekti në të cilën do të bëhet investimi është në bashkëpronësi, aplikuesi duhet të sjellë pëlqimin e bashkëpronarëve dhe kopjet e letërnjoftimeve;
- Kopjen e planit të parcelës ku do të bëhet investimi;
- Kopjen e skicave të objektit;

Përpos këtyre dokumenteve, në rast të ndërtimit, zgjerimit apo rinovimit të objekteve nevojiten edhe këto dokumente shtesë:

- Paralogaria e shpenzimeve të materialit dhe të punëve të parapara;
- Dokument i përgatitur i veçantë (jo pjesë e planit të biznesit) nga vetë aplikuesi ose me ndihmën e ndërtuesit;
- Pëlqimi i Komunës që dëshmon se në rast të dhënies së grantit, aplikuesi mund të marrë leje ndërtimi;
- Në rast të ndërtimit, zgjerimit apo rinovimit të objekteve, të ngritjes së pemishtes, vreshtit dhe/apo vendosjes së sistemit të ujitjes në toka të marra me qira, kontrata për qiramarrje duhet të jetë për së paku 10 vjet duke llogaritur nga viti i aplikimit. Kontratat për qiramarrje të nënshkruara dhe të noterizuara para periudhës së aplikimit, duhet të mbulojnë periudhën kohore prej së paku 5 vitesh nga dita e aprovimit;
- Kontrata duhet të përmbajë edhe pëlqimin e pronarit (qiradhënësit) për investimin që do të bëhet në tokën e tij;
- Kontrata për qiramarrje nuk kërkohet vetëm në rastet kur pronari i tokës dhe aplikuesi janë në bashkëpronësi, në marrëdhënie bashkëshortore apo në vijë të drejtë të gjakut pa kufij (p.sh.: stërgjyshërit, gjyshërit, prindërit, fëmijët, nipërit, mbesat në bazë të ligjit në fuqi), dhe kjo dëshmohet përmes certifikatës së martesës, apo certifikatës së lindjes apo certifikatës së vdekjes. Po ashtu, aplikuesi duhet të plotësojë Deklaratën nën betim, me të cilën dëshmon se ai është trashëgimtar potencial i tokës;
- Përfituesi, me rastin e parashtrimt të kërkesës për pagesë në AZHB, njëkohësisht duhet të dorëzojë edhe lejen për ndërtim nga organi kompetent i Komunës në rast të ndërtimit apo zgjerimit;
- Të gjithë përfituesit të cilët në planin e biznesit të tyre kanë deklaruar se do të krijojnë vende të reja të punës dhe për këtë kanë përfituar pikë gjatë vlerësimit, obligohen t'i krijojnë ato dhe ta dëshmojnë me pagesën e kontributit pensional dhe tatimit në pagë, duke filluar të paktën nga muaji i fundit para dorëzimit të kërkesës për pagesën e

fundit. Përfituesit janë të obliguar të mbajnë këto vende pune të plotësuara me punëtorë me orar të plotë për aq sa zgjatë periudha monitoruese.

Para kërkesës për pagesë në Agjencinë për Zhvillimin e Bujqësisë, përfituesi duhet të dorëzojë:

- Lejen për ndërtim nga organi kompetent (Komuna); kjo nuk kërkohet për projektet e rinovimit;
- Në rastet e ndërtimeve/zgjerimeve me sipërfaqe të bazës mbi 10m² kërkohet leja e ndërtimit;

6.4 Investimet në prodhimin e energjisë së ripërtëritshme

Në kuadër të këtij investimi mbështetet prodhimi i energjisë elektrike nga burimet ripërtëritshme për "vetë-konsum"(d.m.th. energjia elektrike e prodhuar/depozituar në rrjet është mesatarisht e barabartë me energjinë elektrike të shpenzuar gjatë vitit). Kjo justifikohet me faktin se, meqenëse energjia elektrike nuk mund të ruhet, ajo nëse nuk harxhohet, mund të lëshohet në rrjet, rrjeti i energjisë elektrike mund të konceptohet si një vend depozitimi për energjinë elektrike ku futet dhe tërhiqet gjatë vitit në sasi të ngjashme dhe me një ritëm të ndryshëm.

Koncepti i "vetë-konsumit" duhet të kontrollohet në fazën në të cilën paraqitet/vlerësohet një projekt. Investimi konsiderohet i pranueshëm kur kapaciteti (teorik) i energjisë i impiantit të energjisë së ripërtëritshme ("investimi") nuk tejkalon 120% të konsumit mesatar prej 3 vitesh të ekonomisë familjare.

Në rastin e fermave të reja ose në rastet e fermave që kanë ndryshuar në mënyrë thelbësore madhësinë e veprimtarisë së tyre në tri vitet e fundit, konsumi i pritshëm duhet të vlerësohet nga AZHB-ja.

7. Kriteret e veçanta të pranueshmërisë

Spektori i pemëve (molla, dardha, kumbulla, vishnja, arra, lajthia, gështenja, qershia, kajsia, pjeshka, ftoni, dredhëza, mjedra, manaferra, boronica dhe aronia).

- Në momentin e aplikimit për investime në sektorin e pemëve, aplikuesit duhet të dëshmojnë se kanë sipërfaqe të tokës bujqësore në pronësi, të trashëguar apo të marrë me qira, së paku 1 hektar për pemë drufrutore (molla, dardha, kumbulla, vishnja, arra, lajthia, gështenja qershia, kajsia, pjeshka dhe ftoni) dhe/ose 0.25 hektar për pemë manore (dredhëza, mjedra, boronica, manaferra dhe aronia). Sipërfaqja minimale e ngastrës për pemë manore duhet të jetë 0.10 hektar dhe përpemë drufrutore 0.35 hektar;
- Përfituesit për ngritje të pemishteve të reja, para kërkesës për pagesë, nëse blejnë fidanë të prodhuar në Kosovë, duhet të dorëzojnë kopjen e certifikatës fito-sanitare mbi gjendjen shëndetësore të materialit fidanor që përmbush kriterin CAC (Conformitas Agraria Communitatis) dhe kopjen e licencës së prodhuesit, kurse ata që blejnë fidanë të importuar nga vendet e BE-së, duhet të dorëzojnë kopjen e certifikatës fito-sanitare mbi gjendjen shëndetësore të materialit fidanor që përmbush së paku kriterin CAC të lëshuar nga prodhuesi, certifikatën për prejardhjen e origjinës dhe lejen e importit të ndërmarrjes importuese;
- Fidanët e mbjellë të pemëve drufrutore duhet të kenë të ngjitur në trup etiketën e institucionit certifikues;
- Vetëm për aplikuesit tre (3) e më shumë hektarë sipërfaqe me në pronësi, të trashëguar apo të marrë me qira, me pemë drufrutore dhe manore, lejohet aplikimi për ndërtimin e objekteve për veprimet pas vjeljes, si depo ftohëse, makineri për klasifikim, pastrim, paketim;
- Investimet për blerje të traktorit për pemët drufrutore, lejohen vetëm për aplikuesit me sipërfaqet ekzistuese prej 3 (tre) e më shumë hektarësh në momentin e aplikimit;

Sektori i perimeve, serra, serra për fidanë (përfshirë patatet)

- Në momentin e aplikimit për investime në depo për perime (përfshirë patatën), aplikuesit duhet të dëshmojnë se kanë së paku 3 hektarë sipërfaqe të tokës bujqësore në pronësi, të trashëguar apo të marrë me qira;
- Në momentin e aplikimit për investime në serra të reja të përhershme, aplikuesi duhet të dëshmojë se ka së paku 0.10 hektar tokë të punueshme të regjistruar në Regjistrin e Fermave. Madhësia minimale e një serre të pandarë është 0,10 ha.

Sektori i mishit

- Për investime në sektorin e mishit (majmëria e viçave dhe derrave), aplikuesit nuk janë të obliguar të kenë viça/derra në momentin e aplikimit, por para kërkesës për pagesën e fundit duhet të kenë së paku 20 krerë viça, ose 40 derra për trashje me matrikuj të Republikës së Kosovës, të regjistruar në Regjistrin e Identifikimit të Kafshëve ose të vendeve të BE-së, dhe këto duhet t'i dëshmojnë me dokumente përkatëse dhe me praninë e tyre në stallë. Aplikuesit që aplikojnë për ndërtimin e stallës për viça dhe për derra, në projektin e tyre duhet ta përfshijnë edhe depon e plehut me kapacitet të mjaftueshëm për së paku 3 muaj (shiko listën e standardeve minimale kombëtare).
- Në rast të investimeve në mekanizëm bujqësor për kultivimin e tokës, në momentin e aplikimit, aplikuesit për majmëri të viçave duhet të dëshmojnë se kanë së paku 0,20 hektar të tokës bujqësore për kokë viçi, (sipërfaqja e tokës duhet të jetë në relacion me numrin e krerëve në fund të investimit të paraqitura në planin e biznesit) në pronësi, të trashëguar apo të marrë me qira për së paku 5 vjet.

Sektori i qumështit

- Aplikuesi duhet të ketë së paku 5 krerë para nënshkrimit të kontratës.⁵ Posedimi i këtyre krerëve duhet të dëshmohet përmes regjistrimit të kafshëve (Dokument i lëshuar nga AUV-i), ndërsa aplikuesit të cilët në momentin e aplikimit posedojnë 5 e më shumë krerë, duhet të dëshmojnë edhe përmes dëshmisë për subvencionet e marra në vitin paraprak (Dokument i lëshuar nga AZHB).
- Nëse aplikuesi e posedon stallën, e njëjta duhet t'i plotësojë kushtet zooteknike dhe zoohigjienike dhe kjo të dëshmohet përmes fotove dhe tabelës së aseteve në Projekt. Stalla duhet të jetë e pranuar nga inspektorati gjatë kontrollit të parë, para nënshkrimit të kontratës.
- Numri maksimal i krerëve (mëshqerrave/lopëve qumështore) të cilat mund t'i përfitojë aplikuesi/fermeri do të jetë dyfishi i krerëve që i posedon, por jo më shumë se 20 krerë.
- Racat e pranuar:
 1. Holstein (zi e bardhë dhe kuq e bardhë)⁶
 2. Simental
 3. Montbeliarde
 4. Brown Swiss
 5. Tarentaise.
- Mosha e mëshqerrës/lopës së blerë përmes projektit, nuk duhet të jetë më e re se 2 vite e as më e vjetër se 4 vite.
- Aplikuesit për investime në sektorin e prodhimit të qumështit nga bagëtia e imët duhet të kenë së paku 130 dele ose 130 dhi, të regjistruara në Regjistrin e Fermës dhe

⁵ Të drejtë aplikimi kanë edhe fermerët që nuk posedojnë bagëti ose posedojnë më pak se 5 krerë, me kusht që para kontrollit të pare/datës së nënshkrimit të kontratës t'i kenë minimum 5 krerë (të verifikuara me listën nga RRIK).

⁶ Kjo racë nuk mbështetet për zona malore me lartësi mbidetare mbi 700 m.

në Regjistrin për Regjistrim dhe Identifikim të Kafshëve (RRIK) në AUV. Kjo dispozitë nuk vlen për pikat grumbulluese.

- Pikat grumbulluese duhet të kenë kontrata afatgjate (aq sa zgjatë periudha kontrolluese ose më shumë) me së paku 5 fermerë të cilët bashkërisht mbarështojnë së paku 30 lopë qumështore.
- Aplikuesit që aplikojnë për ndërtimin e stallës për lopë qumështore, në projektin e tyre duhet të përfshijnë edhe depon e plehut me kapacitet të mjaftueshëm për së paku 3 muaj (shiko listën e standardeve minimale kombëtare). Depo e plehut nuk është e obligueshme për mbarështuesit e deleve dhe dhive.
- Në rast të investimeve në mekanizëm bujqësor për kultivimin e tokës, aplikuesit duhet të dëshmojnë se kanë të paktën 0.5 hektar të tokës bujqësore për çdo kokë gjedhi, respektivisht 0.05 hektar të tokës bujqësore për kokë deleje/dhie, (sipërfaqet e tokës duhet të jenë në relacion me numrin e krerëve në fund të investimit, të paraqitura në planin e biznesit) në pronësi, të trashëguar apo të marrë me qira për së paku pesë (5) vjet.

Sektori i rrushit

- Në momentin e aplikimit, aplikuesit për investime në sektorin e rrushit duhet të dëshmojnë se kanë tokë bujqësore në pronësi, të trashëguar apo të marrë me qira për së paku 10 vjet, dhe atë së paku 0.50 hektar. Sipërfaqja minimale e ngastrës duhet të jetë 0.10 hektar; Kontratat e nënshkruara dhe të noterizuara për qiramarrje para periudhës së aplikimit, duhet ta mbulojnë periudhën kohore për së paku 5 vite nga dita e aprovimit, dhe të jenë të regjistruara në Regjistrin e Vreshtave dhe në Regjistrin e Fermës.
- Në rast të investimeve në mekanizim dhe pajisje për kultivim dhe vjelje, si dhe depo për trajtim pas vjeljes, aplikuesit duhet të dëshmojnë se kanë së paku 3 hektarë me vreshta, në pronësi, të trashëguar apo të marrë me qira për së paku 10 vjet. Kontratat e nënshkruar dhe të noterizuara për qiramarrje para periudhës së aplikimit, duhet ta mbulojnë periudhën kohore për së paku 5 vite nga dita e aprovimit, dhe të jenë të regjistruara në Regjistrin e Vreshtave dhe në Regjistrin e Fermës.

Sektori i vezëve

- Aplikuesit për investime në sektorin e vezëve, duhet të dëshmojnë posedimin e së paku 5,000 pulave vojse në prodhimtari aktive;
- Aplikuesit që aplikojnë për ndërtimin e fermës së pulave, në projektin e tyre duhet të përfshijnë edhe depon e plehut me kapacitet të mjaftueshëm për së paku 3 muaj (shiko listën e standardeve minimale kombëtare);
- Aplikuesit në sektorin e vezëve, me rastin e aplikimit duhet të shënojnë në planin e biznesit kur do të bëjnë ndërrimin e turnusit dhe sa do të zgjasë pauza pa prodhim;
- Aplikuesi duhet të dorëzojë edhe faturën e furnizimit të fundit me pula. Në rast të sëmundjeve të cilat dëmtojnë numër të madh të pulave, duhet të sigurohet vërtetimi i AUV.

8. Shpenzimet e përbashkëta të pranueshme

Shpenzimet për përgatitjen e planit të biznesit apo projekt-propozimit nuk mund ta tejkalojnë vlerën prej 3% të shpenzimeve të pranueshme, por jo më shumë se 1,500 euro. Në rast të investimeve që parashohin ndërtim të stallave apo depove për ruajtjen e pemëve dhe perimeve, shpenzimet për arkitekt dhe inxhinier, leje dhe licenca të ndryshme janë të pranueshme deri në vlerën 7% të shpenzimeve të pranueshme, por jo më shumë se 3,000 €. Shpenzimet për tarifën e arkitektëve, inxhinierëve, studime fizibiliteti, konsulencë për përgatitjen e planit të biznesit do të jenë të pranueshme vetëm nëse janë kryer nga profesionistë dhe kompanitë e specializuara të fushës.

Si shpenzim i pranueshëm për të gjitha nënmasat do të jetë edhe angazhimi i një studenti në vitin e fundit të studimeve apo të sapodiplomuari në fushën e bujqësisë dhe agroekonomisë. Vlera e mbështetjes nga MBPZHR do të jetë 2,400 € brenda një viti kalendarik. Te gjitha shpenzimet tjera të pranueshme janë të kufizuara në ato që janë përfshirë në Listën e Investimeve të Pranueshme për Masën 1.

8.1 Investimet e pranueshme për sektorët

Investimet në sektorin e pemëve (pemë drufrutore dhe manore)

- Investimet në ngritjen e pemishteve të reja me sipërfaqe minimale prej 1 hektar për pemët drufrutore dhe 0,25 ha për pemë manore;
- Investimet në vendosjen e sistemeve të ujitjes në fermë, sipas praktikave efikase të ujitjes;
- Investimet në prodhimin e energjisë në fermë nga të gjitha llojet e burimeve të ripërtitshme;
- Investimet në sistemin e rrjetave për mbrojtje nga breshri dhe ngricat;
- Investimet në makineri bujqësore dhe pajisje për pemishte, për mbrojtje të bimëve, për plehërim, për vjelje dhe trajtim pas vjeljes;
- Investimet për blerje të traktorit për pemët drufrutore, vetëm për sipërfaqet egzistuese me tre (3) e më shumë hektarë në momentin e aplikimit;
- Vetëm për sipërfaqet me tre (3) e më shumë hektarë, lejohen investime në ndërtimin e objekteve për veprimet pas vjeljes, si depo ftohëse, makineri për klasifikim, pastrim, paketim. Këtyre aplikuesve u lejohet edhe aplikimi për ndërtimin e objekteve për vendosjen e makinave, si dhe depove për produkte për mbrojtje të bimëve dhe për plehra artificiale;

Investimet në sektorin e perimeve: serra, serra për fidanë (përfshirë patatet) dhe depo

- Investimet në ndërtimin e serrave të përhershme për perime, pemë manore apo fidane (serra për fidanë duhet të bëhet në bazë të parametrave optimale të paraqitura në udhëzuesin për aplikues). Sipërfaqja minimale e një serre është 0.1 hektar;
- Investimet në prodhim të energjisë në fermë nga të gjitha llojet e burimeve të ripërtitshme;
- Investime në blerjen dhe instalimin e pajisjeve për arritjen e kushteve të kontrolluara klimatike, përfshirë pajisjet për ngrohje në serra;
- Investimet në vendosjen ose avancimin e sistemeve të ujitjes në serrë sipas praktikave efikase të ujitjes;
- Aplikuesve që kanë tre (3) e më shumë hektarë sipërfaqe me perime/patate u lejohet edhe aplikimi për ndërtimin e objekteve për veprimet pas vjeljes, si depo ftohëse, makineri për klasifikim, pastrim, paketim dhe makineri speciale për vjelje të patates.

- Vetëm aplikuesve me sipërfaqe tre(3) e më shumë hektarë me perime /patate u lejohe edhe aplikimi për ndërtimin e objekteve për vendosjen e makinave, si dhe depove për produkte për mbrojtje të bimëve dhe për plehra artificiale;
- Investime në blerjen e mekanizmit përkatës për kultivimin e perimeve në fushë të hapur apo në serra (makinë për mbjelljen e fidanëve, makinë për shtrirje të folisë).

Investimet në sektorin e mishit

- Ndërtimi/rinovimi/zgjerimi/ i stallave, objekteve përcjellëse (deponitë e plehut, hangarët e ushqimit voluminoz, depot e silazhit) dhe infrastrukturës në fermë (p.sh. furnizim me ujë në nivel ferme);
- Investimet në prodhim të energjisë e në fermë nga të gjitha llojet burimeve të ripërtëritshme;
- Investimet në modernizimin e sistemit të ushqimit dhe furnizimit me ujë;
- Investimet në makineri bujqësore dhe pajisje për kultivim të bimëve foragjere dhe drithërave, mbrojtje të bimëve, plehërim dhe korrje;
- Investimet për pastrimin/largimin e plehut organik (të lëngët dhe të ngurtë) dhe deponimin e tij;
- Investimet për prodhimin e ushqimit të koncentruar, nga kapaciteti total i të cilit së paku 50% do të përdoret për nevoja të fermës.

Investimet në sektorin e qumështit

- Blerja e mëshqerrave të mbarësuar/lopëve të racës (të matrikuara dhe me pedigree).
- Numri i lopëve për të cilat aplikohet nuk duhet të jetë më i vogël se 5 krerë, e jo më shumë se 20 krerë.
- Ndërtimi/rinovimi/zgjerimi i stallave, objekteve përcjellëse si dhe objekteve të qendrave grumbulluese të qumështit (deponitë e plehut, hangarët e ushqimit voluminoz, depot e silazhit, mjeltore) dhe infrastrukturës në fermë (p.sh. instalimi i ujit, i rrymës);
- Investimet në modernizimin e mjeljes dhe pajisjeve për ftohje, si pajisjet për mjelje, ruajtje të qumështit, përfshirë dhomat e ruajtjes së qumështit, laktofrizat;
- Investimet në prodhim të energjisë në fermë nga të gjitha llojet e burimeve të ripërtëritshme;
- Pajisjet dhe makineritë për heqjen e plehut organik, pastrimin e dyshemesë, për shmangien e rrjedhjes së urinës (plehut të lëngët), për lehtësimin e transportit të plehut organik të ngurtë dhe të lëngët drejt objektit të magazinimit,
- Investimet në modernizimin e sistemit të ushqimit dhe furnizimit me ujë;
- Investimet në makineri bujqësore dhe pajisje për kultivim të bimëve foragjere dhe drithërave, mbrojtje të bimëve, plehërim dhe korrje;
- Investimet për pastrimin/largimin e plehut organik (të lëngët dhe të ngurtë) dhe deponimin e tij;
- Investimet për prodhimin e ushqimit të koncentruar, nga kapaciteti total i të cilit së paku 50% do të përdoret për nevoja të fermës.

Investimet në sektorin e rrushit

- Investimet në ngritjen/modernizimin e plantacioneve të vreshtave (konvertim, zëvendësim) për rrush të tryezës dhe rrush të verës me madhësi minimale 0.50 hektar;
- Investimet në vendosjen e sistemeve të ujitjes, sipas praktikave efikase të ujitjes;
- Investimet në vendosjen e plasmasit për rrush të tryezës;

- Investimet në prodhim të energjisë në fermë nga të gjitha llojet e burimeve të ripërtëritshme;
- Investimet në sistemin e rrjetave për mbrojtje nga breshri;
- Investimet në sisteme mbajtëse të hardhive dhe në rrethoja;
- Investimet në makineri bujqësore dhe pajisje për vreshta, makineri për mbrojtje të bimëve, për plehërim, për vjelje dhe trajtim pas vjeljes;
- Aplikuesve që kanë tre (3) e më shumë hektarë sipërfaqe me vreshta u lejonet edhe aplikimi për ndërtimin e objekteve për veprimet pas vjeljes, si depo ftohëse, makineri për klasifikim, pastrim, paketim.

Investimet në sektorin e vezëve

- Ndërtimi/rinovimi/zgjerimi i stallave dhe dhomave për ruajtjen e vezëve;
- Investimet në infrastrukturë të brendshme (sistemi i të ushqyerit, ujë-pirëset dhe pajisje për rregullimin e mikroklimës, pajisje për largimin e plehut, klasifikim të vezëve);
- Investimet në kafaze, vetëm sipas standardeve të BE-së;
- Ndërtimi dhe rinovimi i depove për ruajtjen e ushqimit, përfshirë pajisjet për përgatitje të ushqimit, trajtim, paketim dhe ruajtje të vezëve;
- Investimet në pajisje për energji ose prodhim të energjisë në fermë nga të gjitha llojet e burimeve të ripërtëritshme;
- Investimet për pastrimin/largimin e plehut organik dhe deponimin e tij;
- Investimet për prodhimin e ushqimit të koncentruar, nga kapaciteti total i të cilit së paku 50% do të përdoret për nevoja të fermës.

8.2 Investimet tjera

Blerja e makinave dhe pajisjeve të reja, përfshirë softuerin kompjuterik me çmime të tregut. Investimet në makineri, në pajisjet e TI-së si dhe softuerë duhet të arsyetohen mirë në planin e biznesit.

Investimet për blerje të traktorit do të pranohen vetëm në ato raste kur ekziston një korelacion i ngushtë ndërmjet madhësisë/fuqisë së traktorit dhe ngarkesës së punës/madhësisë së fermës/kapacitetit prodhues, i prezantuar dhe arsyetuar mirë në planin e biznesit (shih udhëzuesin për fermerë “Tabela - fuqia maksimale e traktorëve sipas sektorëve dhe madhësisë/kapacitetit”)

Një listë e detajuar e shpenzimeve të pranueshme në kuadër të kësaj mase do të paraqitet në listën e shpenzimeve të pranueshme për masën.

9. Kriteret e përzgjedhjes

9.1 Kriteret e përzgjedhjes për prodhimin bimor

Nr	Lloji i kriterëve	Kategoria					
		Drufrutore	Manore	Rrush	Serra/serra për fidanë	Depo për peme drufrutore dhe manore, perime (përfshirë patatën) dhe rrush.	Pikët
1.	Investimet në rritjen e prodhimit, përmirësimi i efikasitetit dhe qëndrueshmërisë së prodhimit në fermë. Kapaciteti prodhues: sipërfaqja që do të ngritet. Në rast të investimit në infrastrukturë: depo, ujitje, mbrojtje kundër breshrit dhe/ose makineri, pikët llogariten varësisht prej sipërfaqes ekzistuese ⁷ apo asaj që do të ngritet, cila do qoftë më e madhe.	≥ 3 ha	≥ 0.5 ha	≥ 1 ha	> 0.20 ha	Sipërfaqja e ngritur, përfshirë edhe atë ekzistuese, më e madhe se 5 ha	55
		1 ha - < 3 ha	0.25 ha- < 0.5 ha	0.5 - 1 ha	0.10 – 0.20 ha	Sipërfaqja e ngritur, përfshirë edhe atë ekzistuese nga 3- 5 ha	50
		Aplikuesi është 40 vjeç ose më i ri					
2.	Aplikuesi i ri ⁸	Aplikuesi është 40 vjeç ose më i ri					3
3.	Gjinia e fermerit ⁹	Aplikuesi femër					2
4.	Investimet në zonat malore - ky kriter nuk vlen për aplikuesit për serra.	Investimet në zonat malore					10
5.	Investimet që synojnë zbutjen e efekteve të ndryshimeve klimatike (Investimet në prodhim të energjisë sëripërtërishme) ¹⁰	Investimi në prodhimin e energjisë në fermë nga burimet e ripërtërishme (<i>min. 5% investimit të pranueshëm</i>). (Pikët nga ky kriter merren sipas biznes planit)(ky kriter nuk vlen për ngritje të vreshtave)					10
6.	Investimet që përfshijnë krijimin e vendeve të punës duke u bazuar në biznes plan.	Vendet e punës do të vlerësohen sipas biznes planit, nëse nuk ju përmbahen kërkesave do të sanksionohen me kthim të investimit. “Çdo vend i krijuar i punës duhet të regjistrohet në ATK dhe të paguhet të gjitha kontributet se paku për periudhën monitoruese”. ¹¹					20
GJITHSEJ						100	

⁷ Sipërfaqet ekzistuese të dëshmohen me marrjen e pagesës direkte për këto sipërfaqe në vitin paraprak ose nëse nuk ka marrë pagesa direkte, dëshmohet me certifikatën e pronës dhe NIF-in.

⁸ I pranueshëm është aplikuesi i cili deri në ditën e aplikimit nuk i ka mbushur 40 vjet

⁹ Gjinia e fermerit, aplikuesi do t'i marrë pikët e këtij kriteri nëse e tërë toka, përfshirë tokën ku bëhet investimi, është në emër të aplikuesit të saj në pesë vitet e fundit. Krijimi i Kushteve artificiale për të marrë pikë paraqet mashtrim dhe do të ndëshkohet sipas legjislacionit në fuqi.

¹⁰ Investimet në prodhimin e energjisë së ripërtërishme/mbrojtja e mjedisit dhe ndryshimi klimatik, nëse përfituesi ka paraparë investime në përdorimin e energjisë së ripërtërishme dhe i fiton pikët për këtë qëllim, është i obliguar që këtë investim ta përdorë dhe ta mbajë aktiv për qëllimet që i ka paraparë në planin e biznesit. Nëse gjatë cilido kontroll nga zyrtarët e AZHB-së (para nënshkrimit të kontratës, ad –hoc ose ex-post), konstatohet se investimet në energji të ripërtërishme nuk janë duke u përdorur siç parashihet në biznes plan, atëherë përfituesi do të ndëshkohet sipas legjislacionit në fuqi.

¹¹ Për çdo punëtor të punësuar, aplikuesi merr nga 5 pikë shtesë, por jo më shumë se 20 pike, në rastet kur punësohen 4 veta e më shumë.

9.2 Kriteret e përzgjedhjes për prodhimin shtazor

Nr.	Lloji i kriterëve	Kategoria					Pikët
		Lopë qumështore ¹²	Viça	Derra	Dele/dhi	Pula	
1.	Kapaciteti prodhues (numri i kafshëve) pas realizimit të projektit.	10-15krerë	≥ 20 < 30 krerë	≥ 40 < 100	≥ 150 < 300	≥ 5000 < 50.000	20
		>15 krerë	≥ 30 krerë	≥ 100 krerë	≥ 300 krerë	≥ 50.000 krerë	25
2.	Investimet në rritjen e prodhimit në përmirësimin e efikasitetit. Lloji i investimit: Në rast të investimit edhe nga pika a) pika b) dhe c pikët llogariten nga investimi me pjesën më të madhe të buxhetit të planifikuar në biznes plan.	a) Ndërtimi/rinovimi/zgjerimi i stallës					25
		b) Makineri dhe/ose përmirësimi i infrastrukturës së jashtme, depo e plehut, depo e silazhit, dhe depo e sanës					20
		c) Blerja e lopëve					30
3.	Investime që synojnë zbutjen e efekteve të ndryshimeve klimatike ¹³	Investimi në prodhimin e energjisë në fermë nga burimet e ripërtëritshme (<i>min. 5% e investimit të pranueshëm</i>) (Pikët nga ky kriter merren sipas biznes planit)					10
4.	Investimet në zonat malore	Investimet në zonat malore					10
5.	Investimet që përfshijnë krijimin e vendeve të punës duke u bazuar në biznes plan.	Vendet e punës do të vlerësohen sipas biznes planit, nëse nuk ju përmbahen kërkesave do të sanksionohen me kthim të investimit. "Çdo vend i krijuar i punës duhet të regjistrohet ne ATK dhe te i paguhet te gjitha kontributet se paku për periudhën monitoruese". ¹⁴					20
6.	Aplikuesi i ri ¹⁵	Aplikuesi është 40 vjeç ose më i ri					3
7.	Gjinia e fermerit	Aplikuesi femër					2
GJITHSEJ						100	

¹² Në këtë grup hyjnë edhe fermerët fillestar, të cilët janë të obliguar të arrijnë numrin minimal prej 10 krerëve pas zbatimit të projektit.

¹³ Investimet në prodhimin e energjisë së ripërtëritshme/mbrojtja e mjedisit dhe ndryshimi klimatik, nëse përfutuesi ka paraparë investime në përdorimin e energjisë së ripërtëritshme dhe i fiton pikët për këtë qëllim, është i obliguar që këtë investim ta përdorë dhe ta mbajë aktiv për qëllimet që i ka paraparë në planin e biznesit. Nëse gjatë cilito kontroll, nga zyrtarët e AZHB-së (para nënshkrimit të kontratës, ad –hoc ose ex-post), konstatohet që investimet në energji të ripërtëritshme nuk janë duke u përdorur siç parashihet në biznes plan, atëherë përfutuesi do të ndëshkohet sipas legjislacionit në fuqi.

¹⁴ Për çdo punëtor të punësuar, aplikuesi merr nga 5 pikë shtesë, por jo më shumë se 20 pikë, në rastet kur punësohen 4 veta e më shumë

¹⁵ I pranueshëm është aplikuesi i cili deri në ditën e aplikimit nuk i ka mbushur 40 vjet.

10. Shkalla e përkrahjes publike

- Vlera minimale e shpenzimeve të pranueshme për projekt brenda kësaj mase është 10,000 €;
- Vlera maksimale e shpenzimeve të pranueshme për projekt është 100,000 euro;
- Përkrahja maksimale publike për periudhën e zbatimit të PKBZHR (2023 - 2027) për Masën 1 është 240,000 € për përfitues;
- Aplikuesi mund të aplikojë me disa projekte gjatë periudhës së zbatimit të Programit në vite të ndryshme, me kusht që projektet e mëhershme të jenë përfunduar me sukses dhe përkrahja publike të mos e tejkalojë shumën e lartpërmendur;
- Mbështetja publike për projekt është 60%:
- +5% për investime në zona malore;
- +5% për investime në asete fizike të ekonomive bujqësore në pronësi të fermerëve të rinj;
- Shpenzimet për përgatitjen e planit të biznesit apo projekt-propozimit nuk mund ta tejkalojnë vlerën prej 3% të shpenzimeve të pranueshme, por jo më shumë se 1,500 euro. Në rast të investimeve që parashohin ndërtim të stallave apo depove për ruajtjen e pemëve dhe perimeve, shpenzimet për arkitekt dhe inxhinier, leje dhe licenca të ndryshme janë të pranueshme deri në vlerën 7% të shpenzimeve të pranueshme, por jo më shumë se 3,000 €;
- Secili Aplikues (përfitues) projekteve me vlerë mbi 50,000 euro, ka për obligim të angazhojë një student të drejtimit universitar bujqësor dhe agroekonomi, për 1 vit kalendarik. Vlera minimale e pagesës për angazhimin 1 vjeçar të studentit të jetë 2,400 euro. Personi i njëjtë nuk lejohet të angazhohet në më shumë se në një projekt dhe duhet të jetë i sektorit përkatës ose të përafërt;
- Pagesa për Masën 1 bëhet në dy këste, pjesa e parë e përkrahjes publike në vlerë prej 50% bëhet në formë të paradhënies pas nënshkrimit të kontratës me përfituesin, me kusht të sigurimit të garancionit bankar, ndërsa pjesa tjetër e mbetur prej 50%, paguhet pas verifikimit të përfundimit të investimit të përgjithshëm;
- Garancioni bankar duhet të sigurohet vetëm për paradhënien prej 50% të përkrahjes publike;
- Garancioni bankar duhet të sigurohet për periudhën kohore deri sa të realizohet pagesa e fundit nga AZHB-ja, respektivisht deri te vendimi i fundit nga Komisioni i Ankesave. Çdo kërkesë për afat shtesë duhet të mbulohet me garancion bankar.

11. Buxheti për Masën 1

MASA 1		Buxheti	%
1.1	Pemë drufrutore	1,527,000.00	9.08
a)	Arra, lajthi dhe gështenja	1,000,000.00	5.94
1.2	Pemë manore	800,000.00	4.75
1.3	Sektori i perimeve dhe serrave, përfshirë serrat për Fidanë	3,000,000.00	17.83
1.4	Depo për ruajtjen e pemëve dhe perimeve	1,200,000.00	7.13
1.5	Prodhimi i mishit/rritja e viçave	1,500,000.00	8.91
1.6	Prodhimi i mishit/rritja e derrave	300,000.00	1.78
1.7	Prodhimi i qumështit/lopë	5,000,000.00	29.72
1.8	Prodhimi i qumështit/dele dhe dhi	800,000.00	3.57
1.9	Pikat grumbulluese të qumështit	200,000.00	1.19
1.10	Prodhimi i rrushit	1,000,000.00	5.94
1.11	Prodhimi i vezëve	500,000.00	2.97
Totali i buxhetit		16,827,000.00	100

12. Treguesit

TREGUESIT	CAQET
Numri i përgjithshëm i fermave të mbështetura	258
Numri i ha të ngritur me pemishte	166
Numri i ha të ngritur me serra, serra për fidane	18.7
Numri i fermave blegtorale të mbështetura/për prodhim qumështi	116
Numri i fermave blegtorale të mbështetura/për prodhim mishit	36
Numri i ha të ngritur me vreshta	25
Numri i fermave të mbështetur për prodhimin e vezëve	8
Numri i pikave të përkrahura grumbulluese të qumështit	4
Numri i depove të reja të ngritura për pemë dhe perime	100
Numri i fermave që marrin mbështetje për investime në PZHR, në higjienën dhe mirëqenien e kafshëve	116
Numri i fermave që prodhojnë energji të ripërtëritshme	150
Numri i përfituesve të PZHR në investime në trajtimin ose menaxhimin e mbetjeve	116
Vende të reja të punës me orar të plotë	258
Vlera totale e investimeve publike	16,827,000.00
Vëllimi i përgjithshëm i investimit	28,045,000.00

*Caqet janë vendosur në bazë të buxhetit të parashikuar, prandaj çdo ndryshim i buxhetit do të reflektohet proporcionalisht në indikatorë.

13. Procedura administrative

Kjo masë do të zbatohet nga Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë (AZHB). Procedurat administrative të detajuara do të paraqiten në Udhëzimin Administrativ i cili miratohet nga Ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural. Vlerësimi përfshin verifikimin e dokumentacionit të dorëzuar (të jetë i plotë), kontrollet e pranueshmërisë (përfshirë projekt propozimin/planin e biznesit) dhe vlerësimi me pikë i projekteve. Raportet e vlerësimit do të publikohen. Të gjithë aplikuesit do të kenë mundësinë të parashtrojnë ankesë. Procedura e vlerësimit do të jetë pjesë e Udhëzimit Administrativ, të miratuar nga MBPZHR.

14. Afati i zbatimit

Afati i zbatimit të projekteve të kësaj mase është 90 ditë kalendarike, përveç për projekte që parashohin ndërtim të stallës apo të depos me ç'rast afati i zbatimit është 120 ditë kalendarike nga dita e nënshkrimit të kontratës me AZHB-në, ndërsa për projektet në sektorin e rrushit, afati i implementimit është 300 ditë nga dita e nënshkrimit të kontratës me AZHB-në, për shkak të periudhës pranverore të mbjelljes së rrushit. Pas afatit të zbatimit, përfituesi ka edhe 15 ditë shtesë për përgatitjen e dokumentacionit dhe paraqitjen e kërkesës për pagesë.

AZHB mund të zgjasë afatin e zbatimit për më shumë se 30 ditë, nëse ka arsye të qëndrueshme për këtë, siç janë kushtet e papërshtatshme klimatike, sjellja e ndonjë makinerie specifike prej ndonjë vendi tjetër.

15. Shtrirja gjeografike e masës

Kjo masë aplikohet në tërë territorin e Republikës së Kosovës.

MASA 3: INVESTIMET NË ASETET FIZIKE NË PËRPUNIMIN DHE TREGTIMIN E PRODUKTEVE BUJQËSORE

1. Baza ligjore

- Ligji nr.08/l-072 për Bujqësi dhe Zhvillim Rural (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/ Nr. 8/ 29 mars 2023);
- Strategjia për Bujqësi dhe Zhvillim Rural 2022-2028, vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr.12/50, i datës: 23.12.2021;
- Programi Kombëtar për Bujqësi dhe Zhvillim Rural 2023-2027, vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës, Nr.15/151 dt. 12.07.2023.

2. Arsyeshmëria

Industria e përpunimit të ushqimit përcaktohet si transformimi i produkteve blegtorale dhe bujqësore në produkte për konsum të ndërmjetëm apo përfundimtar.

Duke investuar në zhvillimin e agro-industrisë nuk rriten vetëm të ardhurat e fermerëve, por gjithashtu krijohen mundësi të reja punësimi në zonat rurale.

Për t'i bërë ballë konkurrencës së tregut, është e nevojshme të përmirësohet cilësia e ushqimit duke zbatuar standardet e cilësisë dhe sigurisë së ushqimit. Kjo masë do të rrisë aftësinë konkurruese të sektorit agro-usqimor, do të përmirësojë efikasitetin dhe qëndrueshmërinë e prodhimit, duke përfshirë prodhimin e sigurt, ushqyes dhe të qëndrueshëm të ushqimit, duke investuar në infrastrukturën fizike në përpunime me standardet përkatëse të BE-së.

Industria e përpunimit dhe paketimit të ushqimit në Kosovë është e ndarë në nënsektorët vijues: përpunim të qumështit dhe prodhimeve të qumështit, përpunim të mishit dhe prodhimeve të mishit, përpunim të pemëve dhe perimeve si dhe prodhim i verës.

Me gjithë investimet që janë bërë në sektorin e përpunimit të ushqimit, ato ende nuk i përmbushin kërkesat vendore për produkte cilësore.

Produktet e importuara dominojnë në tregun e Kosovës. Për të konkurruar me sukses në një treg gjithnjë e më të hapur, industria ushqimore ka akoma nevojë për modernizimin e teknologjive dhe përmirësimin e sistemeve të menaxhimit të sigurisë së ushqimit.

Industria ushqimore ka për detyrë të krijojë grumbullim të sigurt, transportim dhe deponim të lëndëve të para, pakësim të mbeturinave dhe të garantojë sigurinë e ushqimit. Në këto masa, përparësi u jepet investimeve për zbatimin e standardeve të sigurisë së ushqimit që kanë rëndësi të veçantë për furnizimin e tregut vendor me prodhime të sigurta ushqimore dhe për konkurrim të suksesshëm me furnizuesit nga importi. Për të inkurajuar adaptimin e industrisë ushqimore me standardet mjedisore, prioritet u është dhënë investimeve që synojnë trajtimin e mbetjeve, pastrimin e ujit dhe shfrytëzimin efikas të mbetjeve të prodhimit. Investimet e mbështetura në Masën 3 do të kontribuojnë në përmirësimin e situatës së prodhimit bujqësor primar.

Potenciali është shumë i madh për zhvillimin e industrisë së përpunimit të ushqimit, por gjithashtu janë edhe sfidat të mëdha me të cilat ballafaqohet ky sektor: lënda e parë e pamjaftueshme dhe e paqëndrueshme, strukturat e dobëta të prodhimit primar bujqësor, pronësia e tokës së fragmentuar kufizon aftësinë e përpunuesve dhe tregtarëve për të ofruar mundësi biznesi, sasi të mjaftueshme të prodhimeve primare bujqësore me standarde uniforme të cilësisë; mungesa e zbatimit të teknologjive të reja, mungesa e teknologjive të përpunimit të ushqimit, infrastruktura e dobët, mungesa e lidhshmërisë në mes prodhuesve të lëndës së parë dhe përpunuesve, marrëdhëniet kontraktuale ndërmjet përpunuesve dhe fermerëve janë të pazhvilluara, konkurrenca e pandershme nga importi, janë disa pengesa dhe sfida me të cilat po përballen përpunuesit e ushqimit dhe do të përballen më tutje në aktivitetet e tyre të përditshme. Rritja e konsumit për kokë

banori për këto produkte paraqet mundësi potenciale dhe të vazhdueshme për zhvillimin e këtyre bizneseve duke zvogëluar rritjen e importit të këtyre produkteve.

2.1 Sektori i përpunimit të qumështit

Industria e përpunimit të qumështit ka qenë prioritet kryesor në skemat mbështetëse kombëtare dhe në grantet e BE-së përgjatë viteve të fundit. Megjithatë, mbështetja e dhënë ende nuk i ka plotësuar nevojat për mbulim të investimeve të ndërmarrjeve të përpunimit të qumështit në aspektin e përafrimit me standardet e BE-së në fushat e sigurisë ushqimore, mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin e investimeve të energjisë së ripërtëritshme.

Përpunuesit e qumështit kanë nevojë për një furnizim të rregullt dhe më të madh me inpute (qumësht) me cilësi të lartë, për të përmirësuar cilësinë e produkteve të tyre dhe për të siguruar prodhim të qëndrueshëm.

Prodhimi i qumështit në Kosovë përballet me shumë sfida, siç janë numri i madh i fermave të vogla të qumështit dhe zvogëlimi i numrit të bagëtive, përkatësisht lopëve qumështore. Për të kompensuar këtë bilanc, një sasi e konsiderueshme e produkteve të qumështit të përpunuara importohet nga vendet e rajonit si dhe nga vendet e tjera evropiane. Kërkesa për qumësht dhe produktet e qumështit është e madhe. Popullata e Kosovës konsumon rreth 276,730 t/qumësht¹⁶. Nga konsumi i përgjithshëm, 64% e qumështit të prodhuar në Kosovë konsumohet në fermë ose shkon në tregjet e parregulluara lokale (tregjet e gjelbërta), kurse 36% kalon përmes kanaleve tregtare tek përpunuesit dhe tregjet e brendshme. Importet zënë 29% të produkteve të qumështit.

Sipas Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinës (AUV), në Kosovë ekzistojnë 44 kompani përpunuese të cilat e grumbullojnë qumështin nga fermerët, dhe e përpunojnë atë në produkte me vlerë të shtuar si djathi, kosi, jogurti, ajrani, qumështi i sterilizuar etj. Disa përpunues furnizohen direkt nga fermerët të cilët prodhojnë sasi të madhe të qumështit, kurse disa tjerë e grumbullojnë tek pikat grumbulluese të qumështit, ku fermerët me kapacitete të vogla dërgojnë qumështin në një pikë grumbulluese.

Përpunuesit e qumështit nuk kanë sasi dhe cilësi të mjaftueshme të qumështit të papërpunuar, kështu që funksionojnë me kapacitet jo të plotë.

Kapacitetet përpunuese momentalisht janë 774.29 t/ditë ndërsa përpunojnë vetëm rreth 220,000 litra në ditë, ose i shfrytëzojnë rreth 49% të kapaciteteve të përgjithshme.¹⁷ Megjithatë, vazhdon nevoja e mëtejshme për ndarjen e fondeve publike për përpunuesit e qumështit, duke përfshirë rritjen e kapaciteteve prodhuese, pasi ka nevojë për integrim të mëtejshëm të zonave të prodhimit dhe shërbimit vendas që nuk mbulohen nga fabrikat ekzistuese të përpunimit, për diversifikimin e prodhimit dhe futjen në treg të produkteve të reja.

Operatoret e biznesit të ushqimit vejnë në qarkullim produktet me origjinë shtazore të prodhuara në Kosovë, vetëm nëse janë përgatitur dhe trajtuar ekskluzivisht në ndërmarrjet të cilat i plotësojnë kërkesat relevante të Rregullores Nr. 11/2011, për Higjienën e prodhimeve ushqimore dhe kriteret tjera relevante të Ligjit për Ushqim; dhe që Autoriteti kompetent i ka regjistruar ose aprovuar sipas kërkesës.

Bazuar në shkallën e rrezikshmërisë të sigurisë së ushqimit ndërmarrjet e përpunimit dhe paketimit të qumështit kategorizohen në 4 kategori:

- Kategoria "A" = shkallë e ulët e rrezikut
- Kategoria "B" = shkallë e mesme e rrezikut
- Kategoria "C" = shkallë e lartë e rrezikut
- Kategoria "D" = shkallë shumë e lartë e rrezikut

¹⁶ Raporti i Gjelbër 2022

¹⁷ Analiza sektoriale për sektorin e blegtorisë 2020/21

Përpunuesit duhet të punojnë në përmirësimin dhe standardizimin e praktikave të tyre të përpunimit, për të përmirësuar cilësinë dhe qëndrueshmërinë e produkteve të gatshme, për të rritur efikasitetin e prodhimit dhe për të përmbushur vazhdimisht standardet ndërkombëtare të cilësisë.

Qumështi i deleve është një produkt sezonal dhe në shumicën e rasteve fermerët në periudhën e laktacionit mbajnë dele në kullosa malore. Kjo e bën të pamundur që përpunuesit të mbledhin qumësht, prandaj fermerët e përpunojnë qumështin në fermë. Pavarësisht kushteve të papërshtatshme, ku mungon infrastruktura e objektit dhe pajisjeve, falë traditës dhe përvojës në përpunimin e qumështit, fermerët arrijnë të prodhojnë kryesisht djathë, të cilin ata e vendosin drejtpërdrejt në treg për konsumatorët. Sasia e vogël e qumështit dhe prodhimi sezonal i qumështit të deleve dhe dhive kanë orientuar përpunuesit e qumështit që të mos shprehin interesim për përpunimin e qumështit të deleve dhe dhive.

2.2 Sektori i përpunimit të mishit

Sektori i mishit duhet të konsolidohet si veprimtari ekonomike e qëndrueshme, konkurrenente në treg me garancitë e domosdoshme për sigurinë dhe cilësinë të prodhimeve të tyre. Industria përpunuese duhet të përmirësojë kapacitetet përpunuese ekzistuese, qëndrueshmërinë e rrjetit furnizues me lëndë të parë, të zbatojë sisteme të sigurisë së ushqimit dhe të promovojë prodhime të reja. Mbështetja për zhvillimin e zinxhirit të furnizimit duhet të adresohet kryesisht për ndërmarrjet ekzistuese të përpunimit për të rritur përputhshmërinë e tyre me sigurinë e ushqimit dhe kërkesat e kontrollit të cilësisë, për të zgjeruar llojllojshmërinë e produkteve të tyre në përputhje me normat mjedisore.

Mishi i viçit dhe shpendëve janë burimet kryesore të konsumit të mishit në vend. Mishi i shpendëve është kategoria kryesore e konsumuar në Kosovë me rreth 47%, e ndjekur nga mishi i viçit me rreth 46%, ndërsa pjesa tjetër e mishit të konsumuar në vend vjen nga dhitë, delet dhe derri. Kosova ka 62 objekte të licencuara për përpunimin e mishit të gjedhit dhe 8 thertore për pula. Aktualisht, përpunuesit e mishit po prodhojnë kryesisht produkte si në vijim: përgatitjet nga mishi i bluar - qebap, qyfte nga mishi i gjedhit dhe dyner nga mishi i pulës e i gjedhit; produkte të mishit të trajtuara termikisht siç janë mish i thatë, suxhuk dhe sallama tjera nga mishi i gjedhit, pulës dhe derrat si dhe salsiçe (virshlle) nga mishi i pulës. Si rezultat i furnizimit të pamjaftueshëm të produkteve primare nga blegtorët e Kosovës, përpunuesit vendorë të mishit importojnë rreth 80% të lëndës së parë për të përmbushur nevojat e tyre të prodhimit. Në pesë vitet e fundit përqindja e importeve të mishit është rritur vazhdimisht, Kosova vazhdon të importojë peshë të gjallëtë bagëtive dhe gjithashtu mish karkas/mish të ngrirë për të përmbushur kërkesat e tregut. Mbështetja duhet të synojë kryesisht përmirësimin e pajtueshmërisë me sigurinë e ushqimit dhe kërkesat e kontrollit të cilësisë dhe të zgjerojë llojllojshmërinë e produkteve të ofruara në treg.

Mishi i gjedhit është një nga segmentet më të rëndësishme në zinxhirin e furnizimit. Industria e përpunimit të mishit në Kosovë është gjithnjë në rritje duke e bërë përdorimin e mishit vendor si lëndë të parë. Bilanci i furnizimit me mish deleje dhe dhive është pozitiv. Krahasuar me mishin e viçit, mishi i deleve dhe i dhisë konsumohet shumë më pak, kryesisht në festa të caktuara.

Prodhimi i mishit të deleve i referohet kryesisht mishit të qengjit, ndërsa prodhimi i mishit në kategoritë e tjera të deleve është relativisht i ulët. Prodhimi i mishit të qengjit në Kosovë i plotëson nevojat e konsumit vendor, dhe përkundër kushteve të mira për rritje të numrit të kafshëve për të prodhuar për tregun e jashtëm, një gjë e tillë aktualisht është e pamundur për shkak të problemeve në eksport të mishit të qengjit.

Thertoret në Kosovë janë të paorganizuar dhe disa nga to nuk përmbushin standardet e BE-së. Sfidë e madhe për autoritetet është rregullimi i këtij sistemi në të gjitha hallkat e tij, i cili fillon prej fermës dhe përfshin identifikimin e kafshëve, statusin shëndetësor të kafshës

dhe pronës blegtorale si tërësi, shërbimin veterinar dhe përdorimin e substancave për mjekimin e kafshëve, përgatitjen dhe sigurinë e ushqimit të kafshëve, lëvizjen e kafshëve nga ferma në tregje dhe nga tregjet në thertore, si dhe kapacitetet humane si numri i vogëli inspektorëve veterinar dhe kapaciteteve laboratorike nacionale për të dëshmuar dhe verifikuar këtë sistem. Pajisjet e therjes janë të vjetra dhe pjesa më e madhe e procesit të therjes është manuale. Procedurat sanitare gjatë procesit të therjes gjithashtu mungojnë, duke pasur një ndikim të drejtpërdrejtë negativ në cilësinë e mishit që përpunohet. Mbetjete hedhura të kafshëve që dalin nga therja nuk trajtohen si duhet, duke shkaktuar ndikime kundërt në mjedis.

Gjithsej në Kosovë janë 8 (tetë) objekte të aprovuara për therje të shpezëve, prej të cilëve 6 (gjastë) janë aktive dhe vetëm 1 (një) nuk është aktive. Kapaciteti total i therjes është 15,000 copë/ditë. Kapaciteti më i lartë i therjes është 6,000 copë/ditë, kapaciteti mesatar është 1,500 copë/ditë. Industria e përpunimit të mishit në Kosovë varet shumë nga importet e mishit të papërpunuar. Prodhimi lokal i mishit të pulës aktualisht arrin të mbulojë rreth 6.9% të nevojave të konsumit, pjesa tjetër importohet si mish i ftohur ose i ngrirë.

Në Kosovë gjithashtu janë të regjistruar/aprovuar 48 (dyzet e pesë) depo ftohëse, dhe të gjitha janë aktive. Ato kryesisht përdoren për ruajtjen e produkteve, te disa bëhet edhe ripaketimi i produkteve. Këto ftohëse janë të kategorizuara në kategoritë A, B, C dhe D. Objekte për përpunimin e peshkut janë 2 të aprovuara, nga to 2 aktive.

Kapacitet i lartë i përpunimit: 1,500 kg/ditë, kapacitet të mesëm përpunimi: nuk ka, kapacitet i ulët i përpunimit: nuk ka. Kapaciteti total i përpunimit: 3,000 kg/ditë. Objekte për përpunimin e vezëve janë 2 të aprovuara, nga to 2 aktive.

2.3 Sektori i përpunimit të pemëve, perimeve dhe pikat grumbulluese/depo

Industria e përpunimit të pemëve dhe ajo e perimeve kanë shumë parametra të përbashkët, prandaj janë analizuar së bashku, si një industri.

Vështirësitë e këtij sektori kryesisht vijnë si rezultat i ndikimit të faktorëve të ndryshëm siç është organizimi i zinxhirit të furnizimit, pra siguri i lëndëve të para. Fermerët prodhojnë pemë dhe perime kryesisht për tregun vendor si produkte të freskëta, ku prodhimet vendore gjejnë blerës të mjaftueshëm. Industria e përpunimit të pemëve dhe perimeve përballen me furnizim të kufizuar të lëndës së parë për përpunim.

Kompanitë e përpunimit të pemëve dhe perimeve furnizohen kryesisht me pemë dhe perime nga prodhuesit vendorë përmes kanaleve të ndryshme të furnizimit. Kompanitë e përpunimit, në varësi të llojit të kulturave bujqësore që grumbullojnë për përpunim, përdorin dy kanale kryesore të furnizimi: direkt nga fermerët dhe indirekt nga qendrat e mbledhjes dhe ruajtjes së pemëve dhe perimeve.

Në përgjithësi, 30% e pemëve dhe perimeve të kultivuara në vend përpunohen nga industria në Kosovë. Në mungesë të pemëve dhe perimeve, lënda e parë importohet.

Përveç problemit të sigurimit të lëndës së parë për industrinë, është interesante të shohim nga afër kostot për përpunimin e pemëve: lënda e parë 12%, energjia elektrike 23%, uji 5%, karburanti 7%, paga 0.4% dhe të tjerat 14%. Është e jashtëzakonshme që kosto e energjisë është 2-3 herë më e shtrenjtë sesa kostot për lëndët e para. E vlefshme është që të investohet në instalimin e energjisë së ripërtëritshme - mbështetur nga MBPZHR, duke pasur parasysh rritjen e fundit të koston së energjisë elektrike dhe nevojën e depove të ftohjes dhe linjave të prodhimit e të përpunimit për energji elektrike.

Zinxhirit të vlerave të prodhimit dhe përpunimit të pemëve dhe perimeve i mungojnë standardet e cilësisë, dhe si pasojë e kësaj mungon konsistenca e cilësisë së prodhimeve. Mos klasifikimi dhe diversifikimi i prodhimeve po ashtu janë dobësi e prodhimeve vendore të përpunuara.

Kosova ka traditë të gjatë në përpunimin e pemëve dhe perimeve, si një pjesë integrale e zinxhirit të ushqimit të çdo familjeje. Është vlerësuar se një sasi e konsiderueshme e

perimeve dhe pemëve të përpunuara janë duke u prodhuar në shtëpi dhe për konsum vetanak. Kapacitetet e përpunimit në masë të madhe e kalojnë kapacitetin e prodhimit të lëndës së parë. Edhe pse sektori është i fragmentuar, disa nga pjesëmarrësit kryesorë mbulojnë një pjesë të konsiderueshme të tregut.

Në vitet e fundit, përpunuesit e pemëve dhe perimeve kanë filluar të prodhojnë produkte të tilla si reçel frutash, sallata të ndryshme, turshi, lëngje, perime të konservuara, marmelatë, ajvar, etj. Kapaciteti i tharjes është i kufizuar, ndërsa ky trajtim është duke u përdorur kryesisht për bimët mjekësore dhe ato aromatike. Qëllimi kryesor i kësaj mase është që të gjitha ndërmarrjet e përpunimit të pemëve dhe perimeve të fokusohen në përmirësimin e cilësisë dhe sigurisë së ushqimit, dhe në reduktimin e humbjeve në procesin e përpunimit.

Sistemet e sigurisë ushqimore aplikohen në një numër të kufizuar të ndërmarrjeve. Përfshirja e sistemeve të sigurisë ushqimore kërkon investime në përmirësimin e teknologjisë dhe përmirësimin e kushteve në objektet e prodhimit, si dhe investime në pajisje të kontrollit të kualitetit dhe sisteme të IT-së. Është evidente nevoja për linja të klasifikimit, kategorizimit dhe paketimit, për ta rritur cilësinë e produktit përfundimtar dhe për ta përmirësuar konkurrueshmërinë e sektorit ndaj importeve. Objektet e duhura të pas vjeljes dhe zinxhiri për ftohje janë të një rëndësie të madhe për cilësinë në zinxhirin e vlerës së perimeve dhe pemëve. Kërkesat dhe nevojat për objekte të deponimit me sistemetë ftohjes janë në rritje, por ende tejet të kufizuara dhe të përqendruara në disa fusha dhe niveli i arritjes së standardeve të cilësisë ka nevojë për përmirësim.

Sipas regjistrimit të AUV, janë 162 operatorë që përpunojnë pemë dhe perime, nga gjithsej 1399 OU (operator ushqimi) me origjinë jo shtazore. Industria përpunuese e pemëve dhe perimeve në Kosovë është duke u rritur dhe teknologjia e saj përpunuese është duke u përmirësuar. Bazuar në kapacitetet përpunuese, janë tri kategori të përpunuesve.

- Përpunuesit industrial;
- Përpunuesit e mesëm;
- Përpunuesit e vegjël.

Sipas vlerësimeve, përpunuesit e pemëve dhe perimeve mbulojnë rreth 30% të nevojave të tregut vendor.¹⁸

2.4 Sektori i prodhimit të verës

Në përgjithësi, prodhuesit ekzistues të verës kanë nevojë për mbështetje nëse prodhojnë verë cilësore, të tregtuar në shishe. Është e qartë se eksporti i verës me shumicë me cilësi të ulët nuk ofron një të ardhme të begatshme dhe vetëm vera cilësore në shishe mund t'i shtojë vlerë sektorit.

Mbështetja në drejtim të përmirësimit të cilësisë së verës do ta përmirësonte jashtëzakonisht shumë sektorin e prodhimit të verës.

MBPZHR-ja ka licencuar 29 kompani prodhuese të verës dhe të prodhimeve të tjera nga rrushi dhe vera. Tri veraritë më të mëdha përfaqësojnë përafërsisht 90% të kapacitetit të përgjithshëm të prodhimit në këtë sektor, ndërsa veraritë tjera u takojnë prodhuesve të vegjël, disa prej tyre me potencial të mirë për eksport. Po ashtu, ekzistojnë edhe prodhuesit shtëpiakë të verës dhe pijeve të forta alkoolike, të cilët në mungesë të mundësive materiale për pajisje, tanke, infrastrukturë dhe kushte higjienike-sanitare, nuk janë të licencuar nga MBPZHR-ja.

Nësektori i verës ka nevojë për mbështetje, me qëllim të përmirësimit në zbatimin e praktikave më të mira teknologjike. Orientimi aktual i kompanive është tregu i Bashkimit Evropian, i cili është sfidues dhe kërkon ngritjen e cilësisë së verës së prodhuar. Në

¹⁸ AUV 2022

eksportin e tanishëm mbizotëron tregtimi “refuz” i verës, një trend që nuk ka krijuar ndonjë rentabilitet të lartë për kompanitë prodhuese të verës.

3. Objektivat e përgjithshme

- Rritja e aftësisë konkurruese të sektorit agro-ushqimor, duke siguruar një përgjigje më të mirë të sektorit të ushqimit ndaj kërkesave shoqërore për ushqim të shëndetshëm, përfshirë ushqimin e sigurt, ushqyes dhe të qëndrueshëm, duke investuar në infrastrukturë fizike në përputhje me standardet kombëtare dhe përkatëse të BE-së;
- Adresimin e sfidës së ndryshimeve klimatike, duke promovuar energjinë e ripërtërishme dhe ekonominë qarkore;
- Adresimin në përf forcimin e pozitës së fermerëve në zinxhirin ushqimor, duke i inkurajuar ata të bashkëpunojnë në zinxhirët e furnizimit të shkurtër dhe të prodhojnë produkte me vlerë të shtuar.

3.1 Objektivat specifike

- Përmirësimin e efikasitetit dhe produktivitetit duke futur teknologji të reja për të rritur aftësinë konkurruese dhe diversitetin e produkteve në treg;
- Integrimin e fermerëve/prodhuesve të lëndës së parë me industrinë agro-përpunuese;
- Përmirësimin e kontrollit të cilësisë së produktit duke zbatuar sistemet e menaxhimit të cilësisë dhe standardet e sigurisë ushqimore, në mënyrë që të sigurohet cilësi e lartë e produkteve dhe përmbushje e kërkesave të higjienës;
- Përmirësimin e mbrojtjes së mjedisit duke investuar në objektet e trajtimit, në asgjësimin dhe menaxhimit të mbeturinave, përfshirë trajtimin e ujit sipas standardeve mjedisore;
- Përmirësimin e paketimit, marketingut dhe aktiviteteve promovuese;
- Përmirësimin e kapaciteteve ekzistuese të prodhimit dhe zgjerimin e tyre, duke synuar integrimin më të fortë të prodhimit vendas, diversifikimin e produkteve/futja në treg e produkteve të reja;
- Harmonizimi gradual me standardet e BE-së, në drejtim të mbrojtjes së mjedisit, shëndetit publik, mirëqenies së kafshëve dhe sigurisë në punë;
- Kontribut në zvogëlimin e ndryshimeve klimatike duke mbështetur prodhimin e energjisë së ripërtërishme.

4. Lidhja me masat e tjera të programit

Në veçanti, kjo masë ndërlidhet me Masën 1 “Investimet në asetet fizike në ekonominë bujqësore”, pasi që sasia dhe cilësia e prodhimeve primare bujqësore kanë efekt pozitiv në kapacitetin operativ të industrisë përpunuese dhe përdorimin racional dhe efikas të saj. Kurse me Masën “Diversifikimi i fermave dhe zhvillimi i biznesit” do të jepet mbështetje për investime në përpunimin e produkteve bujqësore dhe alternative. Kjo masë mund tëlehtësohet me bartjen e njohurive nga Masat “Përmirësimi i trajnimit” dhe “Inovacionet dhe bartja/transferi i njohurive”.

5. Përfituesit

- Përfitues mund të jenë ndërmarrjet përpunuese të prodhimeve bujqësore të regjistruara në Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve të Kosovës në nënsektorin përkatës, dhe të aprovuara/regjistruara nga AUV-i para datës së aplikimit.
- Aplikuesit në sektorin e verës, duhet të jenë të regjistruar edhe në Regjistrin e Prodhuesve të Verës në Kosovë.

6. Kriteret e përbashkëta të pranueshmërisë

6.1 Llojet e ndërmarrjeve përpunuese që mbështeten

Të gjithë aplikuesit e kësaj mase duhet të jenë të regjistruar në Regjistrin e Fermës dhe në ARBK. Kjo masë përkrah ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, të përcaktuara në bazë të Ligjit Nr. 04/L-220 Për Investime të Huaja, (Gazeta Zyrtare Nr.1/09 Janar 2014).

6.2 Qëndrueshmëria ekonomike

Qëndrueshmëria ekonomike e aplikuesit duhet të demonstrohet me anë të një plani biznesi. Të gjithë aplikuesit duhet të paraqesin një plan biznesi, në përputhje me modelin e kërkuar nga Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë. Aplikuesi duhet të demonstrojë në planin e biznesit qëndrueshmërinë ekonomike të ndërmarrjes në fund të realizimit të projektit. Ndërmarrja duhet të demonstrojë se ajo mund t'i kryejë detyrimet dhe borxhet rregullisht, pa vënë në rrezik funksionimin normal të ndërmarrjes. Plani i biznesit duhet të përmbajë një përshkrim të hollësishëm të investimeve dhe aktiviteteve të planifikuara, konform kërkesave të AUV-it për përmirësimin e standardeve. Gjithashtu, plani i biznesit duhet të tregojë se në çfarë mënyre zbatimi i projektit do të çojë në përmirësimin e performancës së përgjithshme të ndërmarrjes agro-ushqimore përmes prezantimit të perspektivës së qëndrueshmërisë financiare/ekonomike. Vlerësimi i qëndrueshmërisë financiare/ekonomike dhe perspektiva e vazhdimësisë së investimeve vlerësohet nga AZHB-ja, për të siguruar zgjedhjen e projekteve me cilësi më të lartë për sa i përket qëndrueshmërisë financiare/ekonomike. Modeli për planin e biznesit përgatitet nga AZHB-ja dhe do të publikohet në web-faqen e Agjencisë dhe MBPZHR-së.

6.3 Standardet Kombëtare / Standardet e BE-së

Ndërmarrja duhet të demonstrojë qartë planin e investimeve në biznes, plane të cilat do të ndikojnë në zbatimin e standardeve të sigurisë së ushqimit dhe uljen e rrezikshmërisë sipas kategorizimeve. Para paraqitjes së kërkesës për pagesë në AZHB, secili projekt duhet të vlerësohet nga AUV-i nëse janë plotësuar standardet minimale kryesore kombëtare sipas ligjeve në fuqi.

Përfituesit së bashku me kërkesën për pagesë dhe dokumente tjera, duhet të sigurojnë Raportin e bashkëngjitur me Listat e kontrollit nga AUV-i, që konfirmon se investimi është në përputhje me standardet minimale kombëtare. E gjithë ndërmarrja përfituese në fund të zbatimit duhet të përmbushë standardet kombëtare sipas ligjeve në fuqi.

Aplikuesit duhet të kenë Raportin/procesverbalin (jo me të vjetër se gjashtë muaj) të lëshuar nga AUV-i për gjendjen ekzistuese të operatorit dhe cilat standarde duhet t'i plotësojë. Konform kërkesave të AUV-it për përmirësimin e standardeve, plani i biznesit duhet të përmbajë një përshkrim të hollësishëm të investimeve dhe aktiviteteve të planifikuara. Para kërkesës përfundimtare për pagesë në AZHB, investimi i mbështetur duhet të plotësojë standardet kombëtare relevante në fuqi që ndërlidhen me mbrojtjen e mjedisit, shëndetin publik, mirëqenien e kafshëve dhe sigurinë në punë.

6.4 Kriteret e tjera të pranueshmërisë

Në rastin e projekteve që parashohin ndërtim, zgjerim, rinovim ose vetëm në pajisje, aplikuesit me rastin e aplikimit duhet të dorëzojnë:

- Certifikatën e pronësisë (Fletën poseduese) të parcelës në të cilën do të bëhet investimi; (Në raste kur toka/objekti është marrë me qira, fleta poseduese e tokës ku është toka/objekti duhet me qenë në emër të qiradhënësit)

- Në rast se toka ose objekti është marrë me qira, kontratën e noterizuar të qirasë për së paku 10 vjet duke llogaritur nga viti i aplikimit. Kontratat e nënshkuara dhe të noterizuara për qiramarrje para periudhës së aplikimit, duhet të mbulojnë periudhën kohore për së paku 5 vite nga dita e aprovimit;
- Kontrata duhet të përmbajë edhe pëlqimin e pronarit (qiradhënësit), për investimin që do të bëhet në tokën/objektin e tij;
- Nëse toka ose ndonjë pronë tjetër në të cilën do të bëhet investimi është në bashkëpronësi, aplikuesi duhet të sjellë pëlqimin e bashkëpronarëve dhe kopjet e letërnjoftimeve;
- Kopjen e planit të parcelës ku do të bëhet investimi;
- Kopjen e skicave të objektit.
- Të gjithë Aplikuesit (përfituesit) e projekteve në vlerë mbi 50,000 euro, janë të obliguar që së paku për 1 vit kalendarik nga dita e nënshkrimit të kontratës, të angazhojnë së paku një të diplomuar apo nga ata që janë në vitin e fundit të studimeve nga teknologjia ushqimore dhe blegtoria/zooteknika, me qëllim të realizimit të praktikës së punës. Personi i angazhuar duhet të jetë me përgatitje profesionale të njëjtë ose të përafërt me sektorin, dhe kjo të dëshmohet përmes kontratës së noterizuar.

Përpos këtyre dokumenteve, në rast të ndërtimit, zgjerimit apo rinovimit të objekteve nevojiten edhe këto dokumente shtesë:

- Aplikuesi që aplikon në investime për menaxhimin e mbetjeve dhe menaxhimin e ujërave të shkarkuara, në rastin e aplikimit të sjellin projektin ideor me përmasa dhe parallogaritje;
- Parallogaria e shpenzimeve të materialit dhe të punëve të parapara;
- Pëlqimin nga organi kompetent (Komuna) për leje të ndërtimit, në rastet e projekteve të ndërtimit/zgjerimit, por jo në rastet e projekteve të rinovimit;
- Në rast të ndërtimit/rinovimit/zgjerimit, aplikuesit duhet ta dorëzojnë edhe projektin teknik të planit të ndërtimit/rinovimit/zgjerimit;
- Të gjithë aplikuesit duhet t'i kenë të shlyera ose të rregulluara detyrimet tatimore, tatimin në te ardhura dhe tatimet tjera të aplikueshme;
- Toka/objekti ku do të realizohen investimet gjegjësisht vendosen pajisjet e blera sipas projektit, janë të pranueshme për investim edhe nëse janë nën hipotekë (qoftë në pronësi apo të marrë me qira), përjashtimisht investimet për ndërtim/zgjerim të objekteve të kategorisë D dhe për pika grumbulluese/depo ku nuk është e pranueshëm ndërtimi i tyre në token nën hipotekë;

Para kërkesës për pagesë në Agjencinë për Zhvillimin e Bujqësisë, përfituesi duhet të dorëzojë:

- Lejen për ndërtim nga organi kompetent (Komuna), nuk kërkohet për projektet e rinovimit;
- Në rastet e ndërtimeve/zgjerimeve me sipërfaqen e bazës mbi 10m², kërkohet leja e ndërtimit;
- Vlerësimin e ndikimit në mjedis, nëse është paraparë me ligj;

Dispozita tjera njoftuese

- Përfituesit nuk mund t'i jepet një projekt i ri nëse projektet e mëparshme nuk janë përfunduar në përputhje me kontratën e nënshkruar me AZHB-në;
- Projektet e financuara nga Programi i Zhvillimit Rural 2023 nuk bën të jenë të financuara edhe nga Zyra e BE-së në Kosovë apo ndonjë donator tjetër publik vendor ose ndërkombëtar;

- Në rast se përfituesi ka përfituar përkrahje për projektin e njëjtë edhe nga ndonjë donator tjetër, atij nuk i jepet përkrahja, ose nëse e ka marrë atë, ai do të detyrohet t'i kthejë mjetet e marra, si dhe ndaj tij do të zbatohen masat ndëshkimore në përputhje me legjislacionin në fuqi;
- Aplikuesit nuk mund t'i jepet një projekt i ri nëse nuk e ka përfunduar investimin paraprak. Nëse përfituesi potencial ka qenë paraprakisht përfitues i ndonjë projekti nga MBPZHR në (5) pesë vitet e fundit dhe ndodhet në periudhën monitoruese, para nënshkrimit të kontratës së re me AZHB-në, duhet të bëjë një kontroll në mënyrë që të bëhet verifikimi i projektit të mëparshëm. Nëse projekti nuk është mirëmbajtur dhe/ose nuk është funksional, atëherë nuk mund të lidhet kontrata e re;
- Të gjithë përfituesit të cilët në planin e biznesit të tyre kanë deklaruar se do të krijojnë vende të reja të punës dhe për këtë kanë përfituar pikë gjatë vlerësimit, duhet t'i krijojnë ato dhe të dëshmojnë me pagesën e kontributit pensional dhe tatimet në paga, duke filluar së paku nga muaji i fundit para kërkesës për pagesën e fundit. Përfituesit janë të obliguar të mbajnë këto vende pune të plotësuar me punëtorë me orar të plotë, për aq sa gjatë periudha monitoruese.

7. Kriteret e veçanta të pranueshmërisë

7.1 Nënsektori i përpunimit të qumështit, mishit dhe thertoret

- Të gjithë aplikuesit duhet të jenë të regjistruar në Agjencinë e Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës (ARBK) me aktivitetin përkatës dhe i aprovuar nga AUV-i para datës së aplikimit.
- Aplikuesit e kategorisë "A", "B" dhe "C" nuk janë të pranueshëm në rast të ndërtimit të objektit të ri, ndërsa janë të pranueshëm në rast të rinovimit të objektitekzistues dhe investimeve në pajisje.
- Aplikuesit e kategorisë "D" janë të pranueshëm vetëm në rast të ndërtimit të objektit të ri dhe mbylljes së objektit ekzistues. Investimet në pajisje/linjapërpunimi për këtë kategori janë të pranueshme nëse në biznes-plan prioritet i është dhënë ndërtimit të objektit.

7.2 Nënsektori i përpunimit të pemëve, perimeve dhe pika grumbulluese/depo të prodhimeve bujqësore

- Të gjithë aplikuesit duhet të jenë të regjistruar në Agjencinë e Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës (ARBK) me aktivitetin përkatës dhe të regjistruar nga AUV-i para datës së aplikimit.
- Në rast të investimit në pikë grumbulluese/depo ekzistuese, kapaciteti minimal i ruajtjes duhet të jetë 1000 m³. Në rast të zgjerimit të objektit ekzistues, ky objekt duhet të ketë kapacitet minimal prej 500 m³, ndërsa objekti i zgjeruar duhet të arrijë kapacitetin minimal 1000 m³.

7.3 Nënsektori i prodhimit të verës

- Të drejtë aplikimi kanë ndërmarrjet e regjistruara në Regjistrin e Prodhuesve të Verës dhe në Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve të Kosovës para datës së aplikimit. Prodhuesit e verës duhet që së paku 50% të lëndës së parë (rrushit) ta sigurojnë nga prodhuesit e tjerë (jo prodhim vetanak).
- Ky kriter nuk vlen për prodhuesit e verës që kanë në pronësi mbi 50 ha me vreshta. Aplikuesit duhet të dëshmojnë se e kanë deklaruar prodhimin vjetor të verës dhe të stoqeve të ngelura.

7.4 Investimet në prodhimin e energjisë së ripërtëritshme

Në kuadër të këtij investimi mbështetet prodhimi i energjisë elektrike nga burimet ripërtëritshme për "vetë-konsum". (d.m.th. kapaciteti prodhues i energjisë e huazuar/depozituar në rrjet është mesatarisht i barabartë me energjinë elektrike të shpenzuar gjatë vitit). Kjo justifikohet me faktin se, meqenëse energjia elektrike nuk mund të ruhet, ajo nëse nuk harxhohet, duhet të lëshohet në rrjet; rrjeti i energjisë elektrike mund të konceptohet si një vend depozitimi për energjinë elektrike ku futet dhe tërhiqet gjatë vitit në sasi të ngjashme dhe me një ritëm të ndryshëm. Koncepti i "vetë-konsumit" duhet të kontrollohet në fazën në të cilën paraqitet/vlerësohet një projekt. Investimi konsiderohet i pranueshëm kur kapaciteti (teorik) i energjisë i impiantit të energjisë së ripërtëritshme ("investimi") nuk tejkalon 120% të konsumit mesatar prej 3 vjetësh të ndërmarrjes.

8. Investimet e përbashkëta të pranueshme

Investimet e pranueshme janë të kufizuara në ato që janë përfshirë në Listën e Investimeve për masën 3 :

- Ndërtimi/rinovimi i objekteve. Ndërtimi do të jetë i pranueshëm vetëm për kategorinë "D", kurse investimi në pajisje do të jetë i pranueshëm për të gjitha kategoritë ("A", "B", "C" dhe "D").
- Blerja e makinerive dhe pajisjeve të reja, duke përfshirë programe kompjuterike të nevojshme për funksionimin e linjave të prodhimit apo funksioneve të tjera primare që ndërlidhen me aktivitetet kryesore të ndërmarrjes;
- Investimet në përpunimin e qumështit, mishit, pemëve dhe të perimeve, si dhe prodhimin të verës, përfshirë edhe investimet e marketingut për promovimin e tyre;
- Shpenzimet e pranueshme të marketingut për të gjitha nën masat e Masës 3 janë: përgatitja dhe shtypja e katalogëve, fletëpalosjeve, broshurave, posterëve etj, për promovimin e produkteve, por jo edhe për shpërndarjen e tyre. Po ashtu, shpenzimet e pranueshme të marketingut janë edhe prodhimi i audio dhe video-spotëve promovuese, por jo edhe shpërndarja e tyre mediale;
- Vlera maksimale e shpenzimeve të pranueshme për marketing është e kufizuar në 5% të totalit të shpenzimeve të pranueshme, por jo më shumë se 10,000 €;
- Shpenzimet e tjera të ndërlidhura me projektin, siç janë: shpenzimet për arkitekt, për inxhinier dhe shpenzimet për studime parapake, si dhe nxjerrja e dokumenteve dhe lejeve relevante janë të pranueshme deri në 7% të shpenzimeve të pranueshme por jo më shumë se 15,000 €, kurse shpenzimet për përgatitjen e planit të biznesit janë të pranueshme deri në 3% të shpenzimeve të pranueshme për projekt, por jo më shumë se 5,000 €;
- Shpenzimet administrative, edhe pse ndodhin para nënshkrimit të kontratës, janë të pranueshme vetëm në qoftë se projekti është përzgjedhur dhe është kontraktuar nga Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë.

8.1 Investimet e pranueshme për sektor

8.1.1 Investimet e pranueshme për nënmasën e përpunimit të qumështit

- Investimet në ndërtim/rinovim të qumështoreve. Investimet në ndërtim të qumështoreve të reja janë të pranueshme vetëm për aplikantet te cilët në kohën e aplikimit gjenden në kategorinë “D”;
- Investimet në pajisje për përmirësimin e higjienës, cilësisë dhe sigurisë së prodhimeve (sidomos për të arritur standardet HACCP dhe/ose ISO 22000); *Nuk finanohet certifikimi HACCP dhe/ose ISO 22000;*
- Investimet në pajisje për përmirësimin e mbrojtjes së mjedisit, sidomos për menaxhimin e mbetjeve dhe trajtimin e ujërave të shkarkuara;
- Investimet në mjete të specializuara të transportit të qumështit nga fermerët në objekt dhe të produkteve të qumështit nga objekti në treg (përfshirë mjetet e specializuara të transportit të ftohtë);
- Investimet në pajisje për prodhime të reja dhe paketime moderne;
- Pajisje të IT-së, digjitalizim, harduer dhe softuer për monitorim, kontroll dhe menaxhim;
- Laboratorët dhe pajisje për kontrollin e cilësisë;
- Investimet në teknologji për prodhimin e energjisë së ripërtëritshme;
- Investimet në pajisje për ftohje.
- Investimet për marketing.

8.1.2 Investimet e pranueshme për nënmasën e përpunimit të mishit dhe thertore

- Investimet në ndërtim/rinovim të objekteve ekzistuese, përfshirë depot ftohëse bashkë me pajisje. Investimet në ndërtime të reja, të pranueshme vetëm për aplikantet te cilët në kohën e aplikimit janë në kategorinë “D”;
- Investimet në pajisje për përpunim të mishit dhe thertoreve;
- Investimet në pajisje për përmirësimin e higjienës, si dhe cilësisë dhe sigurisë së prodhimeve (sidomos për të arritur standardet HACCP dhe/ose ISO 22000); *Nuk finanohet certifikimi HACCP dhe /ose ISO 22000*
- Investimet në pajisje për përmirësimin e mbrojtjes së mjedisit, sidomos për menaxhimin e mbetjeve dhe trajtimin e ujërave të shkarkuara;
- Investimet për pajisje për kontroll të cilësisë, përfshirë laboratorët përkatës;
- Investimet për pajisje për ftohje dhe ngrirje për ruajtjen e prodhimeve të gatshme;
- Pajisje të IT-së, digjitalizim, harduer dhe softuer për monitorim, kontroll dhe menaxhim;
- Automjete të specializuara për bartjen e lëndës së parë dhe prodhimeve të gatshme;
- Investimet në teknologji për prodhimin e energjisë së ripërtëritshme.
- Investime në marketing.

8.1.3 Investimet e pranueshme për nënmasën e përpunimit të pemëve (përfshirë, pataten) dhe pika grumbulluese/depo të prodhimeve bujqësore

- Investimet në rinovim të objekteve për përpunim;
- Investimet në pika grumbulluese/depo të prodhimeve bujqësore, lejohet ndërtimi zgjerimi/rinovimi dhe investimi në pajisje.
- Investimet në linja për konservim/pasterizim të pemëve dhe perimeve;
- Investimet në pajisje për përmirësimin e higjienës, si dhe cilësisë dhe sigurisë së prodhimeve (sidomos për të arritur standardet HACCP dhe/ose ISO 22000); ***Nuk financohet certifikimi HACCP dhe /ose ISO 22000;***
- Investimet në objekte dhe pajisje për trajtim pas vjeljes, për tharje, për klasifikim dhe për deponim;
- Investimet në pajisje për paketim, për etiketim, përfshirë linjat e mbushjes, mbështjellësit dhe pajisje të tjera të specializuara;
- Investimet në pajisje për zinxhirin ftohës, duke përfshirë depo për ftohje dhe ngrirje, tunele të ngrirjes, mjete transportuese me frigorifer dhe pajisje të tjera të nevojshme për të siguruar vazhdimësinë në zinxhirin e ftohjes;
- Investimet në pajisje për përmirësimin e mbrojtjes së mjedisit, sidomos për menaxhimin e mbetjeve dhe trajtimin e ujërave të shkarkuara;
- Investimet për pajisje për kontroll të cilësisë, përfshirë laboratorët përkatës;
- Automjete të specializuara për bartjen e lëndës së parë dhe prodhimeve të gatshme, me ftohje dhe pa ftohje;
- Pajisje të IT-së, digjitalizim, harduer dhe softuer për monitorim, kontroll dhe menaxhim;
- Investimet në teknologji për prodhimin e energjisë së ripërtëritshme;
- Investimet në marketing.

8.1.4 Investimet e pranueshme për nënmasën e prodhimit të verës

- Investimet në rinovim të objekteve për prodhimin dhe përpunimin e verës;
- Investimet në pajisje për përpunimin e verës;
- Investimet në pajisje për përmirësimin e higjienës, si dhe cilësisë dhe sigurisë së prodhimeve (sidomos për të arritur standardet HACCP dhe/ose ISO 22000); ***Nuk financohet certifikimi HACCP dhe/ose ISO 22000;***
- Investimet në pajisje për paketim, për etiketim, përfshirë linjat e mbushjes, ambalazhës dhe pajisje të tjera të specializuara;
- Investimet në teknologji për prodhimin e energjisë së ripërtëritshme;
- Investimet për pajisje dhe aparatura për kontroll të cilësisë së verës, përfshirë laboratorët përkatës;
- Pajisje të IT-së, digjitalizim, harduer dhe softuer për monitorim, kontroll dhe menaxhim të prodhimit verës;
- Investimet në marketing.

9. Kriteret e përzgjedhjes për të gjithë nënsektorët

Nr	Kriteret e përzgjedhjes	Pikët
1.	Investimet në arritjen e standardeve kombëtare të sigurisë së ushqimit	25
2.	Investimet në projekte për përmirësim të pozitës së fermerëve në zinxhirin e vlerës (lidhja e kontratave/të noterizuara) ¹⁹	20
3.	Investimi në prodhimin e energjisë në ndërmarrje nga burimet e ripërtëritshme (min. 10% investimit të pranueshëm) ²⁰	20
4.	Investimet që kanë të bëjnë me trajtimin e mbeturinave, pastrimin e ujit dhe/ose shfrytëzimin e produkteve të mbeturinave - ekonomia qarkore	15
5.	Investime që shpijnë në inovacion dhe diversifikim të prodhimit Futja e të paktën dy produkteve të reja (ose dy lloje të ndryshme të verërave)	10
6.	Aplikuesit kanë pasur afarizëm pozitiv gjatë 2 vjetëve të fundit (shih dokumentin: Gjendja e përgjithshme e deklarimeve dhe transaksioneve tjera nga ATK)	5
7.	Krijimi i vendeve të punës (për çdo punëtor të ri të punësuar nga një pikë, por jo më shumë se 5 pikë në total)	5
	Totali	100

Përfituesi që ka paraparë investime në përdorimin e energjisë së ripërtëritshme dhe fiton pikë për këtë qëllim, është i obliguar që këtë investim ta përdorë dhe mbajë aktiv për qëllimet që i ka paraparë në planin e biznesit. Nëse gjatë cילו kontroll nga zyrtarët e AZHB- së (para nënshkrimit të kontratës, ad-hoc ose Ex-post) konstatohet që investimet në energji të ripërtëritshme nuk janë duke u përdorur ashtu siç parashihet në planin e biznesit, atëherë do të aplikohet Neni 54 i Ligjit Nr.08/L-072 për Bujqësi dhe Zhvillim Rural.

10. Shkalla e përkrahjes publike

- Intensiteti i ndihmës (ndihma publike) është 50% e shumës së përgjithshme të shpenzimeve të pranueshme për projekt.
- Vlera minimale e shpenzimeve të pranueshme për projekt brenda kësaj mase është 50,000 €;
- Vlera maksimale e shpenzimeve të pranueshme për projekt brenda kësaj mase është 400,000 €;
- Si shpenzim i pranueshëm për të gjitha nënmasat do të jetë edhe angazhimi i një studenti në vitin e fundit të studimeve apo një sapodiplomuari në fushën e teknologjisë ushqimore ose blegtorisë/zooteknikës. Vlera e mbështetjes nga

¹⁹ Investimet në projekte për të përmirësuar pozitën e fermerëve në zinxhirin e vlerës (lidhja e kontratave/të noterizuara)

a) se paku 80% e lëndës së parë të qumështit e kontraktuar të jetë nga prodhimi vendor;

b) se paku 30% e lëndës së parë e mishit të kontraktuar të jetë nga prodhimi vendor;

c) se paku 80% e lëndës së parë të pemëve, perimeve dhe rrushit të kontraktuar të jetë nga prodhimi vendor;

(këto duhet të dëshmojnë përmes kontratave të noterizuara ndërsa prodhimi vetanak i ndërmarrjes dëshmohet me plan biznesi)

(këto duhet të dëshmojnë përmes kontratave të noterizuara ndërsa prodhimi vetanak i ndërmarrjes dëshmohet me plan biznesi).

²⁰

Përfituesi që ka paraparë investime në prodhimin e energjisë së ripërtëritshme dhe fiton pikë për këtë qëllim, është i obliguar që këtë investim ta përdorë dhe mbajë aktiv për qëllime që i ka paraparë në planin e biznesit. Nëse gjatë secilës kontroll nga zyrtarët e AZHB-së (ad-hoc ose ex- post) konstatohet që investimet në energji të ripërtëritshme nuk janë duke u përdorur ashtu siç parashihet në biznes plan atëherë do të ndëshkohet sipas legjislacioni në fuqi .

MBPZHR do të jetë 2,400 euro brenda një viti kalendarik, e dëshmuar përmes kontratës së noterizuar.

- Përkrahja maksimale publike për periudhën programuese (2023-27) për Masën 3 nuk mund të tejkalojë shumën prej 600,000 € për përfitues.
- Aplikuesi mund të aplikojë me disa projekte gjatë periudhës së zbatimit të këtij programi në vite të ndryshme, me kusht që projektet e mëhershme të jenë përfunduar me sukses dhe përkrahja publike të mos e tejkalojë shumën e lartpërmendur.
- Pagesa për Masën 3 bëhet në dy këste: pjesa e parë e përkrahjes publike në vlerë prej 50% bëhet në formë të paradhënies pas nënshkrimit të kontratës me përfituesin, me kusht të sigurimit të garancionit bankar, ndërsa pjesa tjetër e mbetur prej 50%, paguhet pas verifikimit të përfundimit të investimit të përgjithshëm;
- Garancioni bankar duhet të sigurohet vetëm për paradhënien prej 50% të përkrahjes publike;
- Garancioni bankar duhet të sigurohet për periudhën kohore deri sa të realizohet pagesa e fundit nga AZHB-ja, respektivisht deri te vendimi i fundit nga Komisioni i Ankesave. Çdo kërkesë për afat shtesë duhet të mbulohet me garancion bankar.

11. Buxheti

	MASA 3	Buxheti	%
1	Përpunimi i qumështit	500,000.00	14.29
2	Përpunimi i mishit	500,000.00	14.29
3	Përpunimi i mishit të shpezëve/investime në Thertore	500,000.00	14.29
4	Përpunimi i pemëve dhe perimeve	500,000.00	14.29
5	Përpunimi i verës	700,000.00	20.00
6	Pika grumbulluese/depot	800,000.00	22.86
	Totali i buxhetit	3,500,000.00	100.00

12. Treguesit

TREGUESIT	CAQET
Numri i ndërmarrjeve agro- përpunuese të modernizuara	27
Numri i ndërmarrjeve përpunues qumështi	4
Numri i ndërmarrjeve përpunues mish	4
Numri i ndërmarrjeve përpunues pemë/perime	4
Numri i pikave grumbulluese/Depot	6
Numri i ndërmarrjeve përpunues të verës	4
Numri i përfituesve që kanë bërë investime në energjinë e ripërtëritshme	25
Numri i përfituesve që kanë bërë investime në trajtimin e mbetjeve dhe ujërave	27
Numri i vendeve të reja të punës	40
Vlera totale e investimeve publike	3,500,000.00
Vlera e përgjithshme e investimit	7,000,000.00

13. Procedura administrative

Kjo masë do të zbatohet nga Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë (AZHB). Procedurat administrative të detajuara do të paraqiten në Udhëzimin Administrativ i cili miratohet nga Ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

Vlerësimi përfshin verifikimin e dokumentacionit të dorëzuar (të jetë i plotë), kontrollët e pranueshmërisë (përfshirë projekt propozimin/planin e biznesit) dhe vlerësimi me pikë i projekteve. Raportet e vlerësimit do të publikohen. Të gjithë aplikuesit do të kenë mundësinë të paraqesin ankesë. Procedura e vlerësimit do të jetë pjesë e Udhëzimit Administrativ, të miratuar nga MBPZHR.

14. Afati i Zbatimit

Afati i zbatimit të projekteve të kësaj mase është 10 muaj nga dita e nënshkrimit të kontratës me AZHB-në. Pas kësaj periudhe, përfituesi ka edhe 15 ditë shtesë për përgatitjen e dokumentacionit dhe paraqitjen e kërkesës për pagesë. AZHB-ja mund të zgjasë afatin e zbatimit për më së shumti 2 muaj, nëse ka arsye të qëndrueshme për këtë, siç janë kushtet e papërshtatshme klimatike, sjellja e ndonjë makinerie specifike prej ndonjë vendi tjetër.

15. Shtrirja gjeografike e masës

Kjo masë aplikohet në tërë territorin e Republikës së Kosovës.

MASA 7: DIVERSIFIKIMI I FERMËS DHE ZHVILLIMI I BIZNESIT

1. Baza ligjore

- Ligji Nr.08/L-072 për Bujqësi dhe Zhvillim Rural (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/ Nr. 8/ 29 mars 2023;
- Strategjia për Bujqësi dhe Zhvillim Rural 2022-2028, vendim i Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr.12/50, i datës: 23.12.2021;
- Programi Kombëtar për Bujqësi dhe Zhvillim Rural 2023-2027, vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës, Nr.15/151 12.07.2023;

2. Arsyeshmëria

Zonat rurale kanë një rëndësi të madhe për zhvillimin e përgjithshëm të vendit dhe paraqesin potencial për diversifikimin e aktiviteteve ekonomike, për krijimin e vendeve të punës si dhe të hyrave shtesë. Këto zona janë të mëdha dhe janë të pasura me burimet natyrore, kulturore dhe historike. Kushtet e jetesës në zonat rurale janë më të vështira, prandaj është e evidente shpërngulja e vazhdueshme drejt zonave urbane. Papunësia në këto zona është më e shprehur, veçanërisht tek gratë dhe tek të rinjtë. Investimet në zona rurale shihen si mundësi të forcimit të lidhjes së ekonomive rurale dhe urbane. Banorët e zonave rurale mund të shohin diversifikimin e aktiviteteve si mundësi për zhvillim të zonave ku jetojnë.

Problemet me të cilat ballafaqohen banorët e zonave rurale janë të shumta, por kryesore janë:

- Mungesa e vendeve të punës;
- Varësia e lartë nga bujqësia;
- Cilësia e dobët e jetesës, mungesa e shërbimeve të nevojshme dhe infrastrukturës;
- Shpopullimi dhe plakja demografike.

Masa 7 “Diversifikimi i fermës dhe zhvillimi i bizneseve” do të mbështesë një varg aktiviteteve bujqësore dhe jo bujqësore që do të ndihmojnë në përmirësimin e cilësisë së jetës së popullatës në zonat rurale. Në kuadër të masës, përparësi do t’u jepet projekteve të realizuara në zonat malore, femrat ndërmarrëse, fermerët e rinj dhe projektet që do të krijojnë vende të reja të punës në zonat rurale.

Në bazë të analizës sektoriale për diversifikimin e ekonomisë rurale në Kosovë, do të mbështeten disa aktiviteteve që shihen me perspektivë afatgjate për zhvillimin e ekonomisë rurale. Prioritet shtesë do t’u jepet projekteve të rekomanduara nga Grupet Lokale të Veprimit (GLV).

2.1 Grumbullimi dhe përpunimi i produkteve pyjore jo drusorë përfshirë bimët mjekësore dhe aromatike (BMA-të e grumbulluara apo të kultivuara)

Produktet pyjore jo drusorë (PPJD) dhe bimët mjekësore aromatike (BMA) janë produktet e rëndësishme që rriten si të egra dhe të kultivuara. Më shumë se 300 lloje të PPJD-it dhe BMA mbledhen/grumbullohen si të egra, dhe një numër i konsiderueshëm i llojeve kultivohen. Të paktën 67 lloje kanë vlerë tregtare dhe kontribuojnë në krijimin e të ardhurave dhe mirëqenien ekonomike të familjeve që jetojnë në zona rurale.

Vlerësohet që në vendin tonë janë rreth 20,000 vjelës, kryesisht gra, dhe shpesh familje të tëra, të ardhurat e të cilave variojnë nga 12-15 EUR në ditë. Fermerët që kultivojnë PPJD dhe BMA-t janë ata që kryesisht u përgjigjen kërkesave të ndërmarrjeve që eksportojnë këto produkte. Vlerësohet se janë diku rreth 100 mbledhës/përpunues të PPJD dhe BMA, ndërsa rreth 42 përpunues/eksportues operojnë në vend, të cilët kanë linjat e përpunimit dhe paketimit që plotësojnë kërkesën e tregut ndërkombëtar në aspektin e standardeve të

cilësisë dhe sigurisë. Përafërsisht 95% e totalit të PJDP dhe BMA eksportohet në tregun e BE-së. Në vitin 2022²¹, shuma totale e eksportit të PJDP dhe BMA-ve ishte 16,027,858.4 EUR, ku shumica (86.59 %) të eksportit ishte PJDP, ndërsa, shitjet në vitin 2020 kane qenë 12.5 milion EUR, nga kjo 11.85 milion EUR janë eksporte ose 94%; Në shitjet e eksportit, PPJD merr pjesën kryesore; në vitin 2020, 87% e shitjeve totale ishin nga PPJD, 11% BMA dhe vetëm 2% e shitjeve vinin nga farat - kjo tregon për rëndësinë se PPJD dhe arsyt kryesore për këtë është disponueshmëria e PPJD në Malet e Kosovës, tradita e mbledhësve në zonat rurale, si dhe lidhjet e mira të eksportuesve me blerësit në vendet e eksportit. MBPZHR ka sistemin për lëshimin e licencave për grumbulluesit e bimëve mjekësore dhe bimëve të egra. Për përfituesit e kësaj Mase është me rëndësi të jenë të licencuar, për të siguruar qëndrueshmërinë e sektorit.

2.2 Zhvillimi i turizmit rural dhe agro – turizmit

Turizmi në Kosovë është një ndër sektorët me potencial për zhvillim. Zhvillimet në turizëm kanë pas trende pozitive deri në viti 2019. Pandemia ka pasur ndikim negativ në këtë sektor në vitin 2020 dhe ende po vazhdon. Duke u bazuar në përparësitë dhe mundësitë që ka Republika e Kosovës, ekziston një potencial i madh për zhvillimin e turizmit rural dhe agro-turizmit. Duke e parë këtë potencial, Qeveria e Republikës së Kosovës në Programin Qeverisës 2021-2025, e trajton zhvillimin e sektorit të turizmit si njërin nga prioritetet e veta, duke e nënvizuar si njërin nga fushat me prioritet për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik. Fokusi kryesor i Qeverisë së Republikës së Kosovës parashihet të jetë zhvillimi i turizmit kulturor dhe turizmit natyror (atij malor dhe rural), përmes zgjerimit të ofertës turistike, përmirësimit të infrastrukturës, digjitalizimit dhe hartimit të planeve ndër-sektoriale. Turizmi rural është një ndër sektorët e turizmit që mund të kontribuojë në shumë mënyra për ta bërë Kosovën më tërheqëse si destinacion. Veçanërisht turizmi malor i bazuar në qëndrimin në fermë, ecjet në natyrë, çiklizmi si dhe ofertave të ndryshme me ushqimeve tradicionale. Kosova ka plot për të ofruar. Degustimii verës, ajvari, lëngu i mollës, rakia, djathi i Sharrit dhe plot gatime vendore. Parku Kombëtar "Malet e Sharrit" me 53,272 hektarë dhe Parku Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna" me 63,028 hektarë janë zona turistike shumë tërheqëse. Objektet e trashëgimisë kulturore të rinovuara paraqesin potencial për turizmin rural. Ligji kombëtar për turizmin rural është në përgatitjen e sipër, për stimulim të mëtejshëm të zhvillimit të këtij sektori.

2.3 Përpunimi i prodhimeve bujqësore në ekonomi familjare

Shumë ekonomi familjare merren me përpunimin shtëpiak të perimeve, pemëve, qumështit, përgatitje të ëmbëlsirave, të brumërave etj. Disa përfitues të granteve të MBPZHR-së për përpunim në ekonominë familjare, tregojnë se kanë pasur rritje vjetore të shitjes rreth 20-25%. Sasia mesatare e përpunuar në vitin 2020 ishte 5.5 tonë/fermë. Përpunimi në fermë kontribuon rreth 2% në industrinë e përpunimit të pemëve dhe perimeve, dhe rreth 10% në punësimin total në industrinë përpunuese të pemëve dhe perimeve.

Prodhimet e përpunuara në ekonomi familjare nuk kanë problem me shitje, por problemi i tyre është sasia e vogël e produkteve të ofruara në treg.

Kërkesat e shtuara për prodhime bujqësore nga ekonomitë familjare me cilësi të mirë, hapin mundësi për përpunuesit në fermë, sidomos për gratë e papuna që të krijojnë të ardhura shtesë për nevojat familjare dhe të vetëpunësohen në vendin ku jetojnë.

2.4 Prodhimi i mjaltit

Pozicioni gjeografik i Kosovës ofron një ambient të përshtatshëm për zhvillimin e bletarisë. Përkundër kushteve të volitshme klimatike, sasia mesatare e mjaltit të prodhuar

²¹ ORGANIKA

për koshere është ende e vogël - rreth 10 kg, që është shumë më ulët nëse krahasohet me vendet e rajonit ose vendet evropiane (22 kg/koshere).

Në vitin 2019, mbi 90% e prodhimit të përgjithshëm të mjaltit ishte shitur në tregunvëndor. Pothuajse e gjithë sasia e mjaltit vëndor është shitur në tregun joformal. Importi i mjaltit në vitin 2019 ishte 229 tonë.

Çmimi i 1 kg të mjaltit në fermë është vlerësuar 11.85 EUR, që konsiderohet shumë i lartë krahasuar me vendet e tjera të rajonit dhe BE-së.

2.5 Aktivitetet jo-bujqësore në zona rurale

Krijimi i vendeve të punës në zonat rurale është thelbësor për ndalimin e shpërnguljes së popullatës prej këtyre zonave.

Investimet/mbështetja në zona rurale mund ta forcojë lidhjen midis ekonomive rurale dhe urbane.

Me zhvillimin e turizmit rural, gjithnjë e më shumë do të ketë nevojë për ofrimin e aktiviteteve të ndryshme jo bujqësore, me qëllim të përmirësimit të cilësisë së jetës në zona rurale dhe parandalimin e shpërnguljes në zona urbane.

Si veprimtari ekonomike në zonat rurale duhen të merren në konsideratë zhvillimi i bizneseve në ofrimin e shërbimeve, siç janë kujdesi për të moshuarit, për fëmijë, aktiviteteve kulturore dhe sportive për të rinjë etj.

Aktivitetet jo-bujqësore në zona rurale

- Prodhimi dhe përpunimi produkteve nga lëkura;
- Prodhimi dhe përpunimi i produkteve nga leshi;
- Prodhimi dhe përpunimeve produkteve nga druri;
- Prodhimi dhe përpunimi produkteve nga metali;
- Prodhimi dhe përpunimi produkteve nga letra/kartoni;
- Prodhimi dhe përpunimi nga plastika;
- Prodhimi dhe përpunimi produkteve nga poçaria dhe qeramika;
- Prodhimi dhe përpunimi i produkteve nga tekstili;
- Prodhimi i humusit.

2.6 Rritja e shpezëve të fshatit

Kërkesat për produktet e ashtuquajtura të “fshatit” janë duke u rritur.

Është vërejtur kërkesë e shtuar për vezë nga pulat e “fshatit” dhe për mish të shpezëve nga fermat e vogla, të cilat shpezët i mbajnë të lira në natyrë.

Pasi kërkesa e tregut për këto prodhime është rritur, ekonomitë familjare në zonat rurale të cilat kanë hapësirë të mjaftueshme, mund të merren me këto aktivitete dhe të sigurojnë hyra shtesë.

2.7 Kultivimi i peshkut

Kultivimi i peshkut është nënsektor jo shumë i zhvilluar në Kosovë, po me një potencial për zhvillim.

Gjatë viteve të fundit, ka pasur një rritje të numrit të fermave të vogla familjare që kultivojnë peshkun në ujëra të ëmbla. Pjesa më e madhe e tyre e kultivojnë e peshkun për restorante. Nga 35 ferma që e kultivojnë peshkun, 17 sosh e kombinojnë prodhimin e peshkut me restorant apo me ndonjë tjetër shërbim turizmi.

Si veprimtari ekonomike, kultivimi i peshkut jep kontribut të rëndësishëm në punësim. Duke qenë se fermat e peshkut me ujë të freskët ndodhen kryesisht në zona rurale, është një mundësi e punësimit për banorë dhe zhvillim të këtyre zonave.

3. Objektivi i përgjithshëm

Objektivi i përgjithshëm i kësaj mase është zhvillimi socio-ekonomik i zonave rurale përmes krijimit të vendeve të reja të punës zhvillimit të biznesit rural, duke ngritur kështu nivelin e aktivitetit ekonomik të zonave rurale dhe duke ndikuar në ndaljen migrimit rural.

Objektivat e veçanta

Objektivat specifike të masës do të synojnë krijimin, diversifikimin dhe zhvillimin e aktiviteteve rurale, nëpërmjet mbështetjes për investimet në diversifikimin e fermave dhe zhvillimin e aktiviteteve jobujqësore në sektorët e mëposhtëm:

- 7.1 Grumbullimi, përpunimi dhe promovimi i produkteve pyjore jo drusore;
- 7.2 Zhvillimi dhe promovimi i turizmit rural;
- 7.3 Përpunimi i prodhimeve bujqësore në ekonomi familjare;
- 7.4 Prodhimi i mjaltit;
- 7.5 Aktivitete jo-bujqësore në zona rurale;
- 7.6 Rritja e shpezëve të fshatit;
- 7.7 Kultivimi i peshkut.

4. Lidhja me masat e tjera të PZHR –së

Masa 7 "Diversifikimi i fermës dhe zhvillimi i biznesit" plotëson zbatimin e Masave 1 "Investimet në asete fizike të ekonomive bujqësore" dhe 3 "Përpunimi dhe tregtimi i produkteve bujqësore". Për më tepër, kjo masë është e përshtatshme për një zbatim edhe nëpërmes të Masës 5 "Zbatimi i Strategjive të GLV-ve" qasja Leader. GLV-të përgatisin strategjitë e zhvillimit lokal duke identifikuar aktivitete që janë të pranueshme në Masën 7 "Diversifikimi i fermës dhe zhvillimi i biznesit" siç janë projektet e vogla për zonat e tyre specifike që mbulohen me qasjen LEADER.

5. Përfituesit

- Përfituesit përfundimtarë në këtë masë janë fermerët, sipas definicionit nga Ligji Nr.08/L-072 për Bujqësi dhe Zhvillim Rural (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/ Nr. 8/29 mars 2023) dhe ndërmarrjet sipas Ligjit Nr. 04/L-220 Për Investime të Huaja, (Gazeta Zyrtare Nr.1/09 Janar 2014).
- Në rastin e ndërmarrjeve, përfitues mund të jenë: mikro ndërmarrjet dhe ndërmarrjet e vogla (këto ndërmarrje mund të jenë përfituese pa marrë parasyshku janë të themeluara, në zona rurale apo urbane, mirëpo që aktivitetin e tyre e zhvillojnë në zona rurale).
- Në rastin e personave juridik, biznesi duhet të jetë regjistruar me aktivitetin përkatës për të cilën aplikon. (Biznesi në listën e kodeve të aktiviteteve duhet të kenë të regjistruar edhe aktivitetin për të cilin aplikon).
- GLV – të mund të jenë përfitues (vetëm nëse janë të akredituara nga MBPZHR).

6. Krite të përbashkëta të pranueshmërisë

- Të gjithë aplikuesit duhet të jenë të regjistruar në Regjistrin e Fermës;
- Nëse aplikuesi është person fizik, ai duhet të jetë mbi 18 vjeç, por jo më i vjetër se 65 vjeç deri në ditën e aplikimit. Në rastin e personit juridik ky kriter nuk aplikohet;

- Aplikuesit duhet ta dorëzojnë aplikacionin me të gjitha dokumentet e nevojshme në listë e dokumenteve të kërkuara dhe të paraqitura në Udhëzuesin për Aplikues;
- Investimi duhet të kryhet në zona rurale (sipas përkufizimit të Programit për Bujqësi dhe Zhvillim Rural 2023-2027 për zona malore);
- Personi fizik duhet ta ketë të përfunduar shkollimin e detyrueshëm elementar (8 ose 9 vjeçar) (Në rast të personit juridik kjo vlen për pronarin ose personin e autorizuar);
- Të gjithë aplikuesit duhet të dorëzojnë certifikatën e pronës/fletën poseduese dhe kopjen e planit (për vendin e investimit);
- Të gjithë aplikuesit duhet t'i kenë të shlyera ose të rregulluara detyrimet tatimore, tatimin në te ardhura dhe tatimet tjera të aplikueshme;
- Aplikuesit nuk duhet të kenë obligime financiare ndaj MBPZHR-së;
- Të gjithë përfituesit e projekteve të zhvillimit rural obligohen t'i mirëmbajnë investimet e tyre sipas projektit të miratuar gjatë tri vjetëve pas realizimit të projektit, aq sa zgjatë periudha monitoruese. Nëse nuk i mirëmban investimet, përfituesi obligohet ta kthejë shumën e financuar të përkrahjes publike;
- Për projektet investuese në të cilat investimet e pranueshme janë më të vogla ose baras me 20,000 €, aplikuesit duhet ta dorëzojnë një projekt-propozim sipas modelit të AZHB-së. Projekt-propozimi për nënmasën e turizmit rural është i veçantë; Projekt propozimi duhet të përfshijë edhe rrjedhën e parasë dhe tabelën e kthimit të investimit;
- Për projektet investuese në të cilat investimet e pranueshme janë më të mëdha se 20,000 €, aplikuesit duhet ta dorëzojnë një plan të biznesit sipas modelit të AZHB-së. Plani i biznesit për nënmasën e turizmit rural është i veçantë;
- Përfituesit të cilët në Planin e Biznesit janë zotuar të kenë të punësuar, duhet të regjistrohen në ARBK, së paku si biznes individual dhe të gjitha pagesat duhet të bëhen nga llogaria e biznesit;
- Modelet për projekt-propozim për planin e biznesit do të publikohen në web-faqen e Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë (AZHB) dhe MBPZHR-së, dhe do të jenë në dispozicion për të gjithë aplikuesit;
- Të gjithë përfituesit, të cilët në planin e tyre të biznesit kanë deklaruar se do të krijojnë vende të reja të punës dhe për këtë kanë fituar pikë gjatë vlerësimit, duhet t'i krijojnë ato dhe të dëshmojnë me pagesën e kontributit pensional dhe tatimit në paga, duke filluar të paktën nga muaji i fundit para kërkesës për pagesën e fundit. Përfituesit janë të obliguar t'i mbajnë këto vende pune të plotësuar me punëtorë me orar të plotë për 5 vjet, aq sa zgjatë periudha monitoruese;
- Projektet e financuara nga Programi i Zhvillimit Rural nuk duhet të jenë të financuara edhe nga Zyra e BE-së në Kosovë apo ndonjë donator tjetër publik vendor ose ndërkombëtar. Në rast se vërtetohet se përfituesi ka përfituar përkrahje për projektin e njëjtë edhe nga ndonjë donator tjetër, atij nuk i jepet përkrahja ose nëse e ka marrë atë, ai do të detyrohet t'i kthejë mjetet e marra, si dhe ndaj tij do të zbatohen masat ndëshkimore në përputhje me ligjin;
- Përfituesit nuk mund t'i jepet një projekt i ri nëse projektet e mëparshme nuk janë përfunduar në përputhje me kontratën e nënshkruar me AZHB-në;
- Aplikuesi mund të aplikojë vetëm me një projekt brenda vitit;
- Ndihma maksimale publike për periudhën e zbatimit të Programit për Bujqësi dhe Zhvillim Rural për periudhën pesëvjeçare për Masën 7 është 180,000 € për përfitues;
- Nëse toka ose ndonjë pronë tjetër ku do të bëhet investimi është në bashkëpronësi, aplikuesi duhet të sjellë pëlqimin e bashkëpronarëve dhe kopjet e letërnjoftimeve;

- Kontrata për qiramarrje nuk kërkohet vetëm në rastet kur pronari i tokës dhe aplikuesi janë në marrëdhënie bashkëshortore apo në vijë të drejtë të gjakut pa kufij (p.sh.: stërgjyshërit, gjyshërit, prindërit, fëmijët, nipërit, mbesat, e kështu me radhë.) dhe kjo dëshmohet përmes certifikatës së martesës, apo certifikatës së lindjes dhe/apo certifikatës së vdekjes. Po ashtu, aplikuesi duhet ta plotësojë një Deklaratë nën betim, me të cilën e dëshmon se toka me të cilën aplikon dhe për të cilën ai është trashëgimtar potencial nuk shfrytëzohet nga trashëgimtarët tjerë potencial;

Në rastin e projekteve që parashohin ndërtim, zgjerim, rinovim ose investime në pajisje aplikuesit me rastin e aplikimit duhet të dorëzojnë

- Certifikatën e pronësisë (Fletën poseduese) të parcelës në të cilën do të bëhet investimi; (Në raste kur toka/objekti është marrë me qira, fleta poseduese e tokës ku është toka/objekti duhet të jetë në emër të qiradhënësit)
- Në rast se toka ose objekti është marrë me qira, kontratën e noterizuar të qirasë për së paku 10 vjet duke llogaritur nga viti i aplikimit. Kontratat e nënshkruara dhe të noterizuara për qiramarrje para periudhës së aplikimit, duhet të mbulojnë periudhën kohore për së paku 5 vite nga dita e aprovimit;
- Kontrata duhet të përmbajë edhe pëlqimin e pronarit (qiradhënësit), për investimin që do të bëhet në tokën/objektin e tij;
- Nëse toka ose ndonjë pronë tjetër në të cilën do të bëhet investimi është në bashkëpronësi, aplikuesi duhet të sjellë pëlqimin e bashkëpronarëve dhe kopjet e letërnjoftimeve ;
- Kopjen e planit të parcelës ku do të bëhet investimi;
- Kopjen e skicave të objektit

Përpos këtyre dokumenteve, në rast të ndërtimit/zgjerimit/ rinovimit të objekteve nevojiten edhe këto dokumente shtesë:

- Parallogarinë e shpenzimeve për materiale dhe për punë;
- Toka nën hipotekë nuk është e pranueshme për investim, qoftë në pronësi apo e marrë me qira;
- Të bëhet digjitalizimi në vendin ku bëhet investimi;
- Në rast të ndërtimit/zgjerimit në hapësirat e parqeve nacionale kërkohet edhe pëlqimi nga MMPHI;
- Për nënmasën “Prodhimi i mjaltit”, ata të cilët aplikojnë vetëm për pajisje dhe mjete tjera, e nuk aplikojnë për ndërtim objekti, duhet të dokumentojnë me fotografi për ekzistimin e objektit në momentin e aplikimit;
- Për nënmasën “Përpunimi i prodhimeve bujqësore në ekonomitë familjare”, ata të cilët aplikojnë vetëm për pajisje dhe mjete tjera, e nuk aplikojnë për ndërtimobjekti, duhet të dokumentojnë me fotografi për ekzistimin e objektit në momentin e aplikimit;
- Për nënmasën “Aktivitete jo bujqësore në zona rurale”, ata të cilët aplikojnë vetëm për pajisje dhe mjete tjera, e nuk aplikojnë për ndërtim objekti, duhet të dokumentojnë me fotografi për ekzistimin e objektit në momentin e aplikimit;
- Për nënmasën “Zhvillimi i turizmit rural” para nënshkrimit të kontratës me Agjencinë për Zhvillimin e Bujqësisë, përfituesit potencialë të cilët planifikojnë të investojnë në objekte që janë në Listën e Trashëgimisë Kulturore, duhet ta marrin pëlqimin nga Ministria e Kulturës/Departamenti i Trashëgimisë Kulturore.
- Te nënmasa “Zhvillimi i turizmit rural”, termi “zgjerim” e ka kuptimin e zgjerimit të objektit ekzistues, nëse aktiviteti i turizmit rural zhvillohet në bungalo/kamp shtëpizë, atëherë lejohet ndërtimi i ri (bungalovë/kamp shtëpizave tjera si zgjerim

i kapaciteteve ekzistuese) në parcelën apo në hapësirën ku tashmë ekziston biznesi turizmit rural, brenda të njëjtit vendbanim;

- Investimet duhet të jenë në përputhje me standardet përkatëse minimale kombëtare të paraqitura në udhëzuesin për aplikues, të cilat duhet të përmbushen më së voni para kërkesës për pagesën e fundit dhe të verifikohet gjatë kontrollit nga personat zyrtar në vendin e investimit;
- Aplikuesi që aplikon për investime në menaxhimin e mbetjeve dhe menaxhimin e ujërave të shkarkuara, me rastin e aplikimit duhet të sjellin projektin ideor me përmasa dhe parallogaritje;
- Parallogaritë e shpenzimeve të materialit dhe të punëve të parapara; Pëlqimin nga organi kompetent (Komuna) për leje të ndërtimit, në rastet e projekteve të ndërtimit/zgjerimit, por jo në rastet e projekteve të rinovimit;
- Të gjithë aplikuesit duhet t'i kenë të shlyera ose të rregulluara detyrimet tatimore, tatimin në të ardhura dhe tatimet tjera të aplikueshme;

Para kërkesës për pagesë në Agjencinë për Zhvillimin e Bujqësisë, përfituesi duhet të dorëzojë:

- Lejen për ndërtim nga organi kompetent (Komuna); nuk kërkohet për projektet e rinovimit;
- Në rastet e ndërtimeve/zgjerimeve me sipërfaqen e bazës mbi 10m² kërkohet leja e ndërtimit;
- Për nënmasën “Kultivimi i peshkut”, me kërkesën për pagesë duhet të dorëzohet Licenca për aktivitetet e akuakulturës/kultivimi i peshkut;
- Përfituesit për përpunimin e rrushit para kërkesës për pagesë duhet të regjistrohen në “Regjistrin e Verërave të Kosovës”
- Vlerësimin e ndikimit në mjedis, nëse është paraparë me ligj;

6.1 Standardet kombëtare

Investimet duhet të jenë në përputhje me standardet përkatëse minimale kombëtare. Ato duhet të përmbushen më së voni para kërkesës për pagesën e fundit dhe të verifikohen gjatë kontrollit nga personat zyrtar në vendin e investimit (Shih Udhëzuesin).

6.2 Qëndrueshmëria ekonomike

Aplikuesi duhet të dëshmojë qëndrueshmërinë ekonomike të fermës përmes planit të biznesit që synon të arrijë rezultatet deri në fund të periudhës së investimeve. Mënyra se si dëshmohet qëndrueshmëria ekonomike duhet të shpjegohet në udhëzuesin për aplikues i cili përgatitet nga AZHB. Fondet e AZHB-së të dhëna për përfituesin duhet të merren parasysh kur llogaritet qëndrueshmëria ekonomike e përfituesit. Në rast të investimeve baras ose më pak se 20,000 €, mund të pranohet një formë e thjeshtuar e një plani të biznesit ose projekt-propozimi, duke ruajtur parashikimet e qëndrueshmërisë financiare/ekonomike. Aplikuesi duhet ta dorëzojë projekt/propoziminsipas modelit që do të publikohet në web-faqet e AZHB-së dhe MBPZHR-së.

Projekt propozimi duhet të përfshijë edhe rrjedhën e parasë dhe tabelën e kthimit të investimit. Për projektet investuese në të cilat investimet e pranueshme janë më të mëdha se 20,000 €, aplikuesit duhet ta dorëzojnë një plan të biznesit sipas modelit që do të publikohet në web-faqet e AZHB-së dhe MBPZHR-së.

Plani i biznesit është dokumenti kryesor për vlerësimin e qëndrueshmërisë ekonomike.

Investimet e planifikuara duhet të jenë në përputhje me kapacitetin prodhues. Gjatë vlerësimit të aplikacioneve, duke u bazuar në planin e biznesit, zyrtarët e AZHB-së janë të obliguar të refuzojnë pjesën e investimeve të cilat janë në kundërshtim me këtë parim.

Qëndrueshmëria ekonomike dhe financiare vlerësohet në bazë të projekt-propozimit ose planit të biznesit. Plani i biznesit duhet të tregojë qëndrueshmërinë ekonomike të fermës/ndërmarrjes në fund të realizimit të investimi.

7. Kriteret e veçanta të pranueshmërisë

7.1 Grumbullimi dhe përpunimi i produkteve pyjore jo drusore përfshirë bimët mjekësore dhe aromatike (BMA-të e grumbulluara apo të kultivuara)

- Të drejtë aplikimi kanë vetëm personat juridik ose bizneset individuale të regjistruar në ARBK (me aktivitetin përkatës);
- Aplikuesi duhet të jetë i licencuar për grumbullimin e PPJD dhe BMA (nga Departamenti i Pylltarisë).

7.2 Zhvillimin e turizmi rural dhe agro-turizmi

- Ndërtimi i objekteve të reja lejohet vetëm për agro-turizem. Aplikuesit janë të obliguar ta dëshmojnë që zhvillojnë aktivitete bujqësore në zonat rurale dhe marrin subvencione, të dëshmuara përmes NIF-it për person fizik, kodit të aktivitetit në ARBK për persona fizik dhe dëshmisë nga AZHB për marrje të subvencioneve nga viti paraprak.
- Objekti ekzistues në të cilën do të investohet, me rastin e aplikimit, duhet të dëshmohet me fotografi dhe të jetë i stilit të zonës rurale;
- Aplikuesit të cilët planifikojnë të investojnë në objekte që janë në Listën e Trashëgimisë Kulturore, para nënshkrimit të kontratës me Agjencinë për Zhvillimin e Bujqësisë, duhet ta marrin pëlqimin nga Ministria e Kulturës/Departamenti i Trashëgimisë Kulturore;
- Aplikuesi në momentin e aplikimit duhet ta dorëzojë projektin ideor të përgatitur nga arkitekti i diplomuar (vërtetohet me diplomë të fakultetit);
- Objekti i planifikuar të zgjerohet/rinovohet duhet t'i përshtatet stilit të zonës rurale;
- Nëse aplikuesi është person fizik/fermë bujqësore, para nënshkrimit të kontratës me AZHB-në, duhet të regjistrohet si person juridik apo biznes individual dhe atë si ofrues i shërbimeve "hoteliere/bujtinë" dhe investimet/shpenzimet e zbatimit të projektit duhet të faturohen në emër të biznesit.
- Në fund të investimit, për aplikuesit persona fizik maksimumi i dhomave me investim dhe ato ekzistuese nuk duhet të kalojnë më shumë se 8 dhoma apo 16 shtretër, ndërsa për personat juridik mos të kalojnë kufirin e 15 dhomave ose 30 shtretërve.
- Personat fizik që aplikojnë për shërbime të ushqimit/restorant, para nënshkrimit të kontratës me AZHB-në duhet të regjistrohet si person juridik apo biznes individual dhe atë si ofrues i shërbimeve të ushqimit/restorant (maksimumi i ulëseve me investim dhe ato ekzistuese nuk mund të kalojnë kapacitetin prej 40 ulëseve për persona fizik, ndërsa personat juridik mos të kalojnë kufirin e 60 ulëseve).
- Në rast të investimeve në ndërtimin e shtigjeve për këmbësorë dhe biçikletë përreth objekteve të turizmit rural dhe kur këto shtigje kalojnë nëpër pronë private, me rastin e aplikimit duhet të sillen pëlqimi i noterizuar i pronarëve të pronave nëpër të cilat kalon ky shteg.

7.3 Përpunimi i prodhimeve bujqësore në ekonomi familjare

Të drejtë aplikimi kanë personat fizik dhe personat juridik;

Aktivitetet të pranueshme për përpunim brenda kësaj nënmasë janë:

- Përpunimi i prodhimeve blegtorale;
- Përpunimi i pemëve, perimeve dhe kërpudhave;
- Përpunimi i rrushit;
- Përpunimi i brumërave (brumëra të llojeve të ndryshme, ëmbëlsira etj)

Regjistrimi në AUV: Përfituesit e kësaj nënmasë para kërkesës për pagesë përfundimtare duhet të regjistrohen në regjistrin qendror të objekteve të regjistruara ose të aprovuara në AUV (në varësi të kapacitetit prodhues).

Përfituesit për përpunimin e rrushit para kërkesës për pagesë duhet të regjistrohen në "Regjistrin e Verërave të Kosovës"

7.4 Prodhimi mjaltit

- Aplikuesi, qoftë person fizik apo juridik duhet të kenë minimum 50 koshere me bletë.

7.5 Aktivitetet jo-bujqësore në zona rurale

- Të drejtën e aplikimit e kanë personat fizik dhe ata juridik.
- Personat fizik/duhet të regjistrohet si biznes para nënshkrimit të kontratës (aktivitetin jo bujqësor për të cilin ka aplikuar);
- Personat juridik (në regjistër të biznesit në aktivitetin adekuate jo bujqësore në zona rurale)

Aktivitetet e pranueshme jo - bujqësore në zona rurale

- Prodhimi dhe përpunimi produkteve nga lëkura;
- Prodhimi dhe përpunimi i produkteve nga leshi;
- Prodhimi dhe përpunimeve produkteve nga druri;
- Prodhimi dhe përpunimi produkteve nga metali;
- Prodhimi dhe përpunimi produkteve nga letra/karton;
- Prodhimi dhe përpunimi nga plastika;
- Prodhimi dhe përpunimi produkteve nga poçaria dhe qeramika;
- Prodhimi dhe përpunimi i produkteve nga tekstili;
- Prodhimi i humusit.

7.6 Rritja e shpezëve të fshatit

Të drejtën e aplikimit kanë personat fizik dhe ata juridik.

- Personat/fizik duhen të regjistrohen si biznes para nënshkrimit të kontratës për prodhimin e vezëve dhe mishit të shpezëve;
- Persona juridik (në regjistër të biznesit aktivitet në rritjen e shpezeve);
- Aplikuesit, në momentin e aplikimit, duhet të dëshmojnë se kanë së paku 5 m² tokë për kokë pule ose rose dhe 15 m² tokë për kokë bibe ose pate;
- Në momentin e aplikimit duhet të kenë së paku:
- 300 pula, dhe në fund të investimit duhet të kenë jo më pak se 800 krerë;
- 300 rosa, dhe në fund të investimit duhet të kenë jo më pak se 800 krerë;
- 100 pata dhe në fund të investimit duhet të kenë jo më pak se 500 krerë;
- 100 biba, dhe në fund të investimit duhet të kenë jo më pak se 500 krerë;

- Në rast të mbajtjes së kombinuar një patë ose një bibë është e barabartë me 3 pula ose tri rosa dhe duhet të arrihet numri ekuivalent me vlerat e lartpërmendura.

7.7 Kultivimi i peshkut

- Të drejtën e aplikimit e kanë personat fizik dhe ata juridik;
- Të gjithë aplikuesit, para kërkesës për pagesën e fundit, duhet të jenë të regjistruar si biznes dhe të licencuar për kultivim të peshkut nga MBPZHR;
- Aplikuesi që aplikon për ndërtim/rinovim/zgjerim/ të inkubatorit për riprodhimin e peshkut mund të aplikojë vetëm nëse në vitin paraprak ka shitur më shumë se 30 tonë peshk të freskët.

8. Investimet e pranueshme të përbashkëta për masën

- Ndërtimi, rindërtimi, zgjerimi dhe rinovimi i pronës së paluajtshme;
- Blerja e makinerive dhe pajisjeve të reja, duke përfshirë pajisjet kompjuterike;
- Ndërtim, rinovim dhe zgjerim i rrugëve të brendshme për qasjen në pronë/objekt;
- Shpenzimet e përgjithshme të lidhura me shpenzimet siç janë; arkitektët, inxhinierët dhe tarifat e tjera të konsultimit, studimet e fizibilitetit, do të jenë të pranueshme deri në maksimum 10% të shpenzimeve të investimit;
- Nëse toka merret me qira, kontratën e noterizuar të qiramarrjes për së paku 10 vite për parcelën apo objektin ku do të bëhet ndërtimi/zgjerimi/rinovimi, kurse për projekte që nuk parashohin ndërtim/zgjerim dhe rinovim në pronë të huaj mjafton kontrata e noterizuar e qiramarrjes për 5 vite. (duke llogaritur nga viti i aplikimit). Kontratat e nënshkruara dhe të noterizuara për qiramarrje para periudhës së aplikimit, duhet të mbulojnë periudhën kohore prej së paku 5 vitesh nga dita e aprovimit;
- Investimet në prodhimin e energjisë së ripërtëritshme;
- Në kuadër të këtij investimi mbështetës, shitja e energjisë elektrike në rrjet lejohet për aq sa respektohet kufiri "vetë-konsum" (d.m.th. energjia elektrike e shitur në rrjet është e barabartë mesatarisht me energjinë elektrike e shpenzuar gjatë vitit). Kjo justifikohet me faktin se, meqenëse energjia elektrike nuk mund të ruhet, ajo nëse nuk harxhohet, mund të lëshohet në rrjet; rrjeti i energjisë elektrike mund të konceptohet si një vend depozitimi për energjinë elektrike ku futet dhe tërhiqet gjatë vitit në sasi të ngjashme dhe me një ritëm të ndryshëm.
- Koncepti i "vetë-konsumit" duhet të kontrollohet në fazën në të cilën paraqitet/vlerësohet një projekt. Investimi konsiderohet i pranueshëm kur kapaciteti (teorik) i energjisë së impiantit të energjisë së rinovueshme ("investimi") nuk tejkalon 120% të konsumit mesatar prej 3 vjetësh të fermës.
- Në rastin e fermave të reja ose në rastet e fermave që kanë ndryshuar në mënyrë thelbësore madhësinë e veprimtarisë së tyre në tre vitet e fundit, konsumi i pritshëm duhet të vlerësohet nga AZHB. I njëjti shqetësim sa i përket konsumit të energjisë së pritshme rritet për shkak të investimeve të reja që do të bëhen si pjesë e të njëjtit aplikim nga përfituesi i mundshëm.

8.1 Investimet të pranueshme për Grumbullimi, dhe përpunimin e produkteve pyjore jo drusore, përfshirë bimët mjekësore dhe aromatike (BMA-të e grumbulluara apo të kultivuara)

- Ndërtimi/zgjerimi/rinovim i objektit;
- Blerja e pajisjeve për përpunimin, magazinimin, paketimin e produkteve të sektorit;
- Blerja e pajisjeve për larje, pastrim, ruajtje, klasifikim, etiketim;
- Blerja e pajisjeve për tharje, për ftohje, për ngrirje të thellë, etj;
- Blerja e rafteve për tharje;
- Blerja dhe vendosja e pajisjeve për prodhimin e energjisë së ripërtëritshme;
- Blerja e pajisjeve për IT, dhe digjitalizimi;
- Investime për pajisje për trajtimin e mbetjeve dhe trajtimin e ujit.

8.2 Zhvillimi i turizmit rural dhe agro – turizmi

- Ndërtim/Zgjerim/Rinovim i objektit ekzistues për ofrimin e shërbimeve të akomodimit, ambienteve për ofrim dhe përgatitjen e ushqimit.²²
- Blerja e pajisjeve dhe orendive për rregullim të brendshëm të objektit;
- Rregullimi i infrastrukturës turistike (parqe tematike ose argëtimi, fusha tenisi, pishina, shtigje rekreative, shtigje fitnesi, rrugë panoramike, shtigje për çiklizëm etj);
- Blerja dhe vendosja e pajisjeve për prodhimin e energjisë së ripërtëritshme;
- Blerja e pajisjeve për IT, dhe digjitalizim;
- Investime për trajtimin e mbetjeve të prodhimit dhe mbetjeve të ujit;
- Investimet në marketing.

8.3 Përpunimi i prodhimeve bujqësore në ekonomi familjare

- Ndërtimi/rinovimi/zgjerimi i objekteve për prodhim, ruajtje dhe përpunim të prodhimeve;
- Ndërtimi/rinovimi/zgjerimi i objekteve me pamje të përshtatur stilit të zonës rurale për përdorim si pika shitëse për prodhimet lokale (të përshkruhet në projekt-propozim);
- Investimet në makina dhe pajisje për përpunimin e mishit, qumështit (përfshirë njësitë mobile për përpunimin e qumështit), përpunimin e pemëve dhe perimeve, për pastrim, klasifikim, tharje, grumbullim, pasterizim, ruajtje, frigorifer me ftohje, me ngrirje, furra për pjekje të brumërave, përzierëse të ndryshme të brumërave, pajisje për prodhimin e rakisë, pajisje për mbushje për raki dhe verëra, prodhime të verës, etj;
- Investimet në blerjen e pajisjeve për matje, paketim dhe etiketim;
- Blerja dhe vendosja e pajisjeve për prodhimin e energjisë së ripërtëritshme;
- Pajisje për trajtimin e mbetjeve të prodhimit dhe mbetjeve të ujit;
- Blerja e pajisjeve për IT, dhe digjitalizim;
- Investimet në pajisje specifike, me qëllim të përmirësimit të sigurisë dhe cilësisë së ushqimit.

- ²²Ndërtimi lejohet vetëm për agro-turizem.

8.4 Prodhimi i mjaltit

- Blerja e koshereve pa bletë;
- Blerja e makinerisë dhe pajisjeve për prodhimin dhe përpunimin e mjaltit;
- Rimorkio të specializuara për bartjen e koshereve, vetëm për aplikuesit me mbi 100 koshere;
- Investimet në pajisje për nxjerrjen e produkteve të bletës;
- Investimet në pajisje për kultivimin e amave;
- Ndërtimi/rinovimi/zgjerimi i dhomës së mjaltit, maksimumi 5,000 (pesëmijë) euro;
- Blerja e pajisjeve laboratorike për analizim të produkteve të bletëve;
- Blerja e linjave teknologjike për mbushje dhe paketim të mjaltit;
- Blerja dhe vendosja e pajisjeve për prodhimin e energjisë së ripërtëritshme;
- Investimet për përmirësimin e sigurisë së cilësisë së mjaltit;
- Blerja e pajisjeve për IT, dhe digjitalizim;
- Investime për trajtimin e mbetjeve të prodhimit dhe mbetjeve të ujit;
- Investime në marketing
- Të gjitha pajisjeve të linjës së vjeljes së mjaltit t'iu grafkohet numri identifikues i fermës (NIF i fermerit).

8.5 Aktivitete jo-bujqësore në zona rurale

- Ndërtim/zgjerim/rinovim i objektit;
- Blerja e mjeteve dhe pajisjeve për kryerjen e veprimtarive jo bujqësore;
- Blerja dhe vendosja e pajisjeve për prodhimin e energjisë së ripërtëritshme;
- Blerja dhe vendosja e pajisjeve për trajtimin e mbetjeve të prodhimit dhe të ujit.

8.6 Rritja e shpezëve të fshatit

- Ndërtimi i stallës për mbajtjen e shpezëve; Dendësia maksimale e lejuar: 6 pula/rosa ne 1 m² ose 2 biba/pata ne 1m², ndërsa numri i maksimal i shpezëve i lejuar në 1 fole duhet te jetë 7 shpezë.
- Investime në vendosjen e rrethojës për sipërfaqen në të cilën mbahen shpezët;
- Blerja e pajisjeve të nevojshme për rritjen e shpezëve për prodhimin e vezëve dhe mishit të pulave, bibave, patave dhe rosave;
- Inkubatorë të vegjël në përputhje me kapacitetin prodhues;
- Blerja dhe vendosja e pajisjeve për prodhimin e energjisë së ripërtëritshme;
- Investimet në pajisje për trajtimin e mbetjeve të prodhimit dhe të ujit.

8.7 Kultivim i peshkut

- Ndërtim/zgjerim/rinovim të baseneve për kultivimin e peshkut;
- Ndërtimi/zgjerim/rinovim të inkubatorit për riprodhimin e peshkut;
- Investimet në arritjen e standardeve kombëtare të sigurisë së ushqimit;
- Blerja e pajisjeve të nevojshme për kultivimin dhe trajtimin e peshkut të ujërave të ëmbla;
- Blerja dhe vendosja e pajisjeve për prodhimin e energjisë së ripërtëritshme;
- Investimet për pajisjeve për trajtimin e mbetjeve të prodhimit dhe të ujit.

9. Kriteret e përzgjedhjes sipas nënmasave

- a) Kriteret e përzgjedhjes “Grumbullimi dhe përpunimi produkteve pyjore jo drusore, përfshirë bimët mjekësore dhe aromatike (BMA të grumbulluara apo të kultivuara)

	Kategoritë	Pikë t	
1.		Aplikuesi (ndërmarrja) ka përvojë më pak se 3 vite (në grumbullimin, përpunimi të PPDJ dhe BMA)	45
	Përvoja e aplikuesit	Aplikuesi (ndërmarrja) ka përvojë 3 vite e më shumë (në grumbullimin, përpunimi të PPDJ dhe BMA)	40
2	Vendi i investimit	Investimi në zona malore	10
3	Eksporti	Eksporti PPDJ-ve dhe i BMA-ve (i vitit paraprak mbi 500,000 euro)	5
4	Siguria e ushqimit	Investimet në arritjen e standardeve kombëtare të sigurisë së ushqimit	15
5	Krijimi i vendeve të punësimit	Investimi përfshin krijimin e vendeve të reja të punës në bazë të projekt propozimit/planit të biznesit	10
6	Mbrojtja e mjedisit ²³	Investimet në energjinë e ripërtëritshme	5
7	Aplikuesi i ri ²⁴	Aplikuesi është 40 vjeç ose më i ri	5
8	Prodhimtaria organike	I certifikuar për prodhim organik	5
Gjithsej		100	

²³ Investimet në prodhimin e energjisë së ripërtëritshme/mbrojtja e mjedisit dhe ndryshimi klimatik, nëse përfituesi ka paraparë investime në përdorimin e energjisë së ripërtëritshme dhe i fiton pikët për këtë qëllim, është i obliguar që këtë investim ta përdorë dhe ta mbajë aktiv për qëllimet që i ka paraparë në planin e biznesit. Nëse gjatë cilito kontroll, nga zyrtarët e AZHB-së (para nënshkrimit të kontratës, ad – hoc ose ex-post) konstatohet që investimet në energji të ripërtëritshme nuk janë duke u përdorur siç parashihet në biznes plan, atëherë përfituesi do të te ndëshkohet sipas legjislacionit në fuqi .

²⁴ I pranueshëm është aplikuesi i cili deri në ditën e aplikimit nuk i ka mbushur 40 vjet

b) Kriteret e përzgjedhjes për nënmasën “Zhvillimi i turizmit rural /agro-turizmi”

	Kategoritë	Pikët	
1.	<u>Përvoja e aplikuesit:</u> a) Përvoja e aplikuesit në turizëm rural (për personat fizik, të dëshmohet me NIF)	Aplikuesi ka përvojë 3 vite e më shumë në ofrimin e shërbimeve të turizmit	45
	b) Për biznese të dëshmohet me aktivitetin përkatës të biznesit	Aplikuesi ka përvojë më pak se 3 vite në ofrimin e shërbimeve të turizmit	40
2.	Vendi i investimit	Investimi në zona malore	15
3.	Aplikuesi i ri ²⁵	Aplikuesi është 40 vjeç ose më i ri	10
4.	Gjinia e fermerit	a) Femra/person fizik së paku 3 vite pronare e fermës ku zhvillohet aktiviteti i turizmit rural, të dëshmohet me NIF; b) Femra/person juridik se paku 3 vite pronare e biznesit për turizëm rural	5
5.	Mbrojtja e mjedisit ²⁶	Investimet në energjinë e ripërtëritshme	10
6.	Punësimi	Investimi në krijimin e vendeve të reja të punës në bazë të projekt propozimit/planit të biznesit	5
7.	Trashëgimia kulturore	Investimet në objekte të trashëgimisë kulturore	5
8.	Përkrahja nga GLV-të	Investimet që janë në linjë me SZHL të GLV-së përkatëse	5
Gjithsej		100	

²⁵ Pranueshëm është aplikuesi i cili deri në ditën e aplikimit nuk i ka mbushur 40 vjet

²⁶ Investimet në prodhimin e energjisë së ripërtëritshme/mbrojtja e mjedisit dhe ndryshimi klimatik: nëse përfituesi ka paraparë investime në përdorimin e energjisë së ripërtëritshme dhe i fiton pikët për këtë qëllim, është i obliguar që këtë investim ta përdorë dhe ta mbajë aktiv për qëllimet që i ka paraparë në planin e biznesit. Nëse gjatë cilitdo kontroll, nga zyrtarët e AZHB-së (para nënshkrimit të kontratës, ad – hoc ose ex-post) konstatohet që investimet në energji të ripërtëritshme nuk janë duke u përdorur siç parashihet në biznes plan, atëherë përfituesi do të ndëshkohet sipas legjislacionit në fuqi .

c) Kriteret e përzgjedhjes për nënmasën “Përpunimi i prodhimeve bujqësore në ekonominë familjare”

Kategoritë		Pikët	
1.	Madhësia e fermës	> 1ha tokë bujqësore (toka në emër aplikuesit)	45
		≤ 1ha jo më pak se 0,50 ha tokë bujqësore (toka në emër aplikuesit)	40
		3 e më shumë lopë qumështore ose 15 dele ose 15 dhi (në ekonominë familjare në emër të aplikuesit)	45
		Me pak se 3 lopë qumështore ose 15 dele ose 15 dhi (në ekonominë familjare në emër të aplikuesit)	40
2.	Siguria e ushqimit	Investimet në arritjen e standardeve kombëtare të sigurisë së ushqimit	15
3.	Mbrojtja e mjedisit ²⁷	Investimet në energjinë e ripërtëritshme	10
4.	Krijimi i vendeve të punës	Investimi në krijimin e vendeve të reja të punës në bazë të planit të biznesit/projekt propozimit	10
5.	Vendi i investimit	Investimi në zona malore	10
6.	Gjinia e fermerit	Aplikuesi femër	5
7.	Aplikuesi i ri ²⁸	Aplikuesi është 40 vjeç ose më i ri	5
Gjithsej		100	

²⁷ Investimet në prodhimin e energjisë së ripërtëritshme/mbrojtja e mjedisit dhe ndryshimi klimatik: nëse përfituesi ka paraparë investime në përdorimin e energjisë së ripërtëritshme dhe i fiton pikët për këtë qëllim, është i obliguar që këtë investim ta përdorë dhe ta mbajë aktiv për qëllimet që i ka paraparë në planin e biznesit. Nëse gjatë cilito kontroll, nga zyrtarët e AZHB-së (para nënshkrimit të kontratës, ad hoc ose ex-post) konstatohet që investimet në energji të ripërtëritshme nuk janë duke u përdorur siç parashihet në biznes plan, atëherë përfituesi do të ndëshkohet sipas legjislacionit në fuqi .

²⁸ I pranueshëm është aplikuesi i cili deri në ditën e aplikimit nuk i ka mbushur 40 vjet.

d) Kriteret e përzgjedhjes për nënmasën “Prodhimi i mjaltit”

Kategoritë			Pikët
1	Madhësia e fermës në momentin e aplikimit	Numri i koshereve	50 - 100
			101 - 150
			>150
2	Aplikuesi është i regjistruar si biznes (me kod të bletarisë)		10
3	Vendi i investimit	Investimi është në zonë malore	10
4	Mbrojtja e mjedisit ²⁹	Investimet në energjinë e ripërtëritshme	10
5	Krijimi i vendeve të punës	Investimi përfshin krijimin e vendeve të reja të punës në bazë të projekt propozimit/planit të biznesit	10
6	Gjinia e fermerit ³⁰	a) Femër/person fizik së paku 2 vite pronare e fermës ku zhvillohet aktiviteti “Prodhimtaria e mjaltit” të dëshmohet me NIF; b) Femër/person juridik së paku 2 vite pronare e biznesit “Prodhimtaria e mjaltit”	5
7	Aplikuesi i ri ³¹	Aplikuesi është 40 vjeç ose më i ri	5
Gjithsej			100

²⁹ Investimet në prodhimin e energjisë së ripërtëritshme/mbrojtja e mjedisit dhe ndryshimi klimatik, nëse përfituesi ka paraparë investime në përdorimin e energjisë së ripërtëritshme dhe i fiton pikët për këtë qëllim, është i obliguar që këtë investim ta përdorë dhe ta mbajë aktiv për qëllimet që i ka paraparë në planin e biznesit. Nëse gjatë cilitdo kontroll, nga zyrtarët e AZHB-së (para nënshkrimit të kontratës, ad hoc ose ex-post) konstatohet që investimet në energji të ripërtëritshme nuk janë duke u përdorur siç parashihet në biznes plan, atëherë përfituesi do të ndëshkohet sipas legjislacionit në fuqi

³⁰ Gjinia e fermerit, aplikuesi do të marrë pikët e këtij kriteri nëse ferma (bletorja) ose biznesi me aktivitetin (prodhimi i mjaltës) është në pronësi të saj në 2 (dy) vitet e fundit. Krijimi i Kushteve artificiale për të marrë pikë paraqet mashtrim dhe do të ndëshkohet sipas legjislacionit në fuqi .

³¹ I pranueshëm është aplikuesi i cili deri në ditën e aplikimit nuk i ka mbushur 40 vjet

dh) Kriteret e përzgjedhjes për nën-masën “Aktivitete jo-bujqësore në zona rurale”

Kategoritë		Pikët	
1	Mosha e aplikuesit	Aplikuesi është 40 vjeç ose më i ri ³²	45
		Aplikuesi është mbi 40 vjeç	35
2	Përvoja e aplikuesit	Aplikuesi - ka së paku 2 vjet përvojë në aktivitetin për të cilën aplikon (të jetë i regjistruar si biznes për veprimtarinë e caktuar)	15
3	Vendi i investimit	Investimi është në zonë malore;	15
4	Punësimi	Investimi përfshin krijimin e vendeve të reja të punës në bazë të projekt propozimit / planit të biznesit	10
5	Mbrojtja e mjedisit ³³	Investimet në energjinë e ripërtritshme;	10
6	Gjinia e fermerit	Aplikuesi femër	5
Gjithsej		100	

e) Kriteret e përzgjedhjes për nënmasën “Rritja e shpezëve të fshatit”

Kategoritë		Pikët	
1.	Përvoja e aplikuesit para aplikimit	≥ 500 pula ose rosa (ose gjithsej më shumë se 500 krerë)	50
		≥ 200 pata ose biba (ose gjithsej më shumë se 200 krerë)	
		< 500 pula ose rosa (ose gjithsej më pak se 500 krerë)	45
		< 200 pata ose biba (ose gjithsej më pak se 200 krerë)	
2.	Gjinia e fermerit	Aplikuesi femër	10
3.	Aplikuesi i ri ³⁴	Aplikuesi është 40 vjeç ose më i ri/re	20
4.	Vendi i investimit	Investimi është në zonë malore;	20
Gjithsej		100	

³² I pranueshëm është aplikuesi i cili deri në ditën e aplikimit nuk i ka mbushur 40 vjet

³³ Investimet në prodhimin e energjisë së ripërtritshme/mbrojtja e mjedisit dhe ndryshimi klimatik, nëse përfituesi ka paraparë investime në përdorimin e energjisë së ripërtritshme dhe i fiton pikët për këtë qëllim, është i obliguar që këtë investim ta përdorë dhe ta mbajë aktiv për qëllimet që i ka paraparë në planin e biznesit. Nëse gjatë cilitdo kontroll, nga zyrtarët e AZHB-së (para nënshkrimit të kontratës, ad – hoc ose ex-post) konstatohet që investimet në energji të ripërtritshme nuk janë duke u përdorur siç parashihet në biznes plan, atëherë përfituesi do të ndëshkohet sipas legjislacionit në fuqi

³⁴ I pranueshëm është aplikuesi i cili deri në ditën e aplikimit nuk i ka mbushur 40 vjet

ë) Kriteret e përzgjedhjes për nënmasën “Kultivimi i peshkut”

Kategoritë		Pikët
Kapaciteti prodhues Për fillestarë, kapaciteti pas investimit (në biznes plan)	≥ 3 t/vit - < 10 t/vit	45
	≥ 10 t/vit - < 30 t/vit	40
	≥ 30 t/vit	35
Përvoja e aplikuesit në akuakulturë	Aplikuesi është i licencuar nga MBPZHR-ja	20
	Aplikuesi ka marrë pagesa direkte për akuakulturë në vitin paraprak, por nuk është i licencuar	15
	Aplikuesi është fillestar	10
Aplikuesi i ri ³⁵	Aplikuesi është 40 vjeç ose me i ri/re	5
Vendi i investimit	Investimi është në zonë malore	10
Punësimi	Investimi krijimin e vendeve të reja të punës në bazë të projekt propozimit/planit të biznesit	10
Mbrojtja e mjedisit ³⁶	Investimet në energjinë e ripërtëritshme	10
Gjithsej		100

10. Shkalla e përkrahjes publike

- Përkrahja publike për këtë masë është 60% e shpenzimeve të pranueshme të investimit.
- Përkrahja publike rritet + 5% për investime në zona malore, dhe +5% për investime në asete fizike të ekonomive bujqësore të bëra nga fermerë të rinj;
- Vlera minimale e shpenzimeve të pranueshme për projekt brenda kësaj mase është 10,000 €,
- Vlera maksimale e shpenzimeve të pranueshme për projekt brenda kësaj mase është deri në 100,000 €.

³⁵ Pranueshëm është aplikuesi i cili deri në ditën e aplikimit nuk i ka mbushur 40 vjet

³⁶ Investimet në prodhimin e energjisë së ripërtëritshme/mbrojtja e mjedisit dhe ndryshimi klimatik, nëse përfituesi ka paraparë investime në përdorimin e energjisë së ripërtëritshme dhe i fiton pikët për këtë qëllim, është i obliguar që këtë investim ta përdorë dhe ta mbajë aktiv për qëllimet që i ka paraparë në planin e biznesit. Nëse gjatë secilës kontrollë, nga zyrtarët e AZHB-së (para nënshkrimit të kontratës, ad-hoc ose ex-post), konstatohet që investimet në energji të ripërtëritshme nuk janë duke u përdorur siç parashihet në biznes plan atëherë do të ndëshkohen sipas legjislacionit në fuqi .

Vlera maksimale e pranuar sipas nënmasave:

7.1 Grumbullimi, përpunimi dhe promovimi i produkteve pyjore jo drusore...	100,000 €;
7.2 Zhvillimi dhe promovimi i turizmit rural është.....	100,000 €;
7.3 Përpunimi i prodhimeve bujqësore në ekonomi familjare.....	50,000 €;
7.4 Prodhimi i mjaltit.....	30,000 €;
7.5 Aktivitete jo-bujqësore në zona rurale	50,000 €;
a) Përpunimi i leshit – vlera e projektit.....	30,000 €;
b) Prodhimi i humusit - vlera e projektit.....	30,000 €;
7.6 Rritja e shpezëve të fshatit.	30,000 €;
7.7 Kultivimi i peshkut	100,000 €.

- Përkrahja maksimale publike për periudhën programuese (2023-27) për Masën 7 nuk mund ta tejkalojë shumën prej 180,000 € për përfitues.
- Aplikuesi mund të aplikojë me disa projekte gjatë periudhës së zbatimit të këtij programi në vite të ndryshme, me kusht që projektet e mëhershme të jenë përfunduar me sukses dhe përkrahja publike të mos e tejkalojë shumën e lartpërmendur.

Shpenzimet e pranueshme janë të kufizuara në ato që janë përfshirë në Listën e Investimeve të Pranueshme për Masën 7.

Pagesa për Masën 7 mund bëhet në dy këste, pjesa e parë e përkrahjes publike në vlerë prej 50% bëhet në formë të paradhënies pas nënshkrimit të kontratës me përfituesin, me kusht të sigurimit të garancionit bankar, ndërsa pjesa tjetër e mbetur prej 50%, paguhet pas verifikimit të përfundimit të investimit të përgjithshëm;

Garancioni bankar duhet të sigurohet vetëm për paradhënien prej 50% të përkrahjes publike; Garancioni bankar duhet të sigurohet për periudhën kohore deri sa të realizohet pagesa e fundit nga AZHB-ja, respektivisht deri te vendimi i fundit nga Komisioni i Ankesave. Çdo kërkesë për afat shtesë duhet të mbulohet me garancion bankar.

11. Buxheti

		Buxheti	%
1.	Grumbullimi dhe përpunimi i produkteve pyjore jo drusore përfshirë bimët mjeksore dhe aromatike	400,000.00	10.00
2.	Zhvillimin e turizmit rural dhe agro – turizmi	1,000,000.00	25.00
3.	Përpunimi i prodhimeve bujqësore në ekonomi familjare	500,000.00	12.50
4.	Prodhimi i mjaltit	500,000.00	12.50
5.	Aktivitetet jo-bujqësore në zona rurale	500,000.00	12.50
6.	Përpunimi i leshit të deleve	200,000.00	5.00
7.	Prodhimi i humusit	200,000.00	5.00
8.	Rritja e shpezëve të fshatit	300,000.00	7.50
9.	Kultivimi i peshkut	400,000.00	10.00
	Totali i Buxhetit	4,000,000.00	100.00

12. Treguesit

TREGUESIT	CAQET
Numri i përgjithshëm i fermave të mbështetura	130
Numri i përgjithshëm i objekteve për turizëm rural	28
Numri i përgjithshëm i ndërmarrjeve për PPJD dhe BMA	11
Numri i përgjithshëm i fermave për Përpunimin e produkteve në ekonomin familjare	27
Numri i përgjithshëm i fermave për Prodhimin e mjaltit	14
Numri i përgjithshëm i fermave për aktivitete jo bujqësore në zona rurale	25
Numri i përgjithshëm i fermave për Rritjen e shpezëve të fshatit	8
Numri i përgjithshëm i fermave për Kultivim peshku	11
Numri i përfituesve të PZHR në investime në prodhimin e energjisë së ripërtëritshme	100
Numri i përfituesve të PZHR në investime në trajtimin osemenaxhimin e mbetjeve	50
Vende të reja të punës me orar të plotë	130
Vlera totale e investimeve publike	4,000,000.00
Vlera e përgjithshme i investimit	6,666,666.67

13. Procedurat administrative

Kjo masë do të zbatohet nga Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë (AZHB). Procedurat administrative të detajuara do të paraqiten në Udhëzimin Administrativ i cili miratohet nga Ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

Udhëzuesit për aplikues do të publikohen në faqen e internetit të AZHB-së, së bashku me të gjitha anekset e saj të nevojshme që fermerët të përgatisin aplikimin.

Vlerësimi përfshin verifikimin e dokumentacionit të dorëzuar (të jetë i plotë), kontrollet e pranueshmërisë (përfshirë projekt propozimin/planin e biznesit) dhe vlerësimi me pikë i projekteve. Raportet e vlerësimit do të publikohen. Të gjithë aplikuesit do të kenë mundësinë të paraqesin ankesë. Procedura e vlerësimit do të jetë pjesë e Udhëzimit Administrativ, të miratuar nga MBPZHR.

14. Afati i zbatimit

Afati i zbatimit të projekteve të kësaj mase është 90 ditë nga dita e nënshkrimit të kontratës me AZHB në, përveç për nënmasën Akuakultura/kultivimi i peshkut – në të cilën afati i zbatimit të projektit është 10 muaj (300 ditë) me mundësi vazhdimi në përputhje me legjislacionin në fuqi. Pas periudhës prej 90 ditëve, respektivisht 300 ditëve, përfituesi ka edhe 15 ditë shtesë për përgatitjen e dokumentacionit dhe paraqitjen e kërkesës për pagesë. AZHB mund ta zgjasë afatin e zbatimit për më së shumti 30 ditë, nëse ka arsye të qëndrueshme për këtë, siç janë kushtete e papërshtateshme klimatike, sjellja e ndonjë makinerie specifike për ndonjë vendi tjetër.

15. Shtrirja gjeografike e masës

Kjo masë aplikohet në të gjitha zonat rurale të Republikës së Kosovës.

MASA 5: ZBATIMI I STRATEGJIVE TË ZHVILLIMIT LOKAL – QASJA LEADER

1. Baza Ligjore

- Ligji Nr.08/L-072 për Bujqësi dhe Zhvillim Rural (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/Nr. 8/ 29 mars 2023;
- Strategjia për Bujqësi dhe Zhvillim Rural 2022-2028, vendim i Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr.12/50, i datës: 23.12.2021;
- Ligjin nr. 08/L-193 mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2023.
- Programi Kombëtar për Bujqësi dhe Zhvillim Rural 2023-2027, vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës, Nr.15/151, i datës: 12.07. 2023;

2. Arsyeshmëria

LEADER është pjesë e politikës së zhvillimit rural të BE-së, që ndihmon në ngritjen e kapaciteteve dhe përvojës në zbatimin e politikave të BE –së të zhvillimit rural, gjithashtu kjo ndihmon vendet candidate në përgatitjen për anëtarësimin në BE.

Qasja LEADER ka për qëllim zhvillimin e komunitetit, duke kontribuar në përmirësimet ekonomike, sociale, kulturore dhe mjedisore të zonave lokale, duke angazhuar një numër të gjerë partnerësh privat dhe publik multi-sektorial, gjithnjë duke marrë parasysh burimet e komunitetit në nivelin lokal.

Qëllimi kryesor i GLV-ve është që të kontribuojnë në zhvillimin ekonomik të zonaverurale, duke i ofruar përkrahje komunitetit rural për përgatitjen dhe zbatimin e strategjive zhvillimore në bashkëpunim të ngushtë me komunitetin lokal.

Në periudhën 2007-2009, me iniciativën e MBPZHR-së, janë themeluar 30 Grupe Lokale të Veprimit (GLV) - të cilat kanë mbuluar të gjithë zonën rurale të vendit në Kosovë. GLV-të në Kosovë kanë qenë të organizuara mbi bazën e komunave, në këtë mënyrë secilës komunë i korrespondon një GLV. GLV-të kanë qenë të regjistruara si Organizata jo- Qeveritare (OJQ) në përputhje me legjislacionin e Kosovës. Gjatë viteve 2010-2013, GLV-të kanë zbatuar/implementuar projekte të ndryshme për të mirën e komuniteteve të tyre me mbështetje financiare nga MBPZHR-ja, komunat dhe organizatat e tjera donatore. Në mënyrë që të lehtësohet promovimi, komunikimi dhe shpërndarja e informacionit midis GLV-ve dhe akterëve të tjerë rural, është themeluar edhe Rrjeti i Zhvillimit Rural (RrZhr). RrZhr duke funksionuar si një platformë diskutimi.

Gjatë pjesës së dytë të vitit 2014, është realizuar aktiviteti “Ndihmesa teknike për GLV-të e mundshme” në formë të thirrjes për prezantime të Strategjive Zhvillimore Lokale (SZhL). Janë paraqitur 12 GLV-të dhe RrZhr-ja të cilët kanë përgatitur Strategjitë e Zhvillimit Rural. Komisioni përzgjedhës ka bërë vlerësim të thukët të 12 SZhL-ve të parashtruara. Vlerësimi është bërë në bazë të kriterëve të pranueshmërisë dhe të përzgjedhjes, të identifikuar paraprakisht. 12 GLV-ve dhe RrZhr-se së GLV-ve u janë aprovuar Strategjitë e Zhvillimit Rural, dhe këto 12 kanë qenë GLV të aprovuara.

Gjatë periudhës 2015 -2020, GLV-të e aprovuara janë mbështetur nga MBPZHR-ja me mjete financiare për kryerjen e aktiviteteve të tyre. Mirëpo shpesh me problem për shkak të moskuptuarit të qasjes LEADER.

3. Objektiva e përgjithshme

Masa 5 “Zbatimi Strategjive të zhvillimit lokal – Qasja LEADER” si objektiv kryesor ka përkrahjen e ngritjes së kapaciteteve të GLV-ve të përzgjedhura, anëtarëve të GLV-ve dhe

banorëve rural, me qëllim të shtimit të shkathtësive të tyre në fushën e demokracisë dhe zhvillimit lokal.

3.1 Objektivat specifike

Objektivat specifike janë:

- ✓ Përmirësimi i kapitalit social dhe qeverisjes vendore duke krijuar një partneritet privato-publik (GLV -të Grupet Lokale të Veprimit), i cili krijon dhe zbaton strategjitë e zhvillimit lokal;
- ✓ Animi i territorit dhe ngritja e kapaciteteve të popullatës lokale dhe Grupeve Lokale të Veprimit;
- ✓ Kontributi në ekonominë rurale, turizmin rural, forcimin e jetës kulturore dhe sociale të komunitetit, përmirësimin e zonave publike në zonat rurale, përmirësimin e standardeve mjedisore në zonat e GLV-ve si temat kryesore për strategjitë e zhvillimit lokal;
- ✓ Rrjetëzimi me GLV-të e tjera, shkëmbimi i praktikave më të mira, shpërndarja e programeve IPARD dhe mësimi i qasjeve të reja për zhvillimin rural në nivel kombëtar si me vendet kandidatë ashtu edhe me shtetet anëtare;
- ✓ Funkcionalizimi i GLV-ve të përzgjedhura sipas qasjes LEADER;
- ✓ Ndërtimi i kapaciteteve të GLV-ve të përzgjedhura dhe RRZhr-së.

4. Lidhjet me masat e tjera në program të PZHR-së

Kjo masë është e lidhur me masën 9 "Asistenca Teknike". Asistenca Teknike i mbështetë GLV-të e mundshme që të jenë të gatshme të aplikojnë për Masën "Qasja LEADER". Gjithashtu edhe Rrjetëzimi i GLV-ve mbështetet nga masa e Asistencës Teknike të IPARD.

5. Përfituesit

Grupet Lokale të Veprimit të zgjedhura dhe të kontraktuara nga Agjencioni për Zhvillimin e Bujqësisë.

6. Zbatimi i Qasjes LEADER

Qasja LEADER në nivel programi duhet të përmbajë të paktën elementet e mëposhtme:

- Hartimi dhe zbatimi i një strategjie të bazuar në ndërveprimin ndërmjet akterëve dhe projekteve të sektorëve të ndryshëm të ekonomisë lokale;
- Strategjia e zhvillimit lokal e bazuar në zonë mirë të definuar/përcaktuar;
- Partneritetin Publiko-Privat të Grupet Lokale të Veprimit;
- Qasja nga poshtë lart për vendimmarrje për grupet lokale të veprimit në lidhje me zbatimin e strategjive të zhvillimit lokal;
- Rrjetëzimi i partneriteteve lokale;
- Zbatimi i qasjeve inovatore.

Grupet Lokale të Veprimit (GLV-të) zbatojnë Strategji të Zhvillimit Lokal (SZHL), e cila mund të përfshijë një ose më shumë nga gjashtë temat prioritare të mëposhtme:

- Ekonomia rurale: zhvillimi i zinxhirëve të shkurtër të furnizimit dhe produkteve me vlerë të shtuar, duke përfshirë produkte cilësore, zeje dhe aktivitete të tjera për të diversifikuar ekonominë rurale;
- Turizmi rural: zhvillimi i produkteve të turizmit rural bazuar në përdorimin e burimeve lokale, natyrore dhe kulturore;
- Komuniteti: inkurajimi i jetës kulturore dhe sociale të komunitetit dhe mbështetja e organizatave kolektive lokale, shoqatave dhe organizatave joqeveritare;
- Hapësirat publike: përmirësimi i hapësirës publike në fshatra;

- Mjedisi: përmirësimi i standardeve mjedisore në zonat e GLV-ve dhe promovimi i përdorimit të energjisë së ripërtëritshme nga komuniteti lokal;
- Rrjetëzimi: rrjetëzimi i GLV-ve, shkëmbimi i praktikave më të mira, shpërndarja e programeve IPARD dhe mësimi i qasjeve të reja për zhvillimin rural.
- Zbatimi i Strategjisë së Zhvillimit Lokal përfshinë: aktivitetet e animimit dhe ngritjes së kapaciteteve, projektet e vogla dhe kostot rrjedhëse për GLV-në. Aktivitetet duhet të lidhen me temat prioritare të përzgjedhura më sipër.

Grupet lokale të veprimit duhet të plotësojnë kushtet e mëposhtme

- Duhet të propozojnë një strategji të integruar të zhvillimit lokal, bazuar në karakteristikat e LEADER-it siç përcaktohet në pikën 6 prej (a) deri (f);
- Ato duhet të përbëhen nga një grup që përfaqëson partnerë nga sektorë të ndryshëm socio-ekonomikë me bazë lokale në territorin në fjalë. Barazia gjinore duhet të sigurohet nga pjesëmarrja e grave në një nivel vendimmarrës. Një numër minimal i grave dhe të rinjve do të vendoset në program;
- Duhet të demonstrojnë aftësinë për të përcaktuar dhe zbatuar një Strategji të Zhvillimit Lokal (SZHL) për zonën;
- Grupi lokal i veprimit duhet të ketë një formë ligjore (p.sh. shoqatë);
- Aftësia për të menaxhuar fondet publike: Organi qeverisës duhet të sigurojë që GLV-të të zgjedhin një menaxher administrativ, financiar i cili do të jetë në gjendje të menaxhojë fondet publike dhe të sigurojë funksionimin e kënaqshëm të partneritetit.

Kërkesat për GLV-të zonat që duhet të mbulohen/përfshihen nga SZHL-të e tyre

- Zona e GLV-së duhet të jetë koherente dhe të sigurojë masë kritike të mjaftueshme për sa i përket burimeve njerëzore, financiare dhe ekonomike për të mbështetur një strategji të zhvillimit të qëndrueshëm;
- Popullsia e secilës zonë duhet, si rregull, të jetë jo më pak se 10,000 banorë dhe jo më shumë se 150,000 banorë, duke përfshirë vendbanimet me një popullsi më të vogël se 25,000 banorë;
- I njëjti lokacion nuk duhet t'i përkasë më shumë se një GLV-je, që do të thotë një partneritet, një strategji dhe një territor;

Përmbajtja minimale e Strategjisë së Zhvillimit Lokal (SZHL)

- Përkufizimi i Zonës/territorit të GLV-së duhet të jetë koherent/kompakt dhe të ofrojë masë/sasi të mjaftueshme të burimeve njerëzore, financiare dhe ekonomike për të mbështetur zbatimin e Strategjisë së zhvillimit lokal.
- Analiza e nevojave të zhvillimit dhe potencialit të zonës, duke përfshirë një analizë të pikave të forta, të dobëta, mundësive dhe kërcënimeve (SWOT);
- GLV-të duhet të marrin në konsideratë jo vetëm statistikën, por edhe pikëpamjet e akterëve /palëve lokal.
- Përshkrimi i strategjisë dhe objektivave të saj; GLV-të përcaktojnë vizionin dhe objektivat në përputhje me temat prioritare PZHR 2022-2028
- Përshkrimi i procesit të përfshirjes së komunitetit në përgatitjen e strategjisë, strukturën e partneritetit dhe rregullat e brendshme të vendimmarrjes.
- Plani i veprimit/aktiviteteve të SZHL-së. Të gjitha veprimet/aktivitetet e propozuara duhet të jenë të lidhura me temat e zgjedhura me prioritet. Plani i veprimit/aktiviteteve më vonë do të përkthehet në plane vjetore të hollësishme.
- Plani financiar me një buxhet tregues/orientues për periudhën e kohëzgjatjes së SZHL-së i ndarë në: shpenzime operative ose të funksionimit të GLV-së, animacionin/ndërtimin e kapaciteteve dhe për projekte të vogla.

7. Aktivitetet e pranueshme

Përgatitja e Strategjive të Zhvillimit Lokal të GLV-ve

7.1 Lista e shpenzimeve të pranueshme

- Punëtori dhe ngjarje informative për nxitjen e pjesëmarrjes aktive të popullsisë rurale në procesin e zhvillimit lokal
- Shërbimet e ekspertëve;
- Përkthimi i dokumenteve dhe interpretimit;
- Qeraja e objekteve dhe pajisjeve;
- Qeraja e sallës për ngjarje;
- Furnizim me ushqim për pjesëmarrësit;
- Tarifat, kostot e regjistrimit;
- Blerja e materialeve;
- Shpenzimet e udhëtimit;
- Përgatitja /përpunimi dhe shpërndarja e materialeve informuese të nevojshme për përgatitjen, publicitetin e strategjive lokale të zhvillimit;
- Publiciteti, publikimet, broshurat, fletëpalosjet;

8. Procedura për përzgjedhjen e Grupeve Lokale të Veprimit

Thirrja (et) për të zgjedhur GLV-të duhet të jenë të hapura për të gjitha zonat rurale dhe të sigurojnë konkurrencë midis grupeve lokale të veprimit që të paraqesin Strategjitë e Zhvillimit Lokal.

Procedura e përzgjedhjes përbëhet nga dy faza:

- Kontrolli i pranueshmërisë së GLV-ve nga Agjencioni i Zhvillimit të Bujqësisë; (GLV-të të themeluara aplikojnë për fonde për përgatitjen e SZHL-ve të tyre, me dokumentet e kërkuara)
- Vlerësimi i SZHL-ve të GLV-ve janë të pranueshme sipas kriterëve të përzgjedhjes nga Komiteti Vlerësimit. Komiteti i Vlerësimit përbëhet nga përfaqësues nga Autoriteti Menaxhues dhe aktorë të tjerë relevantë rural dhe OJQ që merren me zhvillimin rural. Anëtarët e Komitetit të Vlerësimit do të emërohen nga Ministri ose një zyrtar i lartë pas propozimit nga Autoriteti Menaxhues.

8.1 Kriteret e pranueshmërisë për përgatitjen e SZHL

Territori:

- Territore nga zonat rurale me koherencë/kompaktësi të mjaftueshme dhe me një masë të caktuar të popullatës prej 10,000 – 150,000 banorë, përfshirë edhe vendbanimet me një popullsi më të vogël se 25,000 banorë. Devijimi nga kjo rregull është e mundur me një arsyeshmëri siç duhet dhe e cila do të duhet shpjeguar në program.
- Një komunë/vendbanim i përket vetëm një GLV-je. Asnjë mbivendosje nuk lejohet - që do të thotë “një partneritet, një strategji, një territor”.

Forma ligjore:

- GLV-të duhet të jenë të regjistruara si person juridik zyrtarisht (d.m.th. shoqatë, fondacion, OJQ) bazuar në aktet ligjore relevante; Në përputhje me legjislacionin kombëtar, ajo (GLV-ja) mund të regjistrohet si organizatë, statuti i së cilës garanton funksionimin e kënaqshëm të partneritetit dhe aftësinë për të menaxhuar/administruar fondet publike.

Partneriteti:

- Në nivelin e vendimmarrjes, partnerët ekonomikë dhe social, si dhe përfaqësues të tjerë të shoqërisë civile, të tillë si fermerë, gra rurale, të rinjë dhe shoqatat e tyre, duhet të përbëjnë më shumë se 50% të partneritetit. Për më tepër, minimumi 20% do të jenë përfaqësues të autoriteteve lokale. Sidoqoftë, autoritetet publike siç përcaktohet në përrputhje me rregullat kombëtare, do të përfaqësojnë më pak se 50% të të drejtave të votimit;
- 10% e pjesëmarrjes së grave dhe/ose të rinjve për të siguruar diversitetin e moshës dhe barazinë gjinore
- Anëtarët e organeve vendimmarrëse të GLV-së duhet të jenë banorët resident ose veprojnë në zonën e mbuluar nga Strategjia e Zhvillimit Lokal;
- GLV-ja duhet të propozojë një Strategji të Zhvillimit Lokal të integruar, që përfshin të paktën elemente minimale dhe tema prioritare siç specifikohet në Programin e Zhvillimit Rural.

9. Kriteret e përzgjedhjes së SZHL-ve

Mund të përdoren kriteret e mëposhtme të përzgjedhjes:

- Cilësia e partneritetit, është rregull e përfaqësimit për menaxhim dhe vendimmarrje duke e shmangur konfliktin e interesit, përfshirë pjesëmarrjen e të rinjve dhe grave;
- Koherenca e territorit të GLV-ve dhe sasia mjaftueshme për sa i përket burimeve njerëzore, financiare dhe ekonomike;
- Cilësia e logjikës së ndërhyrjes së Strategjisë (përfshirë analizën SWOT etj.);
- Koherenca e veprimeve të propozuara me analizën SWOT dhe temat prioritare të PBZHR-së ;
- Përfshirja e palëve të interesit në përgatitjen e Strategjisë së Zhvillimit Lokal;
- Aftësia e GLV-së për të menaxhuar zbatimin e SZHL-së;
- Projektet e mbështetura nga burime të tjera (jo nga Programi BZHR) duhet të konsiderohen si vlerë e shtuar, megjithatë financimi i dyfishtë duhet të shmanget.

10. Intensiteti i ndihmës dhe niveli i kontributit

Intensiteti i mbështetjes, i shprehur si pjesë e mbështetjes publike në shpenzime të pranueshme është 100% për përgatitjen e SZHL të GLV-ve.

GLV-të duhet të bëjnë kërkesën për paradhënie 80% dhe kërkesën për pagesë pas dorëzimit të SZHL-së prej 20%.

11. Buxheti

Masa 5	Zbatimi i Strategjive të Zhvillimit Lokal – "Qasja Leader"	Buxheti	%
	Numri i GLV -ve që aplikojnë *	12	
	Buxheti për një GLV	10,000.00	3,33
	Totali i buxhetit	300,000.00	

Numri i GLV -ve që aplikojnë *

Numri i GLV-ve që aplikojnë për përgatitjen e SZHL-ve parashikim 12, nëse aplikojnë më shumë atëherë buxheti ndahet për numrin e GLV-ve që kanë aplikuar.

12. Treguesit

Indikatorët	Caqet
Numri i GLV-ve që veprojnë në zonat rurale	12
Numri i popullatës së mbuluar nga aktivitetet e GLV-ve;	350,000
Numri i Strategjive Lokale të Zhvillimit të aprovuara	12

13. Procedura administrative

Agjencioni për Zhvillimin e Bujqësisë publikon thirrje dhe bën përzgjedhjen e Grupeve Lokale të Veprimit bazuar në kontrollin administrativ të pranueshmërisë. Kontrata nënshkruhet ndërmjet Agjencionit për Zhvillimin e Bujqësisë dhe GLV-ve Potenciale; Ndërsa vlerësimin e SZHL-ve e bën Komiteti Vlerësues i themeluar nga Autoriteti Menaxhues.

14. Afati i zbatimit

Afati i zbatimit të projekteve të kësaj mase është 6 muaj prej momentit të nënshkrimit të kontratës me AZHB-në. Përfituesi/GLV -të kanë edhe 15 ditë shtesë për përgatitjen e dokumentacionit dhe paraqitjen e kërkesës për pagesë. AZHB mund të zgjasë afatin e zbatimit për më së shumti 30 ditë, nëse ka arsye të qëndrueshme për këtë.

15. Shtrirja gjeografike e masës

Qasja LEADER duhet të zbatohet në zonat rurale siç përcaktohet në program



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

Ministarstvo Poljoprivrede, Šumarstva i Ruralnog Razvoja

Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development